



# Besimi İm

INFORMACIONE THEMELORE PËR ISLAMIN



KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE E TURQISË



KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE E TURQISË

# Besimi im

**Editor:**

Prof. dr. Mehmet Emin Özafşar - Prof. dr. Recai Doğan

**Drejtor publikimi:**

Dr. Fatih Kurt

**Koordinimi:**

Lokman Arslan

**Projekti:**

Kryesia e Çështjeve Fetare e Turqisë  
Kryesia e Zyrës së Arsimit Fetar

**Autorët e kapitujve:**

Kapitulli 6-7-9: Prof. dr. Erdoğan Pazarbaşı

Kapitulli 1-4-8: Prof. ass. Ali Kuşat

Kapitulli 2-3-5: Prof. ass. Süleyman Akyürek

**Përktheu**

Florida Kulla

**Redaktor gjuhësor**

Fatjon Cuka

**Faqosës**

Erzen Pashaj

**Përgatiti për botim:**

Uğur Altuntop

**Botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë: 1348**

**Libra profesionalë: 144**

Vendimi i Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare: 10.04.2017 / 27

2019-06-Y-0003-1348

ISBN: 978-975-19-6727-5

Certifikimi: 12930

Botimi i dytë, Ankara 2019

**Botimi:**

Başak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.

+90 312 397 16 17

© KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE E TURQISË

**Kontakt:**

Kontakt me Drejtorinë e Përgjithshme të Botimeve

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü

Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A

06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE

Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr

## KAPITULLI 1

### NJERIU DHE FEJA

1. Natyra e njeriut .....	7
2. Natyra e njeriut dhe feja .....	8
3. Roli i fesë në jetën e njeriut dhe rëndësia e saj .....	9
4. Koncepti i fesë .....	13
5. Qasje të ndryshme ndaj konceptit të fesë .....	14
6. Burimi i fesë .....	15
7. Lloje të ndryshme të besimit .....	16
8. Klasifikimi i feve .....	17

## KAPITULLI 2

### BESIMI DHE NJERIU

1. Besimi dhe rëndësia .....	23
2. Fjala e Teuhidit dhe fjala e Shehadetit ..	25
3. Njerëzit në pikëpamje të marrëdhënies besim-veprim .....	26
4. Marrëdhënia besim-dije-veprim .....	30

## KAPITULLI 3

### MARRËDHËNIA ALLAH-NJERI-GJITHËSI

1. Allahu dhe krijimi .....	41
2. Pozicioni i njeriut në pikëpamje të krijimit .....	42
3. Kontakti i njeriut me Allahun .....	43
4. Gjithësia në pikëpamje të krijimit .....	47
5. Përgjegjësia e njeriut në marrëdhënien njeri-veprim .....	50

## KAPITULLI 4

### BESIMI NË ALLAH

1. Ekzistenca dhe njëjësia e Allahut .....	57
2. Atributet e Allahut në Kur'an .....	58
3. Emrat e bukur (Esmā-i Husnā), që shprehin mëshirën dhe dashurinë e Allahut ndaj krijesave .....	61
4. Emrat e bukur të Allahut që shprehin mëshirën e Tij .....	65
5. Emrat e bukur të Allahut që shprehin fuqinë e Tij .....	68

## KAPITULLI 5

### BESIMI NË MELEKË

1. Karakteristikat e melekëve .....	75
2. Detyrat e melekëve .....	77
3. Qenie të tjera të padukshme përveç melekëve .....	80

## KAPITULLI 6

### BESIMI NË LIBRA

1. Shpallja hyjnore dhe nevoja që ndihet për të .....	93
2. Librat hyjnorë .....	95
3. Zbritja e Kur'anit .....	100
4. Shkrimi i Kur'anit dhe marrja e formës së Mus'hafit .....	101
5. Modeli i njeriut që synon Kur'anin në pikëpamje të dijes .....	103
6. Modeli i njeriut që synon Kur'anin në pikëpamje të besimit .....	106
7. Modeli i njeriut që synon Kur'anin në pikëpamje të sjelljes .....	107

## KAPITULLI 7

### BESIMI NË PEJGAMBERË

1. Profetësia dhe nevoja që ndihet për peygamberët .....	115
2. Karakteristikat e peygamberëve .....	117
3. Detyrat e peygamberëve .....	120
4. Mrekullia dhe kerameti .....	121
5. Paragrafë nga jeta e disa peygamberëve .....	122

## KAPITULLI 8

### BESIMI NË AHIRET

1. Besimi në ditën e ahiretit dhe rëndësia e tij .....	137
2. Vdekja dhe ringjallja pas vdekjes .....	138
3. Hetimi i njerëzve për veprimet e tyre .	141
4. Xhenneti dhe xhennemi .....	143
5. Besimet e gabuara në lidhje me vdekjen dhe jetën e pasme (rikrijimi) .....	144

## KAPITULLI 9

### BESIMI NË KADER DHE KADA

1. Konceptet kader dhe kada .....	151
2. Disa karakteristika në lidhje me kaderin e njeriut .....	152
3. Disa koncepte në lidhje me kaderin në Kur'an .....	157

## PËRGJIGJET

166

## LITERATURA

167

# Parathënie



Allahu, zotëruesi i mëshirës dhe i dhembshurisë, e ka krijuar njeriun në formën më të bukur, e ka pajisur atë me aftësi të larta, e ka përcaktuar si krijesa, ndaj së cilës drejtohet thirrja hyjnore, e ka nderuar dhe i ka ngarkuar përgjegjësi atij. Në jetën e kësaj bote nuk e ka lënë atë të vetëm, e ka nxjerrë nga errësira e mosbesimit dhe, për të bërë të mundur që ai të arrijë në një moral të bukur e të shndritshëm, ka dërguar peygamberë dhe libra, si ndihmë e mirësi hyjnore.

Feja, fillesat e së cilës nisin bashkë me njeriun e parë, është një nevojë ekzistenciale për njeriun. Feja është një tërësi këshillash kundrejt gjithë jetës. Ajo bën të mundur vendosjen e ekuilibrit mes botës dhe ahiretit, mendjes dhe shpirtit; mundëson harmoninë dhe paqen e brendshme, sjell dashuri dhe drejtësi, i shndërron detyrat tona individuale e shoqërore në një përgjegjësi në cilësinë e adhurimit.

Njeriu, i cili mundohet të kuptojë veten, të kuptojë gjithësinë dhe Krijuesin e tij, që e do Atë dhe është i lidhur me Të, duke ecur në rrugën e përfaqësuesve të mëshirës dhe të librave hyjnorë, të cilët i ka dërguar Krijuesi, është i orientuar në kuptimin e robërimit dhe të vërtetës.

Në këtë pikëpamje, plotësimi i nevojës së njeriut me informacion të drejtë për fenë, është i rëndësishëm.

Meqë feja ka si synim parësor njeriun, është e rëndësishme që të bëhet një përtëritje e vetes nëpërmjet informacioneve fetare, me qëllim që jeta të shndrijet, të freskohet mesazhi i Islamit në mendje dhe në zemra, të formohet një lidhje dinamike mes dijes dhe jetës. Në këtë kuadër, Kryesia e Çështjeve Fetare ka përcaktuar si objektiv ndriçimin e popullit tonë me informacion fetar, mbajtjen larg besëtytnive, realizimin e kësaj nevojë me informacione të sakta fetare mbi çështje të besimit, adhurimit, sijaerit dhe moralit, duke marrë parasysh edhe të dhënat bashkëkohore e shkencore. Për këtë arsye, ajo ka planifikuar një kolanë të titulluar "Informacione themelore mbi Islamit". Vepra që keni në dorë, me titull "Besimi im", është e para e kësaj kolane dhe është përgatitur sipas programit mësimor *Informacionet Themelore Fetare*, mësim i cili jepet në kurset fetare të varura nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë.

Në këtë vepër jemi fokusuar mbi çështjet e besimit, si një ndër çështjet themelore të fesë islame. Është trajtuar çështja e besimit në ekzistencën dhe njëjtesinë e Allahut, besimi në melekë, në libra, peygamberë, besimi ndaj ditës së ahiretit, kaderit dhe kadasë, çështje të cilat përbëjnë bazën e besimit islam dhe të besimit të teuhidit.

Dëshira jonë më e madhe është që ky punim të jetë i dobishëm për lexuesit.

Vullneti nga ne, suksesi nga Allahu.



besimi im



Kapitulli


1





# Njeriu dhe feja

1. Natyra e njeriut
2. Natyra e njeriut dhe feja
3. Roli i fesë në jetën e njeriut dhe rëndësia e saj
4. Koncepti i fesë
5. Pikëpamje të ndryshme ndaj konceptit të fesë
6. Burimi i fesë
7. Lloje të ndryshme të besimit
8. Klasifikimi i feve



## RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull:

- Shqyrtohet roli dhe pozicioni i njeriut në gjithësi,
- Roli i tij ndër gjallesat e tjera,
- Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e tij,
- Natyra e njeriut dhe marrëdhënia e fesë në këtë kuadër; struktura e njeriut kundrejt kuptimit dhe perceptimit të fesë,
- Po ashtu, jepet edhe koncepti i fesë dhe kuptimi i këtij koncepti, brendia e tij, si dhe trajtohen format e besimit që janë shfaqur ndër njerëzit, duke nisur nga historia e hershme e deri në ditët e sotme

6

## SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Në fund të këtij kapitulli pritet që të zotëroni informacionet e mëposhtme:

1. Të perceptoni përse është krijuar njeriu.
2. Të shprehni marrëdhënien ndërmjet natyrës së njeriut dhe fesë.
3. Të perceptoni rolin dhe rëndësinë e fesë në jetën e njeriut.
4. Të shpjegoni konceptin e fesë dhe burimin e saj.
5. Të klasifikoni llojet e besimeve dhe të feve të ndryshme.

## NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni çështjet që lidhen me ato pika, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Plotësojini patjetër ushtrimet dhe veprimtaritë analitike që jepen brenda kapitullit.
3. Studioni librat që mund të siguron nga literatura në fund të veprës.



### Le të mendojmë

Sipas Kur'anit, amanetin e mori mbi vete njeriu. Kështu, ai premtoi:

- Të lexojë e kuptojë Kur'anin dhe të plotësojë përgjegjësitë që bien mbi të,
- Të ndiejë përgjegjësi,
- Të perfeksionohet,
- Të dojë dhe të duhet,
- Të plotësojë urdhëresat e Allahut.

# 1

## Natyr e njeriut



Të gjitha krijesat e kësaj bote janë krijuar për një qëllim. Çdo gjallesë, me apo pa shpirt, sillet në përputhje me qëllimin, për të cilin është krijuar. Bimët bëjnë atë që duhet të bëjnë. Kur gjejnë mjediset e përshtatshme gjallërohen dhe rriten, marrin dyoksid karboni nga ajri dhe prodhojnë oksigjenin, i cili është baza e jetës sonë, japin fruta të ndryshme për përballimin e nevojave tona ushqimore. Këto detyra i kryejnë që në çastin kur krijohehen, pa ndërprerje.

Në lidhje me këtë çështje, Allahu, duke urdhëruar: "Është shiu që zbret nga qielli ai që ju siguron ujë për të pirë dhe bën që të rriten bimët, të cilat shërbejnë si ushqim për kafshët." (*Nahl, 16/10*), "Vallë, a nuk e shohin ata tokën, prej së cilës kemi bërë të mbijnë sa e sa lloje çifte bimësh fisnike?" (*Shuara, 26/7*), në një farë mënyre kërkon që njeriu të hetojë dhe të meditojë përse është krijuar.

## Detyrat e dhëna ndaj kafshëve

Edhe kafshët, sa i përket realizimit të detyrave që u janë dhënë në mënyrë instinktive nga Allahu, nuk kryejnë gabime. Bleta, për shembull, e cila që nga dita e parë kur u krijua filloi të prodhojë mjaltë, vazhdon ta kryejë këtë detyrë pa mangësi.



"Zoti yt e frymëzoi bletën, (duke thënë): Ndërto shtëpi në male dhe në drurë dhe në atë (kosheret) që kanë ngritur njerëzit!" (*Nahl, 16/68*)

## Qëllimi i krijimit të njeriut

Qëllimi i krijimit të njeriut është shumë më i ndryshëm nga ai i gjallesave të tjera. Ndërkohë që gjallesat e tjera e kryejnë një detyrë në mënyrë instinktive për të përballuar nevojat themelore në këtë botë, krijimi i njeriut është krejtësisht i ndryshëm. Ndryshe nga gjallesat e tjera, njeriu i janë dhënë disa karakteristika të posaçme.

Këta karakteristika e ndihmojnë atë të orientohet dhe të administrojë veten. Ato bëjnë që njeriu të marrë përgjegjësi dhe t'i realizojë ato



Njeriu, i cili sipas librit të madhëruar, Kur'anit, pranoi mbi supe amanetin, ka marrë përgjegjësi mbi çështjen e leximit dhe të kuptimit të Kur'anit, por dhe të plotësimit të urdhëresave të tij; mbi çështjen e pranimet të ndjenjës së përgjegjesisë, të zhvillimit dhe të perfeksionimit të vetes; mbi çështjen e të dashurit të të tjerëve dhe të qenit i dashur nga të tjerët, si dhe në plotësimin e lejimeve dhe të ndalimeve të Allahut.

Njeriu, i cili ka marrë mbi supe amanetin hyjnor, duke filluar që nga dita kur është krijuar e deri më sot, e ka zhvilluar veten dhe është munduar që të nxjerrë në pah karakteristikat ekzistuese të vetvetes. Po ashtu, ai është mbajtur përgjegjës nga Allahu për të gjitha sjelljet e tij në këtë drejtim.

Allahu në Kur'an i radhit qartazi arsyet përse është krijuar njeriu dhe se cilat janë përgjegjësitë e tij.

"A nuk e mban mend njeriu se Ne e kemi krijuar atë, kur ende nuk ishte asgjë?!" (Merjem, 19/67)

"Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun nga një pikë farë e përzier, për ta sprovuar, e bëmë që të dëgjojë e të shohë." (Insan, 76/2)

"Çdo gjë që gjendet në tokë, Ne e kemi bërë stoli për të, që të provojmë se kush prej tyre punon më mirë." (Kehf, 18/7)

"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë." (Dharijat, 51/56)

8

2

## Natyrë e njeriut dhe feja

Njeriu është krijuar në një strukturë të përshtatshme për ta njohur Allahun dhe për t'i besuar atij. Madje, duke u nisur nga pastërtia krijimore e tij (fitrat), njeriu zotëron cilësinë e zhvillimit nga bota materiale drejt botës shpirtërore. Sa i përket kësaj çështjeje, Krijuesi i Lartmadhëruar urdhëron:



"Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer." (Tin, 95/4)

"Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, në natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Rum, 30/30)

Njeriu, që nga fëmijëria e tij zotëron një natyrë të përshtatshme për ta pranuar fenë, për ta kuptuar dhe për ta përjetuar atë. Hadithi i Pejgamberit tonë të dashur: "Çdo njeri lind mbi fitrat (pastërti krijimore), nëna dhe babai i tij më vonë e bën atë zoroastri, hebre ose të krishterë." (Muslim, Kader, 6 (25), III/2048), tregon se çdo fëmijë krijohet mbi një pastërti krijimore, e cila është e përshtatshme për ta kuptuar, perceptuar dhe jetuar fenë, por pasi lind dhe në varësi të mjedisit ku rritet, ai pranon kulturën fetare të nënës dhe të babait të tij.

Fëmija, që nga çasti kur lind kalon në disa faza zhvillimi. Në secilën prej këtyre fazave ka disa nevoja, të cilat duhet t'i jetojë dhe t'i plotësojë. Në përballimin e këtyre nevojave, feja ka një rol të madh. Fëmija, pas një moshe të caktuar, e kupton se ndjenja e dashurisë dhe e besimit që do të dhurojë nëna dhe babai janë të kufizuara. Kështu, ai orientohet drejt dashurisë së pafund, pra, drejt Allahut; sigurinë dhe besimin e pafund e gjen vetëm tek Allahu.

Krahas kësaj, njeriu, me vullnetin e tij të lirë, që nga krijimi zotëron edhe lirinë e mosbesimit tek Allahu. Për shkak se nuk rritet në një mjedis fetar, ose si rrjedhojë e disa ndodhive që ka përjetuar, njeriu mund të mos pranojë asnjë fe. Allahu i ka lënë të lirë njerëzit në çështjen e besimit dhe mosbesimit, nuk i ka detyruar ata që të besojnë. Ashtu siç shprehet edhe në Librin tonë të madhëruar:



“Nuk ka detyrim në fe.” (Bakara, 2/256)

Ndërkaq, në pikëpamje të karakteristikave të tij të zhvillimit, njeriu zotëron një strukturë të përshtatshme për ta pranuar fenë, për ta kuptuar atë dhe për të jetuar sipas saj.

Feja, duke iu drejtuar mendjes, zemrës dhe ndjenjave të njeriut, i shndërron në njerëzore sjelljet e njerëzve; e ndihmon atë që të pastrojë nefsin (egon) e tij dhe i jep normat e të jetuarit si njeri. Kështu bën të mundur që, qoftë jetesa sociale, ashtu edhe ajo shoqërore, të fitojnë një cilësi që përputhet me pëlqimin e Allahut.

### 3

## Vendi dhe rëndësia e fesë në jetën e njeriut



Është fakt i ditur që njeriu lind me disa prirje natyrore dhe se duhet të edukohet në kuadër të këtyre prirjeve për të arritur shëndet shpirtëror, por edhe për të qenë i suksesshëm. Orientimi i njeriut në drejtim të fitratit, pra të pastërtisë krijimore, na paraqitet si një kusht paraprak, në mënyrë që njeriu të jetë më i perfeksionuar dhe më i lumtur në këtë botë, në përshtatje me qëllimin e krijimit të tij.

## Feja, lumturia e botës dhe ajo e ahiretit

Feja është një tërësi këshillash dhe urdhëresash kundrejt gjithë jetës së njeriut. Ajo është dërguar nga Allahu (xh. sh.) me qëllim që njeriu të jetë i lumtur në botë dhe në ahiret. Në rast se këto këshilla vihen në zbatim, feja kontribuon që jetesa individuale dhe shoqërore të jetohet në mënyrë njerëzore.



## Feja dhe marrëdhënia shpirtërore me Allahun e me të tjerët

Jetesa fetare, e cila është themeluar mbi ndjenjën e unitetit shpirtëror me të tjerët, si zgjatje kjo e lidhjes së sigurt dhe përzemërsisht me Allahun, luan një rol të rëndësishëm në nxjerrjen në pah të karakteristikave dhe të bukurive të shpirtit të njeriut.

## Zgjidhja e problemeve dhe feja

Në zgjidhjen e disa problemeve që njeriu nuk mund t'i zgjidhë vetvetiu në këtë botë, vjen në ndihmë informacioni dhe dija hyjnore. Për shembull:



### Le të mendojmë

- Përse jemi krijuar?
- Ç'do të bëhet pas vdekjes?
- Cili është qëllimi i ekzistencës sonë në këtë botë?

Për këtë arsye, kur shihet historia e njerëzimit, pothuajse është e pamundur që të gjendet një shoqëri, tek e cila nuk ka pasur fe. Megjithëse në një shoqëri mund të ketë njerëz, të cilët individualisht nuk besojnë, nuk mund të ketë të tillë të pa fe.



### Le të mendojmë

Në historinë e njerëzimit mund të rastisim njerëz, të cilët individualisht nuk besojnë... Ndërkaq nuk mund të rastisim një shoqëri pa fe.

## Feja në jetën fizike, shpirtërore dhe sociale të njeriut

Parimet e besimit, adhurimit dhe të moralit, ndaj të cilave feja kërkon që njerëzit të përshtaten, kanë rëndësi thelbësore në pikëpamje të jetës fizike, shpirtërore dhe sociale të njeriut.

- Disa parime morale të vendosura nga feja, ndikojnë që individi të perfeksionohet shpirtërisht dhe e ndihmojnë atë që të bëhet më social.
- Me ndihmën e parimeve që feja ka vendosur në ruajtjen e vlerave më të larta për njeriun, të tilla si arsyetimi, jeta, nderi dhe trashëgimia, bëhet e mundur që njeriu të jetojë në mënyrë të ndershme dhe të respektuar.

## Shoqëria konkurruese dhe feja

Në shoqëritë e sotme, ku materializmi, konkurrenca e lirë dhe konsumimi kanë arritur nivelin më të lartë, nevoja që ndihet për fenë është më e madhe se çdoherë.

Është një realitet i ditur që përfitimet materiale nuk mund t'i përballojnë të gjitha nevojat shpirtërore të njeriut. Kur njeriu arrin në një perfeksionim të caktuar material, në rast se hapësirën shpirtërore nuk e mbush me fenë e vërtetë hyjnore, këtë hapësirë do ta mbushë me besime besëtyte dhe hurafe (të pabaza); ose do të konsumojë çmendurisht, duke u bërë tërësisht skllav i materies. Kjo bën që uria e tij të shtohet më shumë, e shtyn atë drejt pangopshmërisë. Ndërkohë që në udhëzuesin e rrugës së drejtë, pra në Kur'an, urdhërohet:



"... Vërtet, zemrat qetësohen duke përmendur Allahun!" (Ra'd, 13/28)

dhe aludohet se burimi i paqes e i harmonisë së brendshme të njeriut është feja e Allahut. Lidhja e njeriut me zemër ndaj Allahut, përmendja e Tij, jetesa duke e përmendur atë në çdo situatë, krijon mundësinë që njerëzit të jetojnë në mënyrë paqësore me veten dhe me gjithësinë.

## Largësia nga feja

Ata që jetojnë larg atmosferës fetare, me qëllim që t'i plotësojnë këto hapësira të brendshme shpirtërore, orientohen drejt disa ushtrimeve medituese dhe kërkojnë ndihmë nga aktivitetet fizike. Një arsye e rëndësishme e rritjes së interesit ndaj këtyre veprimtarive nga njerëzit mbi një nivel të caktuar ekonomik në metropole është veçanërisht fakti që këta persona ndodhen në një krizë shpirtërore dhe gjendje depresioni.



### Le të mendojmë

- Dihet se përfitimet financiare nuk mund t'i përballojnë të gjitha nevojat shpirtërore të njeriut.
- Kur njeriu arrin në një perfeksionim material, nëse hapësirën shpirtërore nuk e mbush me fenë hyjnore, do të përpiqet ta mbushë duke konsumuar sa më shumë.

## Nevojat materiale-shpirtërore të njeriut dhe feja

Njeriu ndien herë pas here nevojën materiale dhe shpirtërore të njerëzve të tjerë.

- Njerëzit, të cilët mbledhen bashkërisht duke përjetësuar të njëjtat ndjenja, mendime dhe besime, formojnë një mjedis të posaçëm besimi, vlere, tradite dhe kulture.
- Dhe, për të jetuar brenda kësaj shoqërie, është e nevojshme që të gjenden disa vlera dhe parime të larta. Ja, pra, feja fal pikërisht këto vlera dhe parime.



- Feja jep këshilla se si njeriu duhet të krijojë marrëdhëniet me të afërmit e me fqinjët, si dhe në lidhje me nevojën për t'i vizituar ata. Çështja sila-i rahim, pra e vizitës së të afërmeve është një sjellje, mbi të cilën Pejgamberi ynë është fokusuar shumë. Allahu i Lartmadhëruar urdhëron në Kur'an duke thënë: "Krijoni solidaritetet në mirësi dhe devotshmëri" (*Maide, 5/2*). Ndërsa Pejgamberi, në një hadith të tijin thotë: "Vizitoni të afërmit, sepse Allahu ia zgjat jetën dhe i zgjeron riskun atij që viziton të afërmit dhe miqtë e tij." (*el-Edebu'l-Mufred, 1/67*)

## Problemet sociale, ekonomike, politike dhe feja

Qoftë në të kaluarën, qoftë në ditët e sotme, njerëzit e shoqërive që kanë pasur probleme sociale, ekonomike dhe politike, mbledhen rreth vlerave fetare me ndjenjën e solidaritetit dhe kanë arritur t'i zgjidhin me sukses e t'i tejkalojnë këto probleme. Sepse feja, duke na dhënë disa vlera morale, sociale dhe ekonomike, e ka konsideruar si detyrë të shenjtë përkujdesjen e njerëzve për njëri-tjetrin rreth këtyre vlerave, veçanërisht në periudha të vështira. Për këtë arsye, shoqëritë në të cilat dominon ndjenja e besimit, janë më të qëndrueshme ndaj vështirësive dhe më të suksesshme në vijueshmërinë e ekzistencës së tyre.

Feja na bën të ditur se çfarë është e drejtë apo e gabuar dhe na këshillon kryerjen e së drejtës dhe shmangien nga e gabuara. Në veçanti tregon se çfarë mund të jenë sjelljet negative të njeriu dhe i ndalon këto sjellje. Cenimin e të drejtave të të tjerëve e konsideron si e drejta e robit dhe e ndalon rreptësisht.



### Le të mendojmë

- Feja na bën të ditur se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar.
- Feja na këshillon të kryejmë çka është e drejtë dhe të shmangemi nga ajo që është e gabuar.

## Rregullat shoqërore dhe feja

Kur shohim rregullat shoqërore, të cilat kanë rol kyç në mbajtjen më këmbë të shoqërisë sonë dhe në vijimin e jetesës në mënyrë të drejtë, vërejmë se në mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre, feja dhe bazat e besimit kanë një funksion shumë të rëndësishëm.

Besimi ynë e tregon veten në çdo fushë të jetesës sociale dhe kulturore. Vihet re se në shoqërinë ku jetojmë, në traditat dhe zakonet e saj, në letërsi, art, në botëkuptimin e moralit, Islami, feja e fundit hyjnore dhe feja jonë e shenjtë, ka një rol dhe ndikim të madh.

Në mënyrë që shoqëria jonë ta ruajë unitetin dhe t'i vijojë këto vlera, jemi të detyruar që, vlerat e këtij besimi dhe kulturën islame, t'ia transmetojmë brezit që po formohet.



"Ndhimoheni njëri-tjetrin në punët e mira, ruajeni nga e keqja, gjynahet dhe armiqësia!" (Maide, 5/2)



"Vizitoni të afërmit, sepse Allahu ia zgjat jetën dhe i rrit riskun atij që viziton të afërmit dhe miqtë e tij." (el-Edebu'l-Mufred, 1/67)



#### Le të mendojmë

- Feja e orienton njeriun drejt lumturisë së botës dhe ahiretit.
- Feja na këshillon për marrëdhënie të mira me të afërmit dhe me fqinjët.
- Feja kërkon robërimin ndaj Allahut dhe sjelljen me respekt ndaj njerëzve.

## 4

### Koncepti "fe"

Koncepti "fe" ka ekzistuar që nga fillimi i krijimit të njerëzimit dhe është një dukuri, e cila ka zënë vend të rëndësishëm në jetën e individit e të shoqërisë. Janë bërë mjaft studime mbi natyrën e fesë dhe rolin e saj në jetën e njeriut dhe të shoqërisë.

Fjala "din (fe)" është fjalë arabe. Kuptimi leksikologjik i kësaj fjale është zakon, dispozitë, dënim, bindje, popull, karakter, situatë, llogari, pasuri, gjykim, masë, adhurim, besim dhe devotshmëri.

Përveç kësaj, fjala "din" e ka prejardhjen nga fjala "dejn", kuptimi i së cilës është "borxh". Feja është përdorur në këtë kuptim për shkak se përpilon borxhin dhe përgjegjësitë tona ndaj Allahut, vetes sonë, shoqërisë, njerëzimit dhe gjithësisë.

Ndërsa një kuptim tjetër i fjalës "din" është edhe "dënim dhe shpërblim". Për këtë arsye, dita e ahiretit, në të cilën njeriu do të gjykohej për çfarë ka bërë në botë, quhet "jeumuddin - dita kur jepen shpërblimet".

"Din" ka edhe kuptimin rrugë. Do të thotë "feja e Allahut", "rruga që këshillon dhe urdhëron Allahut". Pra, do të thotë të sillesh sipas urdhrave dhe këshillave të Allahut, të ecësh drejt rrugës që tregon Ai.



### Le të shënojmë

Fe: Dënim dhe shpërblim

Fe: Rrugë

Feja e Allahut: Rruga që këshillon Allahu

Jeumuddin: Dita e ahiretit

## 5

### Pikëpamje të ndryshme të konceptit “fe”



“Feja është një tërësi ligjesh hyjnore, të cilën Allahu e ka dërguar nëpërmjet peygamberëve dhe e cila i orienton njerëzit me mendje të shëndoshë drejt së mirës, së drejtës dhe së bukurës, me vullnetin e tyre të lirë.”



Në këtë përkufizim përfshihen këto elemente:

1. Feja është dërguar nga Allahu.
2. Feja është dërguar nga peygamberët, të cilët Allahu i ka zgjedhur ndër njerëzit.
3. Qëllimi kryesor i fesë është t’u falë lumturi njerëzve në botë dhe në ahiret, duke fituar pëlqimin e Allahut. Gjërat që Allahu kërkon nga njerëzit që t’i bëjnë ose të mos i bëjnë, janë kundrejt sigurimit të kësaj lumturie.

4. Një karakteristikë e rëndësishme e fesë është pranimi i saj prej njerëzve, me vullnetin dhe dëshirën e tyre. Feja nuk mund të pranohet me presion, gjë që Kur’ani e shpreh kështu:



“Nuk ka detyrim në fe.” (*Bakara, 2/256*)

5. Feja u drejtohet njerëzve, të cilët zotërojnë aftësinë e gjykimit sa të mund të dallojnë të mirën nga e keqja. Ata që nuk e zotërojnë këtë cilësi, nuk janë përgjegjës (mukel’lef) për urdhëresat e fesë. Ata që nuk kanë arritur në një moshë të caktuar pjekurie, në kuptimin mendor dhe shpirtëror, ose ata të cilët e kanë humbur shëndetin mendor (të çmendurit), nuk mund të jenë përgjegjës për urdhëresat dhe ndalesat e fesë.




### Le të mendojmë

- Qëllimi themelor i fesë është t'i bëjë njerëzit të lumtur në botë dhe në ahiret, duke bërë të mundur që ata të fitojnë pëlqimin e Allahut.
- Njëra prej cilësive të rëndësishme të fesë është që njerëzit ta pranojnë atë me vullnetin e lirë dhe me dëshirën e tyre.



## Burimi i fesë

Sipas fesë sonë të shenjtë, burimi i fesë është Allahu. Allahu i Lartmadhëruar i ka caktuar personat që ka zgjedhur mes njerëzve si peygamberë dhe nëpërmjet tyre u ka transmetuar njerëzve shpalljen hyjnore. Krahas kësaj, Allahu i ka pajisur me një fitrat (pastërti krijimore), e cila bën të mundur që njerëzit të kuptojnë shpalljen hyjnore, si dhe të pranojnë ekzistencën dhe njëjësinë e Allahut. Të gjithë peygamberët, që nga Ademi (a.s.) e deri te Muhammedi (s.a.s.), i kanë transmetuar me përpikëri shpalljet hyjnore që u kanë arritur atyre, ashtu siç kanë zbritur.



Si rrjedhojë, burimi parësor i fesë islame është Kur'ani, i cili përbëhet nga shpalljet hyjnore që i janë dërguar Peygamberit tonë, Muhammedit, nga Allahu.

Ndërsa një burim tjetër i fesë janë fjalët dhe sjelljet e Peygamberit. Fjalët dhe sjelljet e tij janë mbledhur në librat e hadithit. Pas Kur'anit, librat e hadithit janë burimi dytësor i besimit, adhurimit dhe moralit islam.

Peygamberi ynë, në Hutben e Lamtumurës, duke urdhëruar:



“O besimtarë! Juve ju lë dy amanete, për sa kohë i përqafoi ato dhe u përshtateni atyre, mos e ngatëroni rrugën. Ato amanete janë libri i Allahut, Kur'ani, dhe sunneti i Peygamberit.” (Muvatta, Kader 3, III/899)


ka theksuar se Kur'ani dhe sunneti janë burimi parësor i vlerave të fesë islame, të tilla si dija, besimi, adhurimi, morali dhe marrëdhëniet njerëzore.





## 7

### Llojet e ndryshme të besimit



16

### Monoteizmi

- Teuhidi quhet edhe monoteizëm.
- Teuhidi është një sistem besimi, që lidhet me besimin në një ekzistencë të vetme, të lartë dhe superiore.
- Islami është feja e fundit e teuhidit. Ndërsa feja, të cilën e kanë shpallur të gjithë pejgamberët është Islami.

Sipas këtij besimi, Allahu ekziston vetvetiu, Ai e krijoi çdo gjë nga asgjëja dhe forca e të cilit mjafton për çdo gjë.

### Politeizmi

- Shirkut: Quhet ndryshe edhe politeizëm, ose adhurim idhujsh.
- Shirkut është forma e besimit, e cila bazohet në ekzistencën e më shumë se një Zoti.
- Shirkut është një lloj besimi, i cili ishte mjaft i përhapur në mitologjitë e Greqisë, Egjiptit dhe Nordikut të vjetër, dhe që pranon ekzistencën e shumë zotave personalë.
- Ndërkohë që njerëzit, në fillim i besonin një fuqie të lartë, duke u nisur nga koha dhe

nga mjedisi, janë larguar nga besimi në një Zot të vetëm, i kanë njohur fuqisë së lartë si shok disa krijesa të tjera, duke u shfaqur kështu politeizmi dhe adhurimi i idhujve.


## Mosnjohja e Zotit

- Quhet edhe ateizëm.
- Ateizmi është refuzimi i Allahut, refuzimi i disa zotave, ose në tërësi i të gjithë zotave.
- Ateistët nuk e pranojnë idenë e një Zoti të vetëm në krijim; parashtrojnë se çdo gjë ekziston rastësisht vetvetiu.
- Ateizmi është një pikëpamje filozofike, e cila përvetësohet nga personi ose personat që janë kundër fesë.



## Klasifikimi i feve

Në përgjithësi, fetë ndahen në dy grupe: fetë qiellore dhe fetë joqiellore.



## Fetë qiellore

- Fetë qiellore janë fe që kanë si burim kumtesën hyjnore, e cila u është dërguar njerëzve nëpërmjet pejgamberëve nga Allahu.
- Fetë e dërguara me anë të pejgamberëve, nga Ademi (a.s.) e deri te Muhammedi (s.a.s.), janë fetë qiellore.
- Te këto fe ekziston besimi në Krijuesin e Lartmadhëruar, në krijesën më të lartë se njerëzit, i cili jep këshilla ndaj njerëzve se çfarë duhet të bëjnë dhe të mos bëjnë.
- Detyrat themelore të njerëzve në këtë botë janë të njohin Krijuesin e Lartmadhëruar dhe ta adhurojnë atë. Si shembull mund të tregojmë Hebraizmin, Krishterimin dhe Islamin.

## Fetë joqiellore

- Fetë joqiellore njihen si fe të formuara nga njerëzit në kuadër të mendimeve të tyre.
- Këto fe nuk janë dërguar nga Allahu nëpërmjet pejgamberëve.

- Te këto fe nuk ekziston besimi në një Zot të lartë. Thelbin e tyre e përbën orientimi i njerëzve drejt botës së brendshme dhe lartësimi i tyre. Edhe veprimet që bëhen me këtë qëllim, perceptohen si adhurim. Si shembull mund të tregojmë Budizmin, Hinduizmin, Shintoizmin, Brahmanizmin dhe Sihizmin.
- Por ka edhe disa fe, të cilat përbëhen nga përzierja e feve qiellore me ato joqiellore. Shembulli më i rëndësishëm i kësaj, është feja Sih, e cila pranohet sot nga disa njerëz në Indi.



## Përmbledhja e kapitullit



Çdo qenie frymore apo jo, sillet në kuadër të qëllimit për të cilin është krijuar. Bimët dhe kafshët, si rrjedhojë e natyrës së tyre, bëjnë atë që duhet të bëjnë.

Sa i përket njeriut, ai zotëron cilësinë e vullnetit/mendjes, cilësi kjo që e ndihmon atë në orientimin e tij. Në të njëjtën kohë, njeriu është edhe përgjegjës tek Allahu për sjelljet e tij.

Shpirti i njeriut nuk është i huaj ndaj fesë. Te njeriu ekziston në formë natyrore prirja e lidhjes te një ekzistencë dhe gjallesë e lartë.

Feja e ndihmon njeriun në zgjidhjen e disa problemeve, të cilat nuk mund t'i zgjidhë në këtë botë. Besimi dhe adhurimet, të cilat feja kërkon që t'i kryejnë njerëzit, kanë shumë dobi në pikëpamje të jetës fizike, shpirtërore dhe sociale.

Fjala "din (fe)" është një fjalë arabe. Kuptimi leksikologjik i saj është zakon, dispozitë, dënim, bindje, popull, karakter, situatë, llogari, pasuri, gjykim, masë, adhurim, besim dhe devotshmëri.

Ekzistojnë disa lloje besimi në lidhje me ekzistencën e Zotit dhe me atributet e tij. Këto janë monoteizmi (teuhid), politeizmi (shirku) dhe mosnjohja e Zotit (ateizmi).

Fetë zakonisht ndahen në dy kategori: fe qiellore dhe fe joqiellore. Fetë qiellore janë ato fe që u janë dërguar njerëzve nëpërmjet peygamberëve nga Allahu. Ndërsa fetë joqiellore janë ato fe, të cilat njerëzit i kanë shpikur sipas mendjes së tyre.



## Të rishikojmë kapitullin



1. Cilat janë burimet themelore të fesë?
2. Cilat janë qëllimet e krijimit të njeriut dhe të gjallesave të tjera?
3. Cila është rëndësia e fesë në pikëpamje të njeriut dhe të shoqërisë?
4. Cilat janë llojet e ndryshme të besimit?
5. Si i klasifikoni fetë?



## Pyetje vlerësuese



**1. Cila nga alternativat e mëposhtme është ndryshe nga të tjerat në pikëpamje të përgjegjësive?**

- A) Njerëzit    B) Kafshët    C) Bimët    D) Malet    E) Gurët

**2. Cila nga alternativat e mëposhtme përputhet me kuptimin e hadithit: “Çdo njeri lind mbi fitrat (pastërti krijimore), më vonë nëna dhe babai i tij e bën atë zoroastri, jahudi ose të krishterë”?**

- A) Çdo fëmijë lind si zoroastri.  
 B) Çdo fëmijë lind si jahudi.  
 C) Çdo fëmijë lind me prirjen për të pranuar fenë.  
 D) Çdo fëmijë lind si i krishterë.  
 E) Çdo fëmijë lind si musliman.

**3. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është njëra ndër dobitë e fesë?**

- A) Feja, duke penguar kërkesat për konsum të njeriut, i mundëson këtij të fundit një vetëpërmbajtje shpirtërore.  
 B) Feja pengon socializimin e njeriut.  
 C) Feja u përgjigjet disa problemeve, të cilat njeriu nuk i zgjidh dot në këtë botë.  
 D) Feja kërkon që të përkujdesemi për të afërmit dhe këshillon solidaritetin social.  
 E) Feja jep informacion mbi çështjet e marrëdhënies së njeriut me Allahun.

**4. Cili nga kuptimet e mëposhtme nuk është njëri prej kuptimeve të fesë?**

- A) Fjala “fe” ka kuptimin e borxhit.  
 B) Fe do të thotë dënim dhe shpërblim.  
 C) Fe do të thotë rrugë që do të ndiqet.  
 D) Fjala “din” është një fjalë e prejardhur nga fjala “dunja”.  
 E) Feja nënkupton fjalën bindje.

**5. Cili nga llojet e mëposhtme nuk përfshihet ndër llojet e ndryshme të besimit?**

- A) Monoteizmi                      B) Politeizmi                      C) Mosnjohja e Zotit  
 D) Magjia dhe magjepsja        E) Misterizmi

besimi im  
besimi im

Kapitulli

2





# Besimi dhe njeriu

1. Besimi dhe rëndësia e tij
2. Fjala e Teuhidit dhe fjala e Shehadetit
3. Njerëzit në pikëpamje të marrëdhënies besim-sjellje
4. Marrëdhënia besim-dije-veprim

## RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull:

Shqyrtohet çështja e besimit, e cila është baza e të qenit musliman. Po ashtu, analizohet marrëdhënia besim-njeri dhe, paraprakisht, vihet në pah fakti se çfarë është besimi dhe rëndësia e tij.

Shpjegohet kuptimi i kushtit të parë i të konsideruarit si besimtar, fjala e Teuhidit dhe fjala e Shehadetit.

Në vijim trajtohet pikëpamja e marrëdhënies besim-sjellje te njerëzit.

Po ashtu, aludohet mbi njerëzit dhe cilësitë e tyre në pikëpamje të besimit.

Parashtrihen cilësitë e besimtarit, dyfytirëshit, mohuesit dhe idhujtarit. Analizohet marrëdhënia besim-veprim dhe marrëdhënia besim-dije për shkak të ekzistencës së një marrëdhënieje të afërt mes dijes dhe veprimit si një pranim i brendshëm.

Ndikimi i besimit në cilësi të dijes, shfaqet në dy mënyra: në formën e imitimit dhe në atë të hetimit.

## SYNIMET E KAPITULLIT

Në fund të këtij kapitulli pritet të arrini synimet e mëposhtme:

1. Të jepni një përkufizim të besimit.
2. Të sqaroni rëndësinë e besimit.
3. Të shprehni ajetet dhe hadithet në lidhje me rëndësinë e besimit.
4. Të sqaroni dallimin mes besimit dhe mohimit.
5. Të shprehni fjalën e Teuhidit dhe fjalën e Shehadetit.
6. Të thoni kuptimet e fjalës së Teuhidit dhe të fjalës së Shehadetit.
7. Të sqaroni rolin e fjalës së Teuhidit dhe të fjalës së Shehadetit në fenë islame.
8. Të përkufizoni miratimin me zemër.
9. Të sqaroni rëndësinë e miratimit me zemër.
10. Të shprehni klasifikimin e njerëzve në pikëpamje të marrëdhënies besim-sjellje.
11. Të përkufizoni konceptet mumin, munafik, kafir dhe mushrik.
12. Të sqaroni aspektet e ndryshme të këtyre koncepteve.
13. Të jepni shembuj mbi klasifikimin e bërë në aspektin e imanit dhe të sjelljes.
14. Të sqaroni marrëdhënien besim-veprim.
15. Të jepni shembuj mbi marrëdhënien besim-veprim.
16. Të jepni shembuj mbi sjelljet e bukura që shfaq besimi.
17. Të dalloni sjelljet tuaja në aspektin e marrëdhënies iman-veprim.
18. Të sqaroni marrëdhënien besim-dije.
19. Të jepni shembuj mbi marrëdhënien besim-dije.
20. Të vini re përmasën e dijes në besimin tuaj.
21. Të analizoni sjelljet në aspektin e marrëdhënies besim-dije.

## NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni çështjet që lidhen me synimet, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Plotësojini patjetër ushtrimet dhe veprimtaritë analitike që jepen në këtë kapitull.

## 1

## Besimi dhe rëndësia e tij



- Besim do të thotë të besosh me qetësi dhe harmoni zemre, të besosh me shpirt dhe me vetëdije të brendshme. Në thelb besimi është çështje zemre. Në këtë aspekt, tek imani diskutohet për arritjen të besimi dhe për harmoninë e brendshme.
- Tek imani ka vërtetim, miratim dhe pranim.
- Thelbi i imanit është miratimi me zemër. Nëse bëhet fjalë për mospranimin e çështjeve që duhen besuar, për ndjenjën e dyshimit mbi vërtetësinë e tyre, nuk kemi të bëjmë me iman.
- Tek imani ekziston edhe shprehja e faktit që beson, pra miratimi me gojë. Ndërkaq, të besosh tek imani me zemër, ta përvetësosh këtë besim dhe ta shprehësh atë me gojë, nuk janë kushte të të njëjtit nivel. Megjithatë, atë që njerëzit kanë në zemër, e di vetëm Allahu. Miratimi me gojë ndihmon që imani të dihet nga njerëzit e tjerë.

## Një hadith në lidhje me imanin dhe ata që na bën të mendojmë

Sipas Islamit, iman do të thotë të pranosh si të vërteta ato që Pejgamberi ynë (s.a.s.) solli nga Allahu i Lartmadhëruar dhe t'u besosh atyre me zemër. Në një hadith bëhet e ditur kështu: "Ndërsa Hz. Pejgamberi po qëndronte ulur bashkë me sahabet e tij, erdhi një burrë i veshur me të bardha, përkuli gjunjët dhe u ul përpara Hz. Pejgamberit.

E pyeti Rasulullahun: 'Çfarë është imani?'

Rasulullahu iu përgjigj: 'Iman është t'i besosh Allahut, melekëve, librave, pejgamberëve të tij, ditës së ahiretit (ringjalljes pas vdekjes), kaderit (paracaktimit hyjnor), krijimit të së mirës dhe të së keqes.'

Burri pyeti: 'Çfarë është Islami?'

Rasulullahu iu përgjigj: 'Islam është të adhurosh Allahun, të mos i njohësh shok atij, të falësh namazin, të japësh zekatin që është farz, të shkosh në haxh dhe të mbash agjërimin.'

Burri pyeti: 'Çfarë është ihsani?'

Rasulullahu iu përgjigj: 'Ihsan është të adhurosh Allahun sikur po e sheh Atë. Edhe pse ti nuk e sheh dot Atë, Ai të sheh ty.' Pastaj burri u ngrit dhe iku." (Buhari, Iman, 37; Muslim, Iman, 1, 5)



### Është radha juaj

Për çfarë flitet në hadithin e mësipërm?



## UNË BESOVA, SHPREHA IMANIN

E njoh si të vetëm Allahun,  
besoj në ekzistencën e Tij.  
Ai është që krijoi melekët,  
Ai është që të vërtetën krijoi

Do të ringjallen robërit e vdekur,  
do të gjykohen dhe t'i nënshtrohen gjykimit.  
E njoh si të vetëm Allahun,  
atë që është i mbushur në shpirtin tim.

Librat e tij urdhra të Krijuesit janë,  
në udhë të drejtë janë fjalët e Tij.  
pejgamberët janë të dërguarit,  
e Atij, të Lartit, të rrugës së fesë.

Besoj Muhammedin që,  
ashtu siç është Pejgamber, është edhe rob.

Enver TUNÇALP

Dita e kadasë në ahiret,  
dita e gjykimit, dita e dënimit.  
Nga Zoti është kaderi, e mira dhe e keqja,  
gjithë njerëzimi i lidhur me të është.

24



#### Le të diskutojmë

Duke u nisur edhe nga poezia e mësipërme diskutoni kushtet që duhet të besohen.



#### Le të diskutojmë

Diskutoni brendinë e duasë "Amentu" duke u nisur nga kuptimi i saj.

Besimi i orienton sjelljet e individit dhe ndikon tek ai. Sepse imani ka një marrëdhënie shumë të afërt me mendimin, ndjenjën dhe sjelljen. Në këtë aspekt, imani rrethon tërësisht ekzistencën tonë.

Imani orienton marrëdhëniet tona me veten, njerëzit e tjerë, gjallesat dhe me qeniet e tjera.

Një person që beson në Allah mundohet që të plotësojë, në mënyrën më të mirë, detyrat e tij ndaj njerëzve dhe gjallesave të tjera. Nuk tronditet para fatkeqësive dhe nuk bie në pesimizëm.

Imani na jep forcë për të zgjidhur dhe tejkaluar problemet materiale e shpirtërore. Me imanin vetëdijesohemi se në jetën e botës çdo gjë është objekt për sprovë. Në këtë aspekt, imani është një burim, një thesar i sjelljeve tona.

Imani është forca shtytëse e të gjitha adhurimeve dhe veprimeve tona. Kuptimin e tyre e përfiton imani. Sepse tek imani bëhet fjalë për një pranim të brendshëm në mënyrë të vetëdijshme. Kjo gjendje vetëdijeje u fal kuptim të vërtetë dhe vlerë veprave të kryera.



### Le të mendojmë

- Imani i jep drejtim marrëdhënies së personit me veten e tij, me njerëzit e tjerë, me gjallesat dhe me qeniet e tjera.
- Imani është forca shtytëse e të gjitha adhurimeve dhe veprimeve tona.
- Imani u jep kuptim detyrave që njeriu ka ndaj gjallesave.

## 2

### Fjala e Teuhidit dhe fjala e Shehadetit



Fjala e Teuhidit dhe fjala e Shehadetit janë kushti i parë i pranimit të fesë islame, pra i të qenit musliman dhe besimtar: janë demonstrimi dhe treguesi i imanit të vendosur në zemër. Kushti i pazëvendësueshëm i të qenit musliman është të pranosh mesazhin e shprehur nga fjala e Teuhidit.

### Fjala e Teuhidit

Fjala që shpreh ekzistencën, unitetin e Allahut, që tregon se Allahu është krijuesi i çdo gjëje nga hiçi dhe krijuesi i vetëm; se Pejgamberi Muhammed është i dërguari i Allahut.

Fjala e Teuhidit është të thuash La ilahe il'lallah Muhammedu'r-Rasulullah = Nuk ka Zot tjetër veç Allahut. Muhammedi është i dërguari i Tij.

### Fjala e Shehadetit

Ndërsa fjala e Shehadetit është të shprehësh "fjalën e dëshmisë". Dhe kjo shpreh dëshminë e një njeriu për vërtetësinë e diçkaje.

Esh'hedu en la ilahe il'lallah ue esh'hedu enne Muhammeden abduhu ue rasuluhu = Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut. Përsëri dëshmoj se Muhammedi (s.a.s.) është robi dhe i dërguari i tij.

Ndërkohë që në fjalën e Teuhidit bëhet fjalë për njëjësinë e Allahut dhe pranimin e profetësisë së Pejgamberit Muhammed (s.a.s.), në fjalën e Shehadetit shprehet përforsimi i këtij pranimi në një mënyrë të qartë.



### Le të diskutojmë

- Duke menduar edhe përkufizimin e besimit, diskutoni përse konsiderohet musliman personi që pranon fjalën e Teuhidit.
- Çfarë ndryshon në botën mendore dhe shpirtërore të njeriut pranimi i fjalës së Teuhidit?
- Gjeni kuptimet e fjalës së Teuhidit dhe të fjalës së Shehadetit.
- Përse e shpreh fjalën e Teuhidit dhe fjalën e Shehadetit një njeri që ka pranuar Islamin?




### Le të shënojmë

- Fjala e Teuhidit është të thuash La ilahe il'lallah Muhammedu'r-Rasulullah = Nuk ka Zot tjetër veç Allahut. Muhammedi është i dërguari i Tij.
- Esh'hedu en la ilahe il'lallah ue esh'hedu enne Muhammeden abduhu ue rasuluhu = Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut. Përsëri dëshmoj se Muhammedi (s.a.s.) është robi dhe i dërguari i tij.

## 3

### Njerëzit në pikëpamje të marrëdhënies besim-sjellje

Njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri në pikëpamje të imanit. Imani zotëron përmasën e ndjenjës, të dijes dhe të sjelljes. Njerëzit dallohen nga njëri-tjetri në pikëpamjen e besimit në fenë islame, të pranimit të vërtetësisë së saj dhe të demonstrimit të sjelljeve sipas saj. Në pikëpamje të besimit njerëzit ndahen në katër kategori.



### Besimtari

Mu'min është personi që beson në Allah, që pranon me zemër në vërtetësinë e çdo gjëje që Pejgamberi ynë i dashur shpalli nga Allahu. Mu'mini është njëkohësisht edhe musliman. Në Kur'an, disa nga veçoritë kryesore të besimtarëve citohen si më poshtë:

### Veçoritë e besimtarit:

- "Në të vërtetë besimtarët kanë arritur në shpëtim.
- Ata, në namazet e tyre janë në përlulje të thellë.
- Ata kthejnë fytyrën nga veprat e padobishme dhe nga fjalët e thëna kot.
- Ata japin zekatin.
- Ata ruajnë nderin e tyre.
- Ata respektojnë amanetet dhe fjalët që japin.
- Ata i falin namazet vazhdimisht.
- Ja, pra, këta janë vetë besimtarët. Ata do të jenë të lumtur në xhennetet e Firdeusit. Ata do të qëndrojnë përjetësisht atje." (Mu'minun, 23/1-5, 8-11)



### Është radha juaj

Gjeni ajete të tjera në Kur'an që tregojnë veçoritë e besimtarëve.

Të drejtën e të vërtetën ka në thelb,  
nuk gjendet gënjeshtër në fjalën e tij,  
ndaj të varfërve e zgjat dorën muslimani.

Rruga e tij gjithmonë rruga e dijes është,  
Është robi i Allahut që është një,  
në udhën e Islamit është muslimani.

Bota dhe ahireti janë synimi i tij,  
gjithmonë nga e drejta zëri i anon,  
nga harami shmanget muslimani.

I do të vegjlit dhe bën që ta duan,  
i respekton të rriturit dhe i dëgjon ata,  
nga adhurimet e tij kënaqësi ndien muslimani.

(Programi Mësimor i Kurseve të Kur'anit, 87)



### Le të diskutojmë

- Duke u nisur nga poezia e mësipërme, tregoni se cilat mund të jenë veçoritë e tjera të muslimanit?
- Përse duhet t'i zotërojë besimtari këto cilësi? Diskutoni.

## Munafiku

- Të qenit munafik nënkupton dyfytërsinë. Munafiku, duke thënë se pranon njëjësinë e Allahut, profetësinë e Pejgamberit tonë, Muhammedit, duket si musliman, por në fakt nuk i beson me zemër këto.
- Në pikëpamje të besimit, munafiku është një person që është tjetër nga brenda, e tjetër nga jashtë. Pra, thelbi dhe fjala e tij nuk mbështesin dhe plotësojnë njëra-tjetrën.



### Është radha juaj

Ndërkohë që në iman pranimi dhe miratimi me zemër është një kusht i domosdoshëm, shprehja e besimit me gojë nuk është një kusht i domosdoshëm. Përse? Sqarojeni.

Në Kur'anin e Madhërueshëm, veçoritë e munafikut urdhërohen si më poshtë:

- Ka disa njerëz që, megjithëse nuk besojnë, thonë se i besojnë Allahut dhe ditës së ahiretit.
- Mundohen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët.
- Ndërkohë që, në të vërtetë, mashtrojnë veten e tyre, por nuk e vënë re këtë.
- Në zemrat e tyre ka një sëmundje që buron nga të qenit me dy fytyra.
- Edhe Allahu i ka shtuar sëmundjet e tyre.
- Ndërsa në këmbim të gënjeshtërisë që bëjnë ka një dënim plot dhimbje.
- Kur këtyre u thuhet: "Mos krijoni përçarje në sipërfaqen e tokës," ata thonë: "Ne bëjmë vetëm përmirësime." Dijeni mirë se janë pikërisht ata prishësit dhe çrregulluesit. Por nuk janë në dijeni të kësaj.
- Kur atyre u thuhet: "Besoni edhe ju ashtu siç besojnë njerëzit", ata thonë: "A të besojmë edhe ne, siç bëjnë mendjehetët?" Dijeni mirë se të pamend janë pikërisht këta që thonë kështu, por nuk janë në dijeni të kësaj.
- Ka disa njerëz që thonë: "Besojmë në Allahun dhe në ditën e gjykimit!", por në të vërtetë ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, por në fakt mashtrojnë vetveten, megjithëse nuk e ndiejnë. Në zemrat e tyre ka një sëmundje, të cilën Allahu ua shton. Ata i pret një dënim i dhembshëm, për shkak të hipokrizisë së tyre. Kur u thuhet: "Mos bëni çrregullime në tokë!", ata thonë: "Ne bëjmë vetëm përmirësime në tokë!" Por jo! Në të vërtetë, pikërisht ata janë shkaktarët e çrregullimeve, ndonëse nuk e ndiejnë.

Kur u thuhet: "Besoni edhe ju ashtu siç kanë besuar njerëzit e tjerë!", ata thonë: "Vallë, a të besojmë edhe ne ashtu siç besojnë mendjehetët?!" Por jo! Në të vërtetë, pikërisht ata janë mendjehetët, por nuk e dinë këtë.

Kur takohen me besimtarët, ata thonë: "Besojmë", por, kur mbesin vetëm me shejtanët e tyre, thonë: "Në të vërtetë, ne jemi me ju; ne thjesht po talleshim". Allahu do të tallet me ata dhe do t'i lërë për një kohë të gjatë të bredhin verbërisht në mendjemadhësinë e tyre. Ishin pikërisht këta që e këmbyen udhëzimin me humbjen, kështu që tregtia atyre nuk u solli kurrfarë dobie dhe as nuk ishin të udhëzuar në rrugën e drejtë." (*Bakara, 2/8-16*)

Munafikët, pavarësisht se në pamje janë si muslimanët, në të vërtetë nuk janë besimtarë. Shkaku i devijimit të tyre nga udha e Allahut është besimi në fillim dhe mohimi më pas. Prandaj zemrat e tyre janë vulosur.



"... Tashmë ata nuk kuptojnë më." (*Munafikun, 63/3*)

"Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të xhehennemit dhe ti nuk do t'u gjesh kurrë ndihmës atyre." (*Nisa, 4/145*)



### Le të mendojmë

- Kë mashtrojnë munafikët?
- Përse nuk u sjell dobi munafikëve shitblerja dhe tregtia e tyre?

Munafikët, pavarësisht se duken sikur bëjnë adhurim, në të vërtetë nuk bëjnë. Ata bëjnë adhurim vetëm për të mashtruar njerëzit dhe sa për sy e faqe. Në Kur'an situata e tyre tregohet si më poshtë:



“Rasti i tyre shëmbëllen me rastin e atyre që ndezin një zjarr dhe, kur ai ua ndriçon ç’kanë rreth vetes, Allahu ua merr dritën, i lë në errësirë dhe ata nuk shohin asgjë! Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, prandaj nuk kthehen në rrugë të drejtë.” (Bakara, 2/17-18)

## Mohuesi (Kafir)

Kafir është personi që nuk i beson kushtet themelore të fesë islame, që duke mos pranuar profetësinë e Pejgamberit tonë mohon një pjesë ose të gjitha urdhëresat dhe ndalesat që ai ka sjellë nga Allahu. Kjo situatë shfaqet edhe në formën e mospëlqimit të kushteve të besimit, apo duke mos u kushtuar rëndësi atyre dhe duke i konsideruar si të pavlera.

- Fjala kafir ka kuptimin “mbulues”. Ai që është kafir ka marrë këtë emërtim për shkak se mbulon të vërtetën dhe të drejtën, se u beson gjërave të gabuara.

- Mohuesi nuk e pranon të vërtetën në mënyrë të pavetëdijshme, ose e mbulon atë duke u sjellë indiferent ndaj saj. Në Kur'anin e Madhërueshëm, situata e mohuesve në ahiret shprehet kështu:



“... ose shëmbëllen me ata që, gjatë shtrëngatës nga qielli, shoqëruar me errësirë, bubullimë dhe shkrepimë, i mbyllin veshët me gishtat e tyre, për të mos dëgjuar ushtimën nga frika e vdekjes. Kështu, Allahu i ka nën kontroll mohuesit. Shkreptima, pothuaj ua merr shikimin. Sa herë që ajo u ndriçon rrugën, ata ecin dhe, kur i kaplon errësira, ndalen. Sikur të donte Allahu, do t’ua merrte dëgjimin dhe shikimin. Pa dyshim, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.” (Bakara, 2/19-20)



### Le të mendojmë

Si shpjegohet situata e mohuesve në ajetet e mësipërme? Shpjegojeni.

## Mushriku (Idhujtari)

- Fjala shirk ka kuptimet “të njohësh shok, të pranosh shok dhe ortak”. Të pranosh se Allahu ka shok, të ngjashëm dhe ortak.
- Ndërsa mushriku është personi që bën shirk.
- Mushrikët nuk e mohojnë ekzistencën e Allahut. Ndërkaq, bashkë me të pranojnë edhe zota të tjerë.
- Mushrikët pranojnë si Zot forcat dhe gjallesat, për të cilat mendojnë se janë të

barabarta me Allahun në pikëpamje të attributeve, vullnetit dhe fuqisë. Kjo krijesë mund të jetë frymore-jofrymore, e dukshme ose e padukshme.

- Shirku dhe kufri (mohimi) janë të afërt me njëri-tjetrin. Koncepti mushrik përdoret për të përkufizuar një pjesë të mohuesve. Çdo mushrik është mohues, por jo çdo mohues është mushrik.
- Sipas fesë sonë të lartë, Islamit, t'i njohësh shok Allahut është gjynahu më i madh.
- Në librin tonë, Kur'anin e Madhërueshëm, urdhërohet kështu: "Dhe ata të dy prej jush që kanë bërë këtë punë të turpshme, i ndëshkoni që të dy; e nëse pendohen dhe përmirësohen, ua hiqni dënimin. Se Allahu e pranon pendimin dhe është Mëshirues." (Nisa, 4/16)

Sipas besimit tonë, zotëruesi absolut i qiejve, i tokës dhe i çdo gjëje tjetër është Allahu. Krijimi është i posaçëm për Të. Askush nuk mund të jetë shok i tij.



*"Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s'ka asnjë Zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin mbi njëri-tjetrin. Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!" (Mu'minin, 23/91)*

*"Nëse në qiej dhe në tokë do të kishte zota të tjerë përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe toka do të shkatërrheshin. Qoftë i lavdëruar Allahu, Zoti i Fronit dhe i lartësuar mbi çka i dedikojnë Atij!" (Enbija, 21/22)*

30

4

## Marrëdhënia iman-dije-akt

### Marrëdhënia iman-akt

Në shumicën e rasteve, mendimet, pikëvështrimet e njerëzve dhe sjelljet e tyre shfaqen si një tërësi. Mes mendimit dhe ndjenjave, ndjenjave dhe veprimeve, gjendet një marrëdhënie e afërt. Edhe për njeriun që beson duhet të ketë një marrëdhënie shumë të afërt ndërmjet imanit dhe sjelljeve, sjelljeve dhe mendimeve.

Të gjitha punët që kryen njeriu janë akte. Në fenë tonë të lartë, mes veprave që kryhen me qëllim që të fitohet pëlqimi i Allahut dhe veprave të tjera, është respektuar një dallim. Është kërkuar nga ne që të bëjmë punë të mira dhe të bukura, me qëllim që të fitohet pëlqimi i Allahut. Sjelljet konsiderohen si "vepër e mirë" vetëm kur burojnë nga imani dhe kur përpunohen me besimin.

Marrëdhëniet ndërmjet imanit dhe sjelljeve të njeriut: Në Kur'anin e Madhërueshëm, duke u cituar në shumë ajete si "ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira", aludohet se ka një marrëdhënie të afërt ndërmjet imanit dhe aktit. Sipas kësaj, nëse besimet dhe vlerat tona të gjykimit ndryshojnë në lidhje me ndonjë çështje, ndikimi i këtij ndryshimi pasqyrohet edhe te sjelljet tona.

Imani ndikon në vijimësinë e sjelljeve tona ose në braktisjen e tyre. Për shembull, një njeri që beson, disa sjellje i kryen me entuziazëm e me dëshirë, ndërsa braktis disa të tjera. Imani e tregon veten me vepra. Imani bëhet shkak për zbulimin e sjelljeve. Në këtë kuadër, veprat e mira janë frytet e imanit.

Allahu bën të ditur se do të shpërblejë ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira:



*“Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ka çdo mirësi dhe vendbanim të mrekullueshëm!” (Ra’d, 13/29)*

*“Kurse për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të ketë kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Kjo është fitorja madhështore.” (Buruxh, 85/11)*

Allahu i Lartmadhëruar bën të ditur se nuk do t’i konsiderojë të barabartë ata që besojnë dhe që sillen ashtu siç besojnë, me ata që nuk kryejnë vepra të mira:



*“Nuk janë njësoj i verbri me atë që nuk sheh; as ai që beson e bën vepra të mira, me atë që bën keq. Sa pak që mendoni!” (Mu’minun, 40/58)*



Edhe Pejgamberi ynë i dashur urdhëron kështu: “Kushdo që vendos në zemrën e tij imanin në mënyrë të sigurtë dhe e pastron veten, nëse bëhet fjalë drejtë, e çon nefsën e tij në qetësi shpirtërore, i sjell veprimet e tij të përditshme, moralin dhe sjelljet në një situatë të drejtë, ky person ka arritur në shpëtim.” (Ahmed, Musned, V/147)



#### Le të diskutojmë

Diskutoni mbi ndikimet e veprave të mira në jetën individuale dhe shoqërore, vepra këto, të cilat bëjnë që personi që i kryen, të fitojë pëlqimin e Allahut.

Meqë ndërmjet imanit dhe sjelljeve gjendet një marrëdhënie e ndërsjellë, imani ndikon në sjelljet tona, ndërsa sjelljet tona ndikojnë mbi imanin. Pejgamberi ynë urdhëron kështu:



*“Kur robi bën një gabim, në zemër i shfaqet një njollë e zezë. Nëse personi e largon nefsën nga ai gabim, kërkon falje dhe pendohet, zemra e tij pastrohet (njolla fshihet). Në të kundërt, nëse vijon të kryejë të njëjtin gjynah, njolla në zemrën e tij shtohet. Madje, pas një kohe njolla pushton të gjithë zemrën.” (Tirmidhi, Tefsir, 75 (3334, V/434)*

Edhe kjo tregon se sjelljet tona lënë shenjë te ne, me kalimin e kohës vendosen te ne dhe ndikojnë mbi sjelljet tona. Si rrjedhojë, ashtu siç nuk duhet të bëjmë keq, nuk duhet të qëndrojmë as indiferentë ndaj të këqijave.

Për këtë arsye, Pejgamberi ynë i dashur urdhëron:





*"Kushdo që sheh një punë të keqe dhe të shëmtuar, duhet ta rregullojë atë me dorë; nëse nuk është i aftë për këtë, ta rregullojë me gjuhë; nëse nuk është i aftë as për këtë, të ftohë zemrën e tij ndaj këtij veprimi. Kjo është më e pakta e imanit." (Ahmed, Musned, II/104)*

## Marrëdhënia iman-dije

Paraprakisht, imani është një lidhje ndërmjet njerëzve dhe Allahut. Te kjo lidhje, dija dhe informacioni zënë një vend të veçantë. Të besosh është një zgjedhje individuale, gjë që nënkupton se personi duhet të vendosë se çfarë të besojë duke qenë i lirë. Në këtë zgjedhje dija dhe informacioni zënë një vend të veçantë. Krijuesi ynë i Lartë na nxit të mendojmë dhe të hetojmë. Ata që janë në dijeni të rregullit në gjithësi dhe të krijimit, janë të hapur në kuptimin e ekzistencës dhe njëjesisë së Allahut. Prandaj njerëzit ftohen që të mendojnë.

Në Kur'anin e Madhërueshëm urdhërohet: "... Ai ua shpjegon njerëzve shpalljet e Veta, që ata të mendojnë." (Bakara, 2/221)



### Le të mendojmë

Në cilat çështje Allahu kërkon që të mendojmë? Përse?

32

Allahu, duke na orientuar që të mendojmë mbi gjithësinë dhe gjallesat e tjera, synon që ne të kuptojmë ekzistencën e tij. Prandaj, të mendosh dhe të marrësh dije shërben në arritjen në besim dhe në forcimin e besimit.



*"Ai ka bërë që ju ta shfrytëzoni natën dhe ditën, diellin dhe hënën. Me urdhrin e tij, edhe yjet janë vënë në shërbimin tuaj. Në të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë." (Nahl, 16/12)*

Për shkak se dija ndihmon në formimin e besimit, ajo ndihmon shumë edhe në zhvillimin dhe forcimin e tij. Për sa kohë zhvillohet niveli i dijes te njeriu, si rrjedhojë shtohet edhe forca e besimit. Në librin tonë, në Kur'anin e Madhërueshëm, urdhërohet: "A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar më këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobesimtarin)?! Thuaj: 'A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!" (Zumer, 39/9) Informohemi se do t'u jepen shpërblime të mëdha atyre që janë thelluar në dije (Nisa, 4/162). Edhe sufiu i madh, Junus Emre, në një poezi të tij e shpreh kështu marrëdhënien mes dijes dhe besimit:

Dituria është të njohësh, është veten ta kuptosh;  
nëse s'e kupton dot veten, ç'të duhet të lexosh?  
Kuptimi i leximit është që njeriu Krijuesin të dijë,  
sepse nëse lexove, por nuk di, ky një mundim i kotë është.

(Yunus Emre)



### Le të diskutojmë

Diskutoni shprehjen: "Ai që njeh veten, njeh Krijuesin".

## Besimi imitues (Taklidi)

Marrëdhënia e imanit me dijen pasqyrohet edhe në cilësinë e besimit. Nëse njeriu beson veçse me thirrjen dhe orientimin e atyre që ka përreth, besimi quhet besim imitues.

### Veçoritë e imanit imitues

- Tek imani imitues bëhet fjalë për besimin e atij individi, i cili imiton njerëzit që ka rreth vetes. Në këtë situatë, nuk bëhet fjalë për dije të thellë dhe arsyetim të bazuar në argumente.
- Edhe pse një besim i tillë është i vlefshëm, ai ka nevojë të mbështetet e të plotësohet me dije.
- Imani imitues, për shkak se nuk formohet me argumente të forta, është i hapur ndaj ndikimeve. Mund të tronditet me një kundërshtim dhe kritikë të vogël.
- Mundësia që me imanin e bazuar në një imitim të pavetëdijshëm të përzihen dyshimet dhe të ndikojnë tek ai, është shumë e lartë.
- Besimi imitues dhe fanatizmi: Për shkak se në përfitimin e besimit imitues nuk bëhet fjalë për analizë dhe hetim të mjaftueshëm, ekziston mundësia që njerëz të tillë të kenë prirje edhe ndaj fanatizmit. Sepse njerëz të këtij lloji, në vend të thelbit, mund të fokusohen në anën e jashtme.
- Imitimi i pavetëdijshëm e dërgon njeriun drejt fanatizmit.
- Ndërsa njerëzit fanatikë nuk mund të besojnë lirisht dhe nuk mund të dallojnë vetvetiu të drejtën dhe të gabuarën.

Allahu i Lartmadhëruar bën këtë paralajmërim ndaj atyre që imitojnë duke mos pasur dije:



"Kur atyre u thuhet: 'Ndiqni atë që ka shpallur Allahu!' ata përgjigjen: 'Jo! Ne do të ndjekim atë udhë, në të cilën i kemi gjetur të parët tanë! Vallë, edhe atëherë kur të parët e tyre nuk kuptonin gjë e nuk ishin të udhëzuar?!'"  
(Bakara, 2/170)

Feja jonë e lartë, imitimim e pavetëdijshëm synon ta eliminojë me studim, hetim dhe me mendim.



### Le të diskutojmë

Diskutoni dëmet e fanatizmit.

## Besimi analitik (Tahkiki)

Imani i bazuar në argumente, studim, dije, kuptim dhe perceptim, quhet besim analitik. Ky është besimi i formuar si rezultat i hetimit, studimit dhe analizimit të vetë personit. Thelbësore është që çdo musliman të jetë i vetëdijshëm për atë që beson dhe përse beson.

Allahu i Lartmadhëruar, në Kur'anin e Madhërueshëm i fton njerëzit të mendojnë, të studiojnë dhe të hetojnë.



“Është Ai që jep jetë dhe vdekje dhe Atij i përket ndërrimi i ditës dhe i natës. Vallë, a nuk kuptoni?” (*Mu'minun, 23/80*)

34

## Rëndësia e besimit analitik

- Personat që mendojnë, studiojnë, zbulojnë të drejtën dhe të vërtetën, i vendosin besimet e tyre në themele të forta.
- Njeriu është përgjegjës që, duke hetuar universin dhe krijimin, duke pasur vetëdije mbi urdhëresat dhe ndalesat e fesë, të lartësojë besimin e tij nga niveli i besimit imitues në nivelin e besimit analitik.
- Kur imani të arrijë në nivelin analitik, ndryshon edhe cilësia e marrëdhënies së personit me Allahun dhe me gjallesat e tjera. Në Kur'an, kjo situatë përcaktohet si më poshtë:



“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten.” (*Enfal, 8/2*)

Për këtë arsye duhet që ta shtojmë vazhdimisht dijen dhe informacionin tonë, në mënyrë që të vendosim mbi baza të forta besimin dhe ta zhvillojmë atë.

Sa i përket kësaj çështjeje, Pejgamberi ynë urdhëron kështu: “Mësimi i dijes është farz për çdo musliman, burrë dhe grua.” (*Ibn Maxhe, Mukaddime, 17, (224), I, 81*).



### Le të diskutojmë

Si ndihmon dija për të arritur në nivelin e imanit analitik? Diskutoni.

- Besimi imitues: Besimi i njeriut me anë të thirrjes dhe orientimit të njerëzve që ka përreth.
- Besimi analitik: Iman i bazuar në argument, studim, dije, kuptim dhe perceptim.



### Përmbledhja e kapitullit



Iman do të thotë të përvetësosh diçka me qetësi shpirtërore, ta besosh atë nga brenda dhe me zemër. Në thelb, imani është çështje zemre. Imani është i sinqertë, nga shpirti dhe nga zemra. Themeli i besimit është miratimi me zemër. Nëse ka mospranim të kushteve të imanit, ndjenjë dyshimi ndaj vërtetësisë së tyre, aty nuk bëhet fjalë për iman.

Imani dhe miratimi: Tek imani gjendet edhe pohimi me gojë i atyre që besohen. Sipas Islamit, iman do të thotë të pranosh si të vërteta ato që Hz. Muhammedi i ka sjellë nga Allahu i Lartmadhëruar dhe t'u besosh atyre me zemër.

Imani i orienton dhe ndikon te sjelljet tona. Sepse imani ka marrëdhënie të afërt me mendimin, ndjenjën dhe veprimin. Në këtë pikëpamje, imani rrethon gjithë ekzistencën tonë. Imani orienton marrëdhënien tonë me veten, njerëzit e tjerë, me gjallesat dhe me qeniet. Imani është baza e të gjitha adhurimeve dhe sjelljeve tona.

Fjala e Teuhidit është tregues i pranimit me zemër të fesë islame dhe të imanit. Ndërsa kushti i parë i të qenit musliman është pranimi i fjalës së Teuhidit. Fjala e Teuhidit është: La ilahe il'lallah Muhammedu'r-rasulullah = Nuk ka Zot tjetër veç Allahut. Muhammedi është i dërguari i tij.

Ndërsa fjala e Shehadetit është: Esh'hedu en la ilahe il'lallah ue esh'hedu enne Muhammeden abduhu ue rasuluhu = Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut. Përsëri dëshmoj se Muhammedi (s.a.s.) është robi dhe i dërguari i tij.

Në pikëpamje të besimit, njerëzit ndahen në mu'min, munafik, kafir dhe mushrik. Ndërmjet imanit dhe sjelljeve të njeriut, po ashtu edhe ndërmjet sjelljeve dhe imanit ka një marrëdhënie shumë të afërt. Sjelljet tona orientohen nga besimet dhe vlerat e gjykimit. Nëse ndryshojnë besimet dhe vlerat e gjykimit, në lidhje me çdo lloj çështje, kjo pasqyrohet edhe te sjelljet tona.

Imani është një element që ndikon në vijimësinë ose në braktisjen e sjelljeve tona. Për shembull, njeriu që beson, ndërkohë që disa sjellje i kryen me dëshirë dhe emocion, shmanget nga disa sjellje të tjera. Imani e tregon veten te veprimi. Imani bëhet shkak për zbukurimin e sjelljeve tona.

Allahu, duke na orientuar që të mendojmë mbi universin dhe gjallesat e tjera, kërkon që të kuptojmë ekzistencën e Tij. Prandaj, të mendosh dhe të marrësh të dhëna mbi krijimin dhe qeniet, na shërben që të arrijmë në besimin e vërtetë, në forcimin e besimit.

Për shkak se dija shërben në formimin e imanit, kjo kontribuon shumë edhe në zhvillimin dhe perfeksionimin e imanit. Kur niveli i dijes sonë zhvillohet, shtohet edhe forca për të besuar.

Nëse një person ka besuar veçse me thirrjen dhe orientimin e njerëzve që ka përreth, ky quhet besimi imitues (taklidi). Pra, në një iman të tillë bëhet fjalë për besim duke imituar njerëzit që personi ka përreth. Në këtë situatë, nuk ka një dije të thellë dhe një hetim racional të bazuar në argument. Një iman i tillë është i vlefshëm, por ka nevojë që të mbështetet dhe të plotësohet me dije.

Ndërsa imani i bazuar në argumente, studim, hetim, kuptim dhe perceptim, quhet iman analitik (tahkiki). Pra, është imani i formuar si rezultat i një studimi dhe hetimi. Njeriu, duke analizuar universin dhe krijimin, duke krijuar një vetëdije mbi urdhëresat dhe ndalesat, është përgjegjës që ta lartësojë imanin e tij nga imani imitues në atë analitik.

36



### Le të rishikojmë kapitullin



- 1- Shpjegoni marrëdhënien ndërmjet elementeve që përfshihen në konceptin e imanit.
- 2- Cilat janë aspektet e përbashkëta dhe të ndryshme në fjalën e Teuhidit dhe në fjalën e Shehadetit.
- 3- Si kalohet nga imani imitues (taklidi) në imanin analitik (tahkiki)? Shpjegojeni.
- 4- Si ndihmon mësimi i dijes për të arritur imanin në nivelin e imanit analitik? Shpjegojeni.



## Pyetje vlerësuese



### Pyetje vlerësuese

#### 1. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është veçori e besimtarit?

- A) Janë në gjendje përuljeje në namazet e tyre.
- B) Japin zekatin.
- C) Qëndrojnë larg punëve të padobishme dhe fjalëve boshe.
- D) Respektojnë amanetet dhe fjalët që japin.
- E) Hetojnë gabimet dhe mangësitë e njerëzve.

#### 2. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është ndër kushtet e besimit?

- A) Të falësh namaz
- B) Të besosh Allahun
- C) Të besosh ditën e ahiretit
- D) Të besosh librat
- E) Të besosh peygamberët

#### 3. Cilin nga veprimet e mëposhtme kryen personi që zgjedh fenë islame?

- A) Mban agjërim
- B) Fal namaz
- C) Shkon në haxh
- D) Jep zekat
- E) Thotë fjalën e Shehadetit

#### 4. Cila nga alternativat e mëposhtme është veçori e munafikut?

- A) Të duket sikur beson, por të mos besojë me zemër.
- B) Të miratojë me zemër dhe të pohojë me gojë.
- C) Të pranojë se Allahu ka shok dhe ortak.
- D) Të mos pranojë kushtet themelore të fesë islame.
- E) Të mos pranojë një pjesë të kushteve themelore të Islamit.

#### 5. Cila nga alternativat e mëposhtme ka të bëjë me imanin e vetëdijshëm të formuar si rezultat i studimit dhe i hetimit?

- A) Imani imitues
- B) Imani analitik
- C) Imani i arritur me eksperiencë
- D) Imani përfaqësues
- E) Imani i fituar

besim im  
besim im  
besim im



Kapitulli

3





# Marrëdhënia ndërmjet Allahut, njeriut dhe gjithësisë

1. Allahu dhe krijimi
2. Pozita e njeriut në pikëpamje të krijimit
3. Kontakti i njeriut me Allahun
4. Gjithësia në pikëpamjen e krijimit
5. Përgjegjësia e njeriut në marrëdhënien njeri-gjithësi



## RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull:

- Trajtohet marrëdhënia e Krijuesit të gjithësisë, pra marrëdhënia e Allahut me njeriun dhe botën.
- Rëndësia e krijimit nga ana e Allahut.
- Hetohet pozita e njeriut në pikëpamje të krijimit.
- Duke aluduar mbi kontaktin e njeriut me Allahun në marrëdhënien Krijues-krijesë, trajtohet mënyra se si vijon ky kontakt.
- Analizohet duaja, adhurimi dhe veprat e mira të ngjashme, të cilat janë mënyra e kontaktit të njeriut me Allahun.
- Nëpërmjet tyre theksohet se si forcohet afrimiteti i njeriut me Allahun e Lartmadhëruar.
- Pasi trajtohen veçoritë e botës në pikëpamje të krijimit, aludohet mbi përgjegjësitë dhe detyrat e njeriut në marrëdhënien njeri-botë.

## SYNIMET E KAPITULLIT

Në fund të këtij kapitulli synohet që të zotëroni aftësitë e mëposhtme:

1. Të shpjegoni qëllimin e krijimit nga Allahu.
2. Të citoni kuptimet e ajeteve në lidhje me krijimin e çdo gjëje.
3. Të shpjegoni pozicionin e njeriut në pikëpamjen e krijimit.
4. Të shpjegoni rëndësinë dhe dobritë e krijimit të kontaktit mes njeriut dhe Allahut.
5. Të shpjegoni se si mund të krijojë njeriu kontakt me Allahun.
6. Të shpjegoni se si mund të afrohem me Allahun nëpërmjet duasë.
7. Të shpjegoni se përse adhurimi dhe veprat e mira janë njëra prej rrugëve të krijimit të kontaktit me Allahun.
8. Të shpjegoni se si, nëpërmjet adhurimeve dhe veprave të mira mund të krijohet kontakt me Allahun.
9. Të jeni në dijeni se me anë të adhurimit dhe punëve të mira mund të realizojmë kontakt me Allahun.
10. Të tregoni gjithmonë kujdes në vetëdijen e të qenit vazhdimisht me Allahun.
11. Të shpjegoni, sipas Kur'anit, se si është krijuar gjithësia.
12. Të shpjegoni se përse është krijuar gjithësia.
13. Të shpjegoni rëndësinë e përgjegjësive të njeriut në marrëdhënien njeri-gjithësi.
14. Të jepni shembuj mbi përgjegjësinë e njeriut në marrëdhënien njeri-gjithësi.

## NDËRSA MËSOJMË KAPITULLIN

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e përmendura në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni çështjet që lidhen me synimet që mendoni se nuk i keni arritur.
2. Plotësojini patjetër ushtrimet dhe veprimtaritë e hetimit që jepen në këtë kapitull.

## 1

## Allahu dhe krijimi



Të krijosh do të thotë të bësh të qenësishme diçka që nuk ekziston. Allahu (xh.sh.) është krijuesi i çdo gjëje (*Zumer, 39/62*). Të gjitha gjallesat që i shohim apo nuk arrijmë t'i shohim me sy, i ka krijuar Allahu i Lartmadhëruar.



“Ne i kemi krijuar qiejt, tokën dhe gjithçka që gjendet midis tyre vetëm me urtësi. Ora (e kiametit) do të vijë me siguri, andaj ti (o Muhammed) sillu me zemërgjerësi.” (*Hixhr, 15/85*)

Krijimi i Allahut, krijesa e Allahut, krijimi i krijesave nuk ka shok dhe ortak, është i pashoq. Ai ka krijuar çdo gjë pa pasur një shembull paraprak.



“Ai është Krijuesi i qiejve dhe i tokës!” (*En’am, 6/101*)

Allahu është Zoti ynë që ka krijuar çdo gjë nga hiçi. Ai që krijon dhe që mundëson jetesën e krijesave të tij është vetëm Allahu (xh.sh.).



“Ky është Allahu, Zoti juaj. S’ka Zot tjetër të vërtetë përveç Tij, Krijuesit të çdo gjëje, andaj adhuroni vetëm Atë! Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje!” (*En’am, 6/102*)

Allahu që krijoi çdo gjë, e bëri këtë sipas një kriteri dhe ekuilibri.

“Ai ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin. Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje? Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur.” (*Mulk, 67/3-4*) Allahu e krijoi çdo gjë sipas një rregulli.

Duhet të falënderojmë Allahun për shkak se ka krijuar çdo gjë. “Lavdëro emrin e Zotit tënd, më të Lartit, që ka krijuar gjithçka dhe e ka përpjesëtuar drejt; që ka caktuar fatin e çdo gjëje dhe ia ka rrëfyer rrugën: që bën të rriten kullotat.” (*A’la, 87/1-4*)



“Ai i ka krijuar qiejt dhe tokën me të vërtetën, ju ka dhënë format tuaja dhe jua ka bërë ato të bukura; të gjithë tek Ai do të ktheheni.” (*Tegabun, 64/3*)





### Le të diskutojmë

A mund të gjeni parregullsi në univers? Diskutoni.

## 2

### Pozicioni i njeriut në pikëpamje të krijimit



Allahu, pasi krijoi sipërfaqen e tokës, qeniet frymore dhe jofrymore dhe e solli atë të përshtatshme për jetesën e njeriut, mundësoi ekzistencën e njeriut. Njeriu është krijuar në formën më të bukur. “Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer.” (Tin, 95/4)

Në Kur’an cilësohet se njeriu është krijuar nga dheu dhe se ka ardhur në këtë formë pasi ka kaluar nga disa etapa. “Një prej shenjave të Tij është se Ai ju krijoi prej dheut, pastaj, ja, tashmë ju jeni njerëz të shpërndarë në të gjitha anët.” (Rum, 30/20)

Allahu i ka dhënë njeriut, i cili ka kaluar nëpër etapa të ndryshme, gjallëri dhe jetë. “Më pas i dha trajtë dhe i fryu shpirtin e krijuar prej Tij. Ai ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrën, por pak prej jush janë mirënjohës.” (Sexhde, 32/9)



### Është radha juaj

Gjeni dhe lexoni ajetet në Kur’an, në të cilat përshkruhen etapat e krijimit të njeriut. Si për shembull: 22/5, 23/12-14, 39/6.

42



### Qëllimi i krijimit të njeriut në Kur’an

Allahu e ka krijuar njeriun dhe ka kërkuar që melekët t’i bëjnë sexhde atij. (Bakara, 2/34)

Njeriu që u krijua në formën më të bukur, duke respektuar urdhëresat dhe ndalesat e Allahut, ashtu siç mund të vijë në një pozicion më të epërt se melekët, mund të bjerë edhe në një nivel më të ulët “Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer, pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët, por, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblime të pandërprera.” (Tin, 95/4-6)

• Njeriu, në pikëpamje të krijimit, është një krijesë e lartë. Qëllimi i krijimit të njeriut shprehet kështu nga Allahu (xh.sh.): “Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë.” (Dharijat, 51/56)

Njeriu i krijuar me qëllim robërimi ndaj Allahut ka aftësi dhe potencial të drejtohet edhe nga e mira, por edhe nga e keqja. Ndërkaq, duke përdorur mendjen dhe vullnetin, njeriu mund të marrë përsipër një rol kundrejt qëllimit të krijimit. "Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar." (Isra, 17/70)



## Kontakti i njeriut me Allahun



Allahu e ka krijuar njeriun, por nuk e ka lënë atë pa mbikëqyrje. Allahu (xh.sh.) është çdo çast afër njeriut. Ndërkaq, disa njerëz mundohen ta shkëpusin lidhjen me Allahun, ose nuk janë në dijeni të lidhjes që kanë me të. Për sa kohë njeriu mundohet të afrohet me Allahun, edhe Allahu i afrohet atij.



Rasulullahu urdhëroi kështu: "Allahu thotë që: 'Unë jam ashtu siç njeriu më parafytyron mua. Kur ai më përmend Mua, unë jam bashkë me atë. Kur ai më përmend mua nga brenda, edhe unë e përmend atë nga brenda. Nëse ai më përmend Mua brenda një xhemaati, edhe unë atë e përmend në një xhemaat më të hairit se ai. Nëse ai më afrohet mua një pëllëmbë, unë afrohem drejt tij një kut. Nëse ai më afrohet mua një kut, unë i afrohem atij një pash. Nëse ai vjen drejt Meje duke ecur, unë shkoj tek ai duke vrapuar.'" (Buhari, Teuhid, 50, VII/212; Muslim, Dhikr, 2, (2675), III/2061)



### Është radha juaj

Shpjegoni përse dëshironi të krijoni kontakt me Allahun dhe përse dëshironi të orientoheni drejt Tij.



### Le të mendojmë

- Njeriu ka përgjegjësinë ta vijojë lidhjen me Allahun në një mënyrë të vetëdijshme.
- Kontakti i njeriut me Allahun mund të jetë në mënyra të ndryshme. Këto janë duaaja, adhurimi dhe veprat e mira.

## Duaja

Njëra prej rrugëve të krijimit të kontaktit me Allahun, vijimit të kësaj lidhjeje me të, ose forcimit të saj, është duaaja. Nëpërmjet duasë shprehim lidhjen tonë me Allahun, forcojmë besimin dhe dashurinë që ndiejmë për të. Në çfarëdo gjuhe dhe forme t'i bëjmë dua Allahut, ai na dëgjon neve dhe i pranon duatë tona.

“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, u përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.” (Bakara, 2/186)



### Le të diskutojmë

- Si duhet të bëjmë dua?
- Çfarë duhet të themi kur këndojmë dua? Diskutoni.

### DUAJA

Këndoj dua, e kuptoj se jam mbështetur tek ti,

largo hem nga bota, vë krahë dhe fluturoj,

nga zotëruesi i fuqisë absolute, që është i aftë për çdo gjë,

kërkoj ashtu siç më do zemra, shpresoj ashtu siç më do zemra.

Hacer AKIN (Revista e Kryesisë së Çështjeve Fetare, 109)



### Le të diskutojmë

Duke u nisur edhe nga poezia e mësipërme,

- Çfarë ndiejmë kur bëjmë dua?
- Çfarë kërkojmë nga Allahu nëpërmjet duasë? Diskutoni.

44

## Duaja dhe njeriu

- Duke kënduar dua, ndjenjat dhe mendimet tona i ndajmë me Allahun, kërkesat tona ia drejtojmë Atij. Flasin për zemërsisht dhe me sinqeritet me të.

- Krahas duasë që bëjmë kur kërkojmë ndonjë gjë prej Allahut, duhet të përpiqemi edhe vetë sa mundemi për realizimin e asaj që duam.

- Nganjëherë duatë tona mund të mos realizohen. Në raste të tilla duhet të jemi të durueshëm dhe të mos nxitohemi.

## Përse bëhet dua?

- Duatë i bëjmë si në rastet kur jemi të mërzitur, ashtu edhe në rastet kur jemi të lumtur.

- Në duatë tona duam të mirën edhe për vete, edhe për të afërmit tanë, por edhe për të gjithë njerëzit.

- Me duatë që bëjmë në çastet kur jemi të gëzuar, dëshirojmë të falënderojmë Allahun që ka mundësuar të përjetojmë këtë gëzim. Kështu shtohet dashuria jonë ndaj Zotit dhe dashuria e Zotit ndaj nesh.

- Pejgamberi ynë i dashur ka kënduar dua duke thënë:



“Falënderimet qofshin për Allahun që më ka dhënë mua shëndet në trup dhe mundësi ta përmend Atë.” (*Tirmidhi, Deavat, 20, (3401), 5/473*)

Duke kënduar dua edhe në çastet kur jemi të mërzitur, me ndihmën e Allahut fitojmë forcë shpirtërore. Kështu përfitojmë forcë dhe rezistencë në tejkalimin e vështirësive.



#### Është radha juaj

- Ndani me shoqërinë tuaj një dua që e këndoni në çastet kur jeni të gëzuar.
- Analizoni një dua që bëhet në çaste gëzimi.
- Ndani me shoqërinë tuaj një dua që e këndoni në çastet kur jeni të mërzitur.
- Analizoni një dua që bëhet në çaste mërzie.



“...O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna për sjellje të drejtë!” (*Kehf, 18/10*)

Më sipër treguam se mund të këndojmë dua në çdo kohë dhe në çdo vend. Duatë mund të bëhen pjesë e jetës së përditshme. Bëjmë dua kur ngrihemi në mëngjes, kur shtrihemi në darkë, para dhe pas ushqimit, kur sëmuremi dhe kur shërohemi, kur fillojmë një punë dhe kur e realizojmë atë.



#### Është radha juaj

- Për kë dhe çfarë dëshirash shprehni ju në duatë tuaja?
- Cilat janë duatë tuaja të përditshme?
- Gjeni shembuj duash nga Kur’ani dhe nga jeta e Pejgamberit.

## Adhurimi: kontakti ynë me Allahun

Lidhjen me Allahun e vijojmë edhe me adhurimet tona. Zoti ynë kërkon nga Ne që të bëjmë adhurim për të.



“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” (*Fatiha, 1/5*)

“...O besimtarë! Përkuluni dhe përluni në sexhde (para Allahut)! Adhuroni Zotin tuaj dhe bëni vepra të mira për të arritur shpëtimin!” (*Haxh, 22/77*)

## Robërim ndaj Allahut

Çdo punë që bëhet me vetëdijen e robërimit ndaj Allahut është një lloj adhurimi. Sepse këto punë janë bërë me qëllim që të fitojmë kënaqësinë dhe dashurinë e Allahut. Ky është kuptimi i gjerë i adhurimit. Përveç kësaj, në Kur'anin e Madhërueshëm dhe në hadithet e Pejgamberit tonë të dashur citohen disa adhurime, që duhet t'i kryejmë në kuadër të disa parimeve. Adhurimet kryesore citohen kështu në një hadith:



“Islami është themeluar mbi pesë pika:

Të besosh se nuk ka Zot tjetër veç Allahut, të pranosh se Hz. Muhammedi është i dërguari i Allahut, të falësh namaz, të japësh zekat, të shkosh në haxh, të mbash agjërim.” (Tirmidhi, Iman, 3, (2609), V/5).

Adhurimet bëhen me qëllim të robërimit ndaj Allahut, tregimit të respektit, plotësimit të urdhëresave. Duke adhuruar, shprehim falënderimin tonë ndaj Allahut, që na fal shumë mirësi.



### Le të mendojmë

- Cilët janë adhurimet e cituara në hadithe? Çfarë adhurimesh të tjera ka?
- Si ndihmojnë adhurimet në kontaktin tonë me Allahun?
- Si ndihmon falënderimi i Allahut në forcimin e lidhjes me të?

Duke adhuruar plotësojmë detyrat që kemi ndaj Allahut, bëhemi të lumtur dhe të qetë.

## Vepra e mirë

- Punët e mira dhe të bukura që kryhen me qëllim fitimin e pëlqimit të Allahut dhe të kënaqësisë së tij dhe që janë të dobishme, quhen “amel-i salih”.
- Këto lloj sjelljesh, që feja jonë i urdhëron dhe i këshillon, për shkak se janë në përputhje me imanin dhe në drejtimin që imani kërkon, janë cilësuar me fjalën salih, e cila ka kuptimin pajtues, paqësor dhe i dobishëm.
- Thelbi i veprave të mira janë adhurimet. Njësoj siç adhurimet janë vepra të mira, edhe ëndërrimet dhe sjelljet, të tilla si të jesh buzagaz me njerëzit, t'i përshëndesësh me selam ata, të ndihmosh ata që kanë nevojë, janë vepra të mira.
- Ka mjaft punë të mira. Le t'i shohim disa prej tyre duke u nisur nga hadithet e Pejgamberit tonë:



“Mirësia ndaj nënës dhe babait...” (Muslim, Iman, 36, (137), I/89)

“Të jesh buzagaz me vëllanë...” (Tirmidhi, Bir, 36, (1956), IV/340)

“Të heqësh nga rruga sende që shqetësojnë kalimtarët...” (Muslim, Iman, 12, (58), I/63)



“T’i tregosh rrugën dikujt që ka humbur...” (*Tirmidhi, Bir, 36 (1956), IV/340*)



### Le të mendojmë

Si mbetet i gjallë kontakti mes njeriut dhe Allahut, kur njeriu synon të fitojë dashurinë e Allahut në të gjitha veprat e tij?

- Allahu i Lartmadhëruar bën të ditur se do të shpërblejë ata që nuk e shkëpusin lidhjen me të duke kryer punë të mira dhe të dobishme:



“Kurse për ata, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të ketë kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Kjo është fitorja madhështore.” (*Buruxh, 85/11*)

- Veprat e mira i kryejmë me qëllim që të fitojmë kënaqësinë e Allahut.
- Kur kërkojmë kënaqësinë e Allahut, forcohet lidhja jonë me të. Allahu i shpërblen shumë ata që ruajnë lidhjen me të dhe që e forcojnë atë.

Pejgamberi ynë i dashur urdhëron kështu:



“Veprat e mira regjistrohen me më e pakta dhjetëfishin e saj, por kjo arrin deri në shtatëqind fish.” (*Ibn Maxhe, Edeb, 58, (3832), II/1556*)

“Ndër veprat që i pëlqen Allahut është veprimi, i cili qoftë edhe sadopak, është i vazhdueshëm.” (*Buhari, Iman, 32, I/16*).



### Le të mendojmë

Si ndihmojnë punët e bëra në mënyrë të vazhdueshme në mbajtjen aktive të lidhjes së njeriut me Allahun? Shpjegojeni.

## 4

### Gjithësia në pikëpamje të krijimit

## Krijimi dhe rregulli i gjithësisë

Asgjë që gjendet në gjithësi nuk ka ekzistuar vetvetiu. Allahu i Lartë, që është krijuesi i çdo gjëje, ka krijuar gjithësinë. Ai është zoti i botëve. Allahu e ka krijuar universin me një rregull.



“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për të mençurit.” (*Al-i Imran, 3/190*)

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në ndërrimin e natës me ditën, tek anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, tek uji që Allahu e zbrit prej qielli, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, te lëvizja e erërave dhe te retë që qëndrojnë ndërmjet qiellit e tokës, te të gjitha këto, pra, sigurisht që ka shenja për njerëzit e mençur.” (*Bakara, 2/164*) “Dielli dhe hëna ndjekin rrugën e caktuar.” (*Rahman, 55/5*)



## PASKA PREKUR DORA E NJË MJESHTRI

Pa hapi sytë dhe shih,  
 këta qiej porsi zambakë.  
 Pa shih rregullin në qiell,  
 paska prekur dora e një mjeshtri.  
 Mbi shkretëtirat që nuk shohin ujë,  
 mbi tokat kur bie shi,  
 mbi këta pemë që gjelbërohen,  
 paska prekur dora e një mjeshtri.  
 Mbi peshqit që bëjnë dritë,  
 mbi vullkanet flakë-flakë,  
 mbi gjethet që bien në tokë,  
 paska prekur dora e një mjeshtri.

İrfan Coşkun

(Revista e Kryesisë së Çështjeve Fetare, 78)



### Le të mendojmë

Çfarë shpjegohet në poezinë e mësipërme?

48

## Qëllimi i krijimit

Çdo gjë e krijuar ka një qëllim dhe një urtësi.



• Ai që i krijoi qiejt dhe tokën është Allahu. "Ne i kemi krijuar qiejt, tokën dhe çfarë gjendet ndërmjet tyre, me qëllim të plotë dhe me afat të caktuar. E megjithatë, mohuesit shmangen nga ajo që u është paralajmëruar (Ahkaf, 46/3)

• "Allahu i ka krijuar qiejt dhe tokën me qëllim të

plotë. Kjo është një shenjë për besimtarët!" (Ankebut, 29/44)

• Allahu e krijoi këtë gjithësi si një vend sprove për të fituar jetën e ahiretit. Universi është në shërbimin e njeriut dhe është krijuar për ta ndihmuar atë.



## Pjesë leximi

### Galaktikë e zgjedhur

Si mendoni, ç'do të ndodhte nëse bota do ta plotësonte rrotullimin rreth vetes në një kohë më të gjatë ose më të shkurtër nga tani? A do të ishin përsëri ditët 24 orë? Po sikur bota të mos ishte në madhësinë aktuale? Për shembull, nëse do të ishte sa Mërkuri, pra 8% më e vogël, ose sa Jupiteri, 318 herë më e madhe, ç'do të ndodhte?

Pa dyshim, ashtu si në krijimin e botës, asgjë nuk funksionon pa arsye, edhe madhësia, nata, dita ose pozicioni i saj në hapësirën e horizontit nuk janë të rastësishme.

Nëse koha e rrotullimit rreth vetes do të ishte ndryshe nga ç'është tani, ndoshta netët do të ishin më të gjata. Atëherë sipërfaqja e tokës do të ftohej më shumë. Ndërsa në ditët e gjata do të ngrohej më shumë. Për shkak se rrotullohet shumë ngadalë rreth boshtit të saj, do të ngjante me Mërkurin, në të cilin dallimi i temperaturave mes natës dhe ditës do të ishte 1000 gradë.

Për shkak se një botë më e vogël do të kishte edhe një gravitet më të dobët, në këtë situatë atmosfera do t'i lëshonte gazrat lehtësisht në hapësirën ajrore. Dhe kjo nënkupton një botë pa atmosferë, gjë që, qoftë edhe vetëm në imagjinatë, është diçka shumë e keqe. Ndërsa në rast se do të ishte një botë më e madhe, për shkak se do të shtohet graviteti, gazrat helmuese do të qëndronin në atmosferë dhe, atëherë, do të ishte e pamundur qoftë edhe të merrnim frymë.

Po sikur të mos ishte atmosfera? Atëherë bota jonë, ashtu si Hëna, do të kishte temperatura të larta përvëluese, deri në 120 gradë gjatë ditës dhe gjatë natës temperatura të ulëta, që do të shkonin deri në 150 gradë nën zero? Po të mos kishte atmosferë nuk do të kishte as dyoksid karboni dhe avull uji. Mosekzistenca e këtyre gazrave, që mbajnë një pjesë të rrezeve të ardhura nga Dielli gjatë ditës dhe që nuk i lëshojnë në hapësirë, do të nënkuptonte moskryerjen e detyrave të tyre. Pra, në një rast të tillë, bota nuk do të ruhej nga rrezet e diellit gjatë ditës, ndërsa gjatë natës nuk do të mund të mbante nxehtësinë e ditës.

Tani le të mendojmë sikur Dielli do të ishte më afër ose më larg botës. Nëse energjia diellore do të vinte më pak se 10% nga ajo që vjen tani, sipërfaqja e tokës do të kaplohej nga akullnaja me trashësi disa metra. Ndërsa një shtim i paktë i energjisë do të çonte në djegie të të gjitha gjallesave. Po sikur bota jonë, në orbitën e saj, të mos rrotullohej në një kënd prej 20 27' gradë, ç'do të ndodhte? Meqë stinët formohen në saje të këtij harkimi, çfarëdoj ndryshimi në kënd do të shkaktonte diferenca të mëdha të temperaturave ndërmjet stinëve. Dhe kjo nënkupton që në sipërfaqen tokësore do të kishim stinën e verës me temperatura të larta të padurueshme dhe stinën e dimrit me temperatura tepër të ulëta.

Në të vërtetë, bota jonë as nuk ngrin së ftohti, siç ndodh me Marsin, as nuk përvëlohet nga i nxehti, siç ndodh me Venusin. Pavarësisht se fqinji i saj, Hëna, "përmytet" nga gurët qiellorë dhe rrezet e dëmshme, bota jonë vazhdon të ketë një klimë të butë e të këndshme.

Sipas një rregulli të ndërtuar mbi ekuilibra shumë të ndjeshëm, çdo gjallesë kryen pa mangësi detyrën e saj. Bota rrotullohet pa pushim. Dielli lind çdo ditë. Toka gjithmonë është poshtë këmbëve tona. Ajri, të cilin do ta kuptojmë sa i rëndësishëm është vetëm kur të mos jetë, nuk na lë vetëm asnjëherë. Bota jonë, në çdo gjendje të saj, është një fole e ngrohtë dhe e gjallë, që na bën të ndiejmë pozicionin e saj të posaçëm dhe faktin që është e zgjedhur.



### Le të diskutojmë

Cilat janë pikat kyçe në krijimin e botës?

## Universi – Hapësira

Allahu ka krijuar çdo gjë për njeriun



“Është Ai që ka krijuar për ju çdo gjë që ka në Tokë. Pastaj, i është drejtuar qiellit dhe e ka rregulluar, duke e bërë atë shtatë qiej. Ai është i Dijshëm për çdo gjë. (Bakara, 2/29)

“A nuk shihni se si Allahu ua ka bërë të mundur të shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme? E, megjithatë, disa njerëz polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyesi dhe pa libër ndriçues.” (Lukman, 31/20)

“E si mund të përfitojnë ata nga këshilla, ndërkohë që më parë u pat ardhur një i Dërguar me shpjegime të qarta.” (Xhathije, 45/13)



### Le të diskutojmë

Cilat janë mirësitë që Allahu u jep njerëzve?

Duke u nisur nga ajetet e mësipërme, cilat mund të jenë “argumentet për një shoqëri që mendon”?

## 5

### Përgjegjësia e njeriut në marrëdhënien njeri-gjithësi

Bota dhe çdo gjë në të është ofruar në shërbimin e njeriut. Ndërkaq, njeriu është përgjegjës për sjelljet ndaj botës dhe të gjitha krijesave. Është përgjegjës për përdorimin në mënyrën më të dobishme të mirësive që i ka dhënë Allahu dhe për mbrojtjen e tyre. “Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur (për pasojat e kësaj përgjegjësie).” (Ahzab, 33/72)



### Le të mendojmë

Cilat mund të jenë përgjegjësitë që njeriu ka marrë mbi vete?

## Të jesh rob i Allahut

Njeriu, i cili është krijuar si rob ndaj Allahut, të gjitha marrëdhëniet me gjallesat frymore dhe jofrymore, duhet t'i ruajë brenda kësaj vetëdijeje të robërimit. Duke vepruar me vetëdijen e përgjegjësise, mirësitë që i janë dhënë duhet t'i përdorë në mënyrën më të mirë dhe më të dobishme. Ndërsa njëra prej përgjegjësisë të njeriut është të kuptojë ajetet e Allahut duke studiuar dhe hetuar sipërfaqen e tokës dhe çdo gjë, si dhe të meditojë mbi këto ajete. Njerëzit janë përgjegjës të mendojnë e të meditojnë mbi këto.



“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e natës me ditën, tek anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, tek uji që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, te lëvizjet e erërave dhe te retë që qëndrojnë ndërmjet qiellit e tokës, në të gjitha këto, pra, sigurisht që ka shenja për njerëzit e mençur.” (Bakara, 2/164)



## Përmbledhja e kapitullit



Allahu (xh.sh.) është krijues i çdo gjëje. Çdo gjë që shohim apo nuk shohim me sy, të gjitha gjallesat i ka krijuar Allahu. Krijimi dhe qenësimi nga Allahu është i pashoq. Ai ka krijuar nga hiçi, pa pasur një shembull. Allahu që ka krijuar çdo gjë, e ka bërë këtë sipas një kriteri dhe ekuilibri të caktuar. Prandaj edhe duhet ta falënderojmë pafundësisht atë.

Zoti ynë, duke krijuar tokën, të gjitha qeniet frymore dhe jofrymore, krijoi dhe njeriun, pasi përgatiti një mjedis të përshtatshëm për jetesën e tij. Njeriu, në pikëpamje të krijimit, është krijuar në formën më të bukur. Njeriu i krijuar me qëllim robërimi ndaj Allahut, ka aftësi të orientohet edhe drejt së mirës, por edhe drejt së keqes. Po ashtu, duke përdorur mendjen dhe vullnetin e tij, njeriu mund të jetojë një jetë të përshtatshme me qëllimin e krijimit.

Allahu i Lartmadhëruar e ka krijuar njeriun dhe nuk e ka lënë atë pa mbikëqyrje. Allahu (xh.sh.) është çdo çast afër njeriut. Edhe njeriu është përgjegjës për vijimin e kësaj lidhjeje me Allahun në mënyrë të vetëdijshme. Kontakti i njeriut me Allahun mund të jetë në mënyra të ndryshme. Këto mënyra janë: dua, adhurimet dhe veprat e mira.

Njëra prej metodave të krijimit të kontaktit me Allahun, vazhdimësisë ose forcimit të kësaj lidhjeje, është dua. Me duanë shprehim lidhjen tonë ndaj Allahut, forcojmë besimin dhe dashurinë që ndiejmë ndaj tij. Në çfarëdo gjuhe dhe mënyre që t’i bëjmë dua Allahut, ai na dëgjon dhe na i pranon lutjet tona. Duatë i bëjmë edhe në çaste të gëzuara, edhe në çaste hidhërimi. Kontaktin tonë me Allahun e vijnë nëpërmjet adhurimeve tona dhe veprave të mira, duke fituar kështu pëlqimin dhe kënaqësinë e Allahut.

Allahu, i cili është krijuesi i çdo gjëje, ka krijuar edhe botën. Ai është zoti i botëve. Allahu e ka krijuar këtë botë me qëllim që të fitohet jeta e ahiretit.

Bota është krijuar me qëllim që të jetë në shërbim të njeriut. Edhe njeriu është përgjegjës për ato që kryen në këtë botë. Është përgjegjës për përdorimin në mënyrë më të dobishme të mirësive që i ka dhënë Allahu dhe për mbrojtjen e tyre. Njeriu, në marrëdhënie me qeniet frymore dhe jofrymore, duhet të ketë vetëdijen e të qenit rob.



## Të rishikojmë kapitullin



1. Si është krijuar kjo botë dhe njerëzit? Analizojeni.
2. Çfarë duhet të bëjmë për të vijuar kontaktin me Allahun? Mendoni.
3. Kur e ndiejmë të nevojshme të këndojmë dua? Përse?
4. Si ndihmon kryerja e adhurimeve në forcimin e lidhjes sonë me Allahun? Shpjegojeni.
5. Përse është krijuar bota? Shpjegojeni.
6. Cilat janë përgjegjësitë e njeriut në marrëdhënien njeri-botë? Jepni shembuj.



## Pyetje vlerësuese



**1. Cila nga alternativat e mëposhtme ka të bëjë me idenë themelore të theksuar në ajetin: “Ja, pra, Zoti juaj, Allahu. Nuk ka Zot tjetër veç tij. Ai është krijuesi i çdo gjëje”?**

- A) Allahu është një.
- B) Nuk ka zot tjetër veç Allahut.
- C) Allahu ka krijuar çdo gjë.
- D) Njeriu është përgjegjës për veprimet e tij.
- E) Njeriu zotëron lirinë e zgjedhjes.

**2. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është njëra prej rrugëve të krijimit të kontaktit me Allahun?**

- A) Të bësh dua
- B) Të falësh namaz
- C) Të punosh
- D) Të lexosh Kur’an
- E) Të mbash agjërim

**3. Cila nga alternativat e mëposhtme është krijesa, për të cilën janë krijuar të gjitha krijesat?**

- A) Meleku
- B) Njeriu
- C) Xhindi
- D) Shejtani
- E) Pejgamberi

**4. Cila nga alternativat e mëposhtmet nuk është njëra prej përgjegjësive të njeriut ndaj universit?**

- A) Të ruajë krijesat e gjalla
- B) Të kuptojë ajetet e Allahut
- C) Të përdorë sa më pozitivisht mirësitë që i janë dhënë
- D) Të ndotë mjedisin
- E) Të prishë ekuilibrin e universit

**5. Cila nga sjelljet e mëposhtme është njëra prej veprave të mira?**

- A) Të bësh mirësi ndaj nënës-babait.
- B) Të jesh i buzëqeshur me vëllanë.
- C) Të ndërtosh shkollë, xhami etj.
- D) T’i tregosh udhën dikujt që e ka humbur
- E) Të tregosh mirësitë që kanë kryer njerëzit.

besimi im  
besimi im



Kapitulli

4





# Besimi në Allah

1. Ekzistenca dhe njëjësia e Allahut
2. Atributet dhe cilësitë e Allahut në Kur'an
3. Mëshira ndaj krijesave të Allahut dhe emrat e bukur që shprehin dashurinë ndaj Tij (Esmā-i Husnā)
4. Emrat e bukur të Allahut që shprehin mëshirën e Tij
5. Emrat e bukur të Allahut që shprehin forcën e Tij





## RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull trajtohen ekzistenca dhe njëjësia e Allahut, cilësitë dhe atributet e Tij.

- Krahas cilësive dhe attributeve të Allahut të Lartmadhëruar, trajtohen edhe emrat e Tij të bukur.
- Shtjellohet ekzistenca e Allahut, cilësitë dhe emrat, marrëdhënia me gjithësinë, krijimi i gjithësisë, si dhe administrimi i saj.
- Sipas fesë sonë, Islamit, Allahu zotëron cilësi të posaçme për Të dhe cilësi qenësore në aspektin e marrëdhënies me gjithësinë. Përveç kësaj, krahas këtyre cilësive, në mënyrë që njerëzit të mund ta njohin më mirë Allahun e Lartmadhëruar, e prezanton veten me emra të ndryshëm.
- Po ashtu, në këtë kapitull sqarohet edhe fakti se cilët janë emrat e Allahut dhe ç'ndikim kanë ata mbi sjelljet e njeriut.

56

## SYNIMI I KAPITULLIT

Në fund të këtij kapitulli pritet që të zotëroni aftësitë e mëposhtme:

1. Të shprehni se Allahu ekziston dhe është një.
2. Të thoni cilat janë cilësitë e Allahut.
3. Të shpjegoni cilësitë e Allahut që shprehin dashuri.
4. Të shpjegoni cilësitë e Allahut që shprehin mëshirë dhe dhembshuri.
5. Të shpjegoni cilësitë e Allahut që shprehin fuqinë e Tij.

## NDËRSA MËSOJMË KAPITULLIN

1. Mendoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të kapitullit.
2. Ripërsërisni çështjet që lidhen me synimet, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
3. Realizoni patjetër aktivitetet studimore që jepen brenda kapitullit.
4. Analizoni çfarë keni arritur nga literatura që gjendet në fund të veprës.



“Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!” (*Ihlas, 112/1*)

“Zoti juaj është një Zot i vetëm! S’ka Zot tjetër (të denjë për adhurim), përveç Atij, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!” (*Bakara, 2/163*)

# 1

## Ekzistenca dhe njëjësia e Allahut



Themeli i fesë islame, i fesë sonë, e cila është “feja e Teuhidit”, bazohet në besimin në Allah, që është Një. Si rrjedhojë, Pejgamberi ynë i dashur, Muhammedi (s.a.s.), të vërtetën e besimit e përkufizon si mëposhtë: “Të vërtetosh se nuk ka Zot tjetër veç Allahut.” (*Muslim, Iman, 8 (33), I/52*). Në Kur’an ekzistenca dhe njëjësia e Allahut përmenden gjithmonë së bashku. Ajetet e Kur’anit të Madhërueshëm, në veçanti ajetet e zbritura në periudhën e Mekës, përqendrohen mbi ekzistencën dhe njëjësinë e Allahut.

Të besosh në ekzistencën e Allahut të Lartmadhëruar është parimi i parë i të qenit besimtar. Kushtet e tjera të besimit vijnë pas këtij. “Thuaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm.’” (*Ihlas, 112/1*)

Sipas fesë islame, Allahu i Lartmadhëruar e krijoi universin në mënyrë të harmonishme deri në imtësitë më të vogla, e administron dhe është i aftë për çdo gjë. Në mënyrë që të kuptohet më mirë ekzistenca e Allahut, Allahu i Lartmadhëruar urdhëron që të shohim si është krijuar gjithësia, natyra dhe gjallesat në natyrë dhe të mendojmë mbi to.

Edhe rezultatet dhe argumentet që nxirren nga disa ngjarje në botë, tregojnë se Allahu ekziston dhe është një. Harmonia dhe rregull në funksionimin e kësaj gjithësie, krijimi i çdo gjëje në vendin e saj, rregullimi i çdo gjëje të gjallë apo jo sipas qëllimeve të tyre, janë vepër e ekzistencës dhe njëjësisë së Tij.



“Sikur në qiej dhe në tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin. Qoftë i lavdëruar Allahu, zoti i fronit dhe i lartësuar mbi çka ia veshin Atij!” (*Enbija, 21/22*)



## 2


## Cilësitë e Allahut në Kur'an



- Allahu i Lartmadhëruar, në librin e fundit hyjnor, Kur'anin e Madhërueshëm, na bën të ditur disa cilësi të tij. Allahu e prezanton veten me cilësitë e tij.
- Ai nuk ngjan me asnjë gjallesë në botën e gjallesave.
- Sipas dijetarëve islamë, Allahu është në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha krijesat.
- Kontaktin e tij me gjithësinë Allahu e realizon nëpërmjet emrave dhe cilësive të tij.
- Në saje të këtyre cilësive, ne arrijmë të njohim Allahun.

Që të arrijmë të kuptojmë se Allahu është një, i pashoq dhe i pangjashëm, duhet të njohim cilësitë e tij dhe të marrëdhënies që këto cilësi kanë me gjithësinë; si dhe të njohim mirë Krijuesin dhe cilësitë e krijesave. Në disa fe dhe vende, Allahu është cituar me cilësi të ngjashme me njeriun dhe është kërkuar që të shprehet me disa sende konkrete. Kjo është bërë shkak për formimin e idhujtarisë. Është e pamundur që njeriu të mund ta perceptojë Allahun me shqisat që zotëron. Prandaj edhe Allahu i Lartmadhëruar kërkon që ta mendojmë atë mbi cilësitë e tij. Njeriu mund ta njohë Atë vetëm me cilësitë e tij.

Cilësitë e Allahut që citohen në Kur'an dhe në hadithe, në përgjithësi klasifikohen si mëposhtë:



Kur'ani u jep përparësi cilësive individuale (dhati), duke u munduar kështu të parandalojë disa besime të gabuara në lidhje me Allahun, besime të cilat ekzistojnë para Allahut. Për këtë arsye, surja Ihlas, e zbritur në periudhën e Mekës në vitet e para të Islamit, jep të dhëna të plota mbi cilësitë individuale të Allahut. Në këtë sure urdhërohet kështu:



“Thuaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. (Nuk ka lindur fëmijë nga ai (nuk është babai i askujt). Edhe ai vetë nuk ka lindur (nuk është fëmija i askujt). Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!’” (*Ihlas, 112/1-4*)

## Cilësitë individuale (Dhati) të Allahut

Këto janë cilësi që lidhen me individualitetin e Allahut dhe na ndihmojnë të mësojmë ekzistencën dhe vërtetësinë e Allahut të Lartmadhëruar. Këto cilësi janë:

1. *Vuxhud*: është cilësia e Allahut të Lartmadhëruar, sipas së cilës Allahu ekziston. Ekzistenca e Allahut nuk është e varur nga ekzistenca e dikujt tjetër. Vetë ai është shkak për ekzistencën e tij.

2. *Kidem*: ekzistenca e Allahut nuk ka një fillim. Ai nuk ka filluar të ekzistojë më pas. Ai është i paraqenë. Pra, nuk është krijuar ndërkohë që më parë nuk ekzistonte. Sado që të mund të shkojmë drejt së shkuarës, nuk mund të imagjinohet një kohë kur Allahu nuk ka ekzistuar, “Ai është i Pari dhe i Pasmë, i Dukshmi (me argumente) dhe i Padukshmi (me sy).” (*Hadid, 57/3*)

3. *Beka*: vjen në kuptimin që ekzistenca e Allahut nuk ka fund, se Ai do të ekzistojë gjithmonë. Njësoj siç ekzistenca e Allahut nuk ka fillim, nuk ka edhe fund e përfundim. “Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.” (*Rahman, 55/26-27*)

4. *Muhalefetun lil havadis*: sipas kësaj cilësie, Allahu nuk i ngjan asgjëje në aspekt të individualitetit dhe veçorive të tij. “Asgjë nuk i shëmbëllen Atij.” (*Shura, 42/11*) Allahu është larg nga forma, koha dhe vendi. Pra, Allahu nuk mund të mendohet në asnjë formë, Ai nuk ka asnjë vend qëndrimi, Ai nuk mund të mendohet edhe si i kushtëzuar me kohën. Me Allahun nuk ngjan asgjë; Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha. Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.” (*Shura, 42/11*)

5. *Kijam Binefsihi*: të mos ketë nevojë për dikë tjetër për të ekzistuar dhe për të vijuar ekzistencën. Allahu ekziston si domosdoshmëri e individualitetit të tij. Ekzistenca e Allahut nuk është fundi apo rezultat i ekzistencës së një tjetri.

“Allahu! Nuk ka Zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përrjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje.” (*Al-i Imran, 3/2*)

6. *Uahdanijjet*: në individualitet, cilësi dhe vepra, Allahu është i pashoq, nuk ka ortak dhe të ngjashëm. “Ne kemi shpallur se: ‘S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!’” (*Enbija, 21/25*) Përsëri në suren Ihlas urdhërohet: “Thuaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!’” (*Ihlas, 112/1*)

Surja Ihlas shpjegon cilësinë uahdanijjet të Allahut dhe cilësitë e tij. Sipas kësaj sureje, Ai nuk ka ortak, djalë dhe vajzë. Ai nuk është prind. Nuk është as djali apo vajza e një gjysheje. Është i pashoq dhe nuk ka të ngjashëm.

- Nuk ka Zot tjetër veç Allahut. Të shprehësh robëri ndaj dikujt tjetër përveç Allahut, është e ndaluar në formë kategorike në besimin islam.
- Feja islame parandalon shprehjen e robërimit të një njeriu ndaj një njeriu tjetër. Adhurimin e idhujve, dukurive natyrore dhe njerëzve, që shihen te disa fe, feja islame i ka ndaluar kategorikisht. Ka konsideruar shirk adhurimin ndaj dikujt tjetër.

## Cilësitë qenësore (Thubuti) të Allahut

Këto cilësi duhet t'i dedikohen Allahut dhe shprehin veçoritë e Tij.

1. *Hajat (Jetë)*: do të thotë që Allahu është i gjallë. Fakti që Allahu ka jetë, kjo do të thotë që ai është i paraqenë, i pasqenë dhe i pavdekshëm. "Allahu është i Gjallë." (*Al-i Imran, 3/2*) Jeta e Allahut nuk ngjan me jetën kalimtare dhe materiale të krijesave. E kundërta e jetës është vdekja. Vdekja është një cilësi mangësie. Ndërsa Allahu është larg çdo mangësie. Cilësia jetë tregon që Allahu është i paraqenë dhe i pasqenë. "Mbështetu në të Gjithëjetshmin, i cili nuk vdes dhe madhëroje Atë me falënderim!" (*Furkan, 25/58*)

2. *Ilm (Dije)*: do të thotë që Allahu di çdo gjë që ka ndodhur, do të ndodhë dhe atë që ndodh. Dija e Allahut nuk është e kufizuar me një kohë dhe vend të caktuar. "Thuaju: 'Edhe nëse e fshihni atë që keni në zemrat tuaja apo e shpallni haptazi, Allahu e di atë. Ai di çfarë gjendet në qiej dhe çfarë gjendet në tokë...'" (*Al-i Imran, 3/29*) Dhënia e shpërblimit ndaj robërve të Allahut, e dënimit ndaj të këqijve, është e mundur me dijen nga ana e Tij për çdo veprim të këtyre personave.

3. *Irade (Vullnet)*: do të thotë që Allahu të shprehë dëshirën për çdo gjë, ashtu siç dëshiron. Çdo gjë që ka ndodhur dhe do të ndodhë në gjithësi, realizohet me dëshirën dhe krijimin e Allahut. Çdo dëshirë e Tij me siguri realizohet, ndërsa ajo që nuk dëshiron kurrë, nuk realizohet. "Nëse dëshirojmë të bëhet diçka, mjafton që të themi: Bëhu! dhe ajo bëhet." (*Nahl, 16/40*)

4. *Kudret (Fuqi)*: do të thotë që Allahu ka të drejtën e veprimit mbi krijesat e tij, në përputhje me vullnetin dhe dijen, zotëron forcë për të bërë dhe krijuar çdo gjë, i mjafton fuqia për të bërë dhe krijuar çdo gjë. Ky univers dhe ata që janë në të qëndrojnë përballë nesh si tregues i cilësisë fuqi të Allahut. "... Pa dyshim, Allahu është i fuqishëm për çdo gjë." (*Bakara, 2/20*)

5. *Semi' (Dëgjim)*: do të thotë që Allahu dëgjon çdo gjë. Në dëgjimin dhe shikimin e Allahut nuk përbëjnë pengesë koncepte të tilla si largësia-afërsia, fshehtësia-qartësia, errësira-ndriçimi. Ai dëgjon edhe psherëtimat brenda nesh, ato që bëjmë me zemër dhe me mendje. "Allahu dëgjon dhe sheh gjithçka." (*Haxh, 22/61*)

6. *Basar (Shikim)*: do të thotë që Allahu sheh çdo gjë. Për shikimin e Allahut largësia-afërsia, fshehtësia-qartësia, errësira-ndriçimi nuk përbëjnë pengesë. Asgjë nuk është jashtë fushës së shikimit të Tij. "... Djeni se Allahu i sheh mirë të gjitha punët që bëni ju." (*Bakara, 2/233*)

Kriteri se Allahu është Semi' dhe Basar, pra që sheh dhe dëgjon çdo gjë, përgjithësisht, në Kur'an citohet bashkërisht. Shikimi dhe dëgjimi i tij kurrë nuk ngjan me shikimin dhe dëgjimin tonë.

7. *Kelam (Fjalë)*: do të thotë të folurit e Allahut pa pasur nevojë për mjete të posaçme për njerëzit, të tilla si shkronja, zëri dhe shkrimi. "Sa i takon Musait, Allahu i ka folur atij drejtpërdrejt." (*Nisa, 4/164*) Kur'ani quhet "Kelamullah". Shpalljet hyjnore që Allahu u ka përcjellë peygamberëve, librat hyjnorë që u ka zbritur atyre, frymëzimet që u dhuron krijesave, janë të gjitha shprehje të cilësisë kelam/fjalë të Tij.

8. *Tekuin*: është cilësia krijim e Allahut. Tekuin do të thotë të nxjerrësh nga hiçi diçka që nuk ekziston, ta bashkosh atë me ekzistencën. Të gjitha veprimet e Allahut, si të krijojë, të japë risk dhe mirësi, të dënojë fajtorët, të ringjallë, të japë vdekje, lidhen me cilësinë e tij tekuin. Këto konsiderohen si vepra dhe pasqyrimi i tij. Të shpikë, të krijojë, aktualisht të formësojë, bëhen të mundura me cilësinë fuqi të Allahut. "Thuaj: 'Do t'i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë.'" (*Jasin, 36/79*)



### Emrat e bukur të Allahut që shprehin mëshirën dhe dashurinë e Tij ndaj krijesave (Esmā-i Husnā)



## Esmā-i Husnā dhe kuptimet e tyre

- Një pjesë e emrave të bukur të Allahut shprehin mëshirën dhe dhembshurinë e Allahut ndaj njeriut dhe gjallesave të tjera.
- Përmendja, citimi i shpeshtë i emrave të bukur të Allahut, lartësimi i Tij bëhet shkak që, personi që e bën këtë, me kalimin e kohës të ndikohet prej këtyre emrave dhe të zbukurohet me ta.
- Të zbukurohesh dhe të pajisesh me emrat e bukur të Allahut e bën njeriun më të pjekur, energjik dhe me moral të bukur.
- Njeriu që grumbullon në vetvete cilësitë e emrave të bukur të Allahut, lartësohet ndërmjet njerëzve më të përzgjedhur, të plotësuar dhe mes imazheve shembullore të njerëzimit. Fiton cilësinë insan-i kamil (njeri që ka arritur në afirmim dhe pjekuri).
- Shprehja "Zbukurojeni moralin me moralin e Allahut është një detyrë që ka kaluar në kulturën tonë. Me këtë kërkohet të thuhet se duhet të rregullojmë veten dhe moralin, ashtu siç dëshiron Allahu, ta zhvillojmë atë, ta pajisim nivelin njerëzor me cilësitë që përcaktohen në emrat e Tij.



"Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirreni Atë (lutjuni Atij) me to dhe largohuni nga ata që i shtrembërojnë emrat e Tij. Ata do të ndëshkohen për çfarë kanë bërë." (*A'raf, 7/180*)

"Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që çdo gjëje i jep trajtë. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti." (*Hashr, 59/24*)

Muslimanët i vendosin këto emra ndaj fëmijëve të tyre duke vendosur para emrave fjalën “Abd”, që ka kuptimin “rob”. Për shembull, Abdullah, Abdulkadir, Abdurrahman, Abdurrahim, Abdulkerim, Abdussamed.

Emrat e Allahut janë të shumtë. Në traditën islame, emrat e bukur të Allahut njihen si “Esma-i Husna”. Por, këto emra nuk janë të kufizuar me numrin 99.

## Nevojat materiale dhe shpirtërore të njerëzve

- Njerëzit kanë edhe nevoja materiale/fizike, por edhe nevoja shpirtërore.
- Nevojat materiale janë nevoja të tilla si të ngrënit-të pirit, veshja, strehimi dhe nevoja të tjera të ngjashme me këto.
- Njeriu duhet t’i përballojë nevojat materiale njësoj si ato shpirtërore, pasi edhe këto janë po aq të rëndësishme sa nevojat materiale.
- Në rast se nuk përballohen nevojat materiale, njeriu pëson rënie psikologjike dhe shpirtërore; bëhet shkatërrues dhe me kohën mund të humbasë shëndetin mendor e shpirtëror. Ndër kriteret më të rëndësishme që përballojnë nevojat shpirtërore të njeriut janë kriteret të tilla si shprehja e adhurimit ndaj Zotit, përmendja e Tij, përgjërimi dhe shprehja e duave kundrejt Tij.
- Përveç kësaj, njeriu e ka të nevojshme të shihet, të njihet, të dallohet, të dëgjohet, të duhet dhe të respektohet, t’i jepet vlerë. Të dojë dhe të duhet është ndër nevojat shpirtërore më të rëndësishme të njeriut.
- Dashuria është një ndjenjë që e orienton njeriun të tregojë interes dhe vartësi ndaj diçkaje apo dikujt që e vlerësoni.
- Krahas dashurisë, ai që duhet, shpreh një vlerë në shikimin e atij që do. Në saje të dashurisë njeriu bëhet i vetëdijshëm se është pjesë e tërësisë brenda së cilës jeton dhe ku i kushtohet rëndësi.
- Dashuri do të thotë të ndash diçka me dikë tjetër. Gjëja për të cilën njeriu ndien më shumë nevojë pas bukës dhe ujit është dashuria. Ky është ushqimi i vërtetë i shpirtit.

## Dashuria ndaj Allahut

Dashuria ndaj Allahut qëndron mbi çdo dashuri dhe është e pafund. Nëpërmjet ajeteve të mëposhtme, Allahu shpreh se sa i do njerëzit dhe se sa mëshirë e dhembshuri tregon ndaj tyre:



“Ai është Falësi i madh, i Dhembshuri.” (*Buruxh, 85/14*)

“... Dijeni se Allahu nuk ua humb besimin tuaj (d.m.th., namazin që keni falur nga Kudsi). Në të vërtetë, Allahu është i Mëshirshëm me njerëzit.” (*Bakara, 2/143*)

“Kërkoni falje nga Zoti juaj e kthehuni me pendim tek Ai. Me të vërtetë, Zoti im është Mëshirëplotë dhe gjithë dashuri.” (*Hud, 11/90*)

## Personat që do Allahu dhe ndaj të cilëve është i kënaqur

Allahu, në ajete të ndryshme në Kur'an, bën të ditur se do shumë:

- ata që bëjnë mirësi,
- ata që pendohen dhe janë të pastër,
- ata që mbajnë fjalën e dhënë,
- ata që shmangen nga rebelimi ndaj Allahut,
- ata që bëjnë harxhime në rrugë të Allahut,
- ata që nuk bien në pesimizëm dhe shprehin durim,
- ata që kryejnë sjellje të bukura,
- ata që nënshtrohen,
- ata që shprehin falje,
- ata që sillen drejt,
- ata që janë modestë,
- ata që janë të pastër,
- ata që kryejnë vepra të mira,
- ata që përpiqen për mirësi,
- ata që sillen drejt,
- ata që ruajnë forcën dhe nderin kundrejt padrejtësisë,
- ata që zotërojnë besim të pjekur,
- ata që shprehin falënderim,
- ata që janë të sinqertë
- dhe ata që duan Hz. Muhammedin.

Krahas kësaj, Allahu, kur ka dërguar peygamberët, u ka dhënë atyre edhe detyrën e përhapjes së dashurisë dhe të respektit mes njerëzve. Në veçanti, në lidhje me Pejgamberin tonë të dashur, Hz. Muhammedin, thotë kështu:



“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua do të mirën me gjithë zemër, dëshiron që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” (*Teube, 9/128*)

Allahu, pasi bën të ditur se ai vetë dhe peygamberët që ka dërguar i duan shumë njerëzit dhe gjallesat e tjera, kërkon edhe që njerëzit ta duan shumë njëri-tjetrin. Një ndër shprehjet më themelore të Islamit është se ai që nuk ndan me fqinjshëm shqetësimet e tij, ai që nuk e do fqinjin, nuk do të jetë besimtar i vërtetë.





Aty ku gjendet dashuria dhe sinqeriteti i pastër, zemrat janë të pastra, marrëdhëniet ndërnjerëzore naive dhe të sinqerta, nuk ekziston gënjeshtria; nuk është e nevojshme të ketë mllef, urrejtje dhe zemërim. Po ashtu, njëri prej argumenteve që tregon ekzistencën e Allahut është ndjenja e dashurisë që ka krijuar te ne.



“Një prej shenjave të Tij është se prej jush dhe për ju krijoi bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.”  
(Rum, 30/21)

Ndjenja e dashurisë që Allahu i fal njeriut prej kur lind është një ndër demonstrimet më të rëndësishme të dashurisë që Allahu ka për njerëzit.

Dashuria është një dhuratë e Allahut ndaj njerëzve. Ajo që i përket njeriut është ta zhvillojë këtë ndjenjë dhe t’u afrohet atyre që ka përreth me këtë ndjenjë.

Me këtë ajet, Allahu bën të ditur se dashuria rregullon marrëdhëniet ndërnjerëzore, se urrejtja shkatërron marrëdhëniet ndërnjerëzore:

64



“Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” (Al-i Imran, 3/159)

#### NË LIDHJE ME DASHURINË

Ajo që e bën njeriun njeri është dashuria, miqësia,  
më beso se fundi i kësaj udhe lumturia është,  
krijuesi e ka ndërtuar gjithësinë mbi dashuri,  
e ka zbukuruar botën me blu, jeshil dhe me të zezë!...

Mevlana, Junus, Haxhi Bektash Veliu,  
rryma më e bukur e dashurisë dhe e vëllazërisë,  
vullneti i Allahut që nga kalu belaja (krijimi i botës),  
vepra e njerëzimit është afrimiteti dhe dashuria!...

Hasan ARAL



### Le të mendojmë

Për cilat dobi të dashurisë flitet në poezinë e sipërme?

## Emrat e bukur të Allahut, që shprehin dashurinë dhe dhembshurinë e Tij

Disa nga emrat e bukur të Allahut, që shprehin dashurinë dhe dhembshurinë e Tij, si dhe kuptimet e tyre.

*AFUVV*: i mëshirshëm, falës i përhershëm, falës i atyre gjynaheve që dëshiron të falë, falës i fajeve.

*BIR*: është emri i Allahut të Lartmadhëruar, që ka kuptimin mirësi dhe bukuri, që dhuron, që ndihmon robërit. Mirësia e tij është e madhe dhe Ai dhuron shumë. Ai është që dhuron ndjenja të bukura, të tilla si mirësia.

*GAFFAR*: ka kuptimin e krijesës së lartë, që fal gjynahet e robërve dhe është falës i madh. Një ndër cilësitë e pandashme të Allahut është edhe mbulimi i gjynaheve dhe falja e tyre.

*HADI*: ai që udhëzon në rrugë të drejtë, që tregon udhën e drejtë; që krijon udhërrëfimin; që i jep sukses në veprat e mira atij që dëshiron, që u tregon udhën e drejtë robërve të tij, që bën të mundur realizimin e dëshirave të tyre.

*HALIM*: që nuk nxiton, edhe pse zotëron forcë sa t'u japë dënim gjynahqarëve, nuk nxiton dhe e vonon dënimin, duke u dhënë afat atyre.

*RAUF*: që shpreh dhembshuri, që sillet me mjaft tolerancë dhe butësi në mbajtjen përgjegjës të njerëzve.

*REZZAK*: tregon se Allahu ua jep riskun të gjitha gjallesave. Ai që krijon riskun e nevojshëm për çdo gjallesë dhe që e jep riskun me shumicë.

*TEUUAB*: mundëson që robërit të arrijnë të shprehin pendim dhe që pranon pendimet e tyre.

*UEHHAB*: nënkupton se Allahu është shumë dhurues, që fal dhe dhuron me bollëk. U jep shumë krijesave, pavarësisht se ata nuk e meritojnë.

*UEKIL*: ai që ndihmon në punët e tyre personat që rregullojnë jetën duke shprehur nënshtrim ndaj Allahut dhe ata që mbështeten tek Ai; ai që në drejtimin e tij nuk është i lidhur me asnjë kusht. I besueshëm, mbrojtës, ndihmues, zotëruar i çdo gjëje.

*UELI*: Është miku i urdhëruesve dhe njerëzve të mirë, pra i besimtarëve (ueliu i tyre), i drejton punët duke shprehur ndihmë ndaj tyre.

## 4

## Emrat e bukur të Allahut, që shprehin mëshirën e Tij



Disa nga emrat e Allahut që shprehin mëshirën e Allahut dhe kuptimet e këtyre emrave janë si më poshtë:

**RAHMET:** fjala rahmet, në aspektin e ndërtimit, ka kuptimet e mëposhtme: 'pikëllimi që ndien një gjallesë për shkak të situatës së keqe, me të cilën është përballur, shprehje mëshire dhe dhembshurie'.

Sipas Kur'anit të Madhërishëm, burimi i vërtetë i mëshirës dhe i dhembshurisë është Allahu.

Allahu e prezanton veten si zotërues të mirësisë së pafund, të dhembshurisë së pamatur, të bujarisë së pafund.

Zoti ynë i përkrah dhe i mbron vazhdimisht robërit e tij, nuk i privon mirësitë, dhurimet dhe bujarinë e Tij.

Është Ai që dëgjon gjithmonë kërkesat e robërve dhe u hap portat e mëshirës atyre që mbështeten tek Ai.



66

“Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën. Ai lëshon ujë nga qielli e nëpërmjet tij nxjerr fruta si ushqim për ju. Ai i ka vënë anijet në shërbimin tuaj, që me lejen e Tij, ju të lundroni me to nëpër dete. Ai i ka krijuar lumenjtë për dobinë tuaj.” (Ibrahim, 14/32)

Emrat që shprehin në formën më të bukur mëshirën e Allahut dhe që citohen më shumë në Kur'anin e Madhërueshëm janë Rahman (i gjithëmëshirshmi) dhe Rahim (mëshirëploti).

Në fenë islame, fillimi i çdo pune duke thënë “Bismil’lahirrahmanirrahim” (është shumë i rëndësishëm. Kjo shprehje ka kuptimin “Po filloj me emër të Allahut, që është Rahman dhe Rahim”. Kjo quhet citim i fjalës “bismil’lah”.

Të fillosh një punë duke përmendur emrat e Allahut që shprehin mëshirë, bën të mundur që të përfitohet begati nga ajo punë. Sepse fillimi i punës nga personi duke shprehur emrin e Allahut, veprimi i personit me besimin se Allahu është me të, ndihmon që ta kryejë punën në mënyrën më të bukur, më produktive, në mënyrën më të mirë dhe që të respektojë pëlqimin e Allahut në këtë punë.

**RAHMAN:** në Kur'an, pas emrit Allah, ky është emri që citohet më shumë.

Është një emër i Allahut, që tregon se Allahu është shumë i mëshirshëm, i dhembshëm. Nga pikëpamja kuptimore, kjo fjalë ka lidhje me fjalën “rahmet”, që do të thotë “dhembshuri, butësi, butësi zemre, falje, mëshirë dhe mirësi”.

Mëshira e Tij shprehet në formën e shprehjes së mirësisë ndaj të gjitha krijesave dhe dhënies së mirësive të panumërta ndaj tyre. Sepse Allahu urdhëron kështu:



“Thuaj: Ai ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën.” (En'am, 6/12)

Krahas kësaj, Allahu i Lartmadhëruar kërkon që të mos pritet kurrë shpresa nga mëshira e Tij dhe se kjo do ta çojë njeriun në rrugë të gabuara. Sepse fakti që njeriu është gjithmonë pozitiv dhe i mbushur me shpresë, është një mëshirë për të dhe një shpresë e tillë e lidh robin me Zotin.



“Ibrahimi tha: ‘E kush mund ta humbë shpresën nga mëshira e Zotit të vet, përveç atyre që janë të humbur?!’” (Hixhr, 15/56)

Mëshira e Allahut shpreh mirësinë dhe mbrojtjen hyjnore. Kjo mëshirë përqafon të gjithë universin; nuk lë mundësi për pesimizëm dhe mungesë shprese.

**RAHIM:** emri Rahim tregon se veprimet tona do të shpërblehen nga Allahu. Do të thotë se do t’u jepet shpërblimi i punës atyre që punojnë në kuadër të urdhëresave dhe pëlqimit të Allahut.

**MEXHID:** ai që është i lartë, i nderuar, që zotëron shumë mirësi dhe bujari.

**LATIF:** ai që njeh deri në pikën më të vogël nevojat e krijesave dhe që i përballon nevojat në mënyra që nuk i percepton intuita.

**SHEKUR:** ai që jep shumë shpërblim në këmbim të një mirësie të paktë.

**BASIT:** tregon se Krijuesi i Lartë, që jep çdo mirësi, që përhap mirësinë dhe mëshirën e tij mes njerëzve, është Allahu. Allahu, duke u dhënë njerëzve risk, kënaqësi, rehati dhe begati, sillet me ta me mirësi dhe mëshirë.

**MUKIT:** krijues i risqeve.

**KERIM:** zotërues i bujarisë dhe i mirësisë; që fal edhe pse zotëron mundësinë e dënimit, që fal ndjenjën e bujarisë, që plotëson premtimin e dhënë.

**UASI:** ai që zotëron shumë falje dhe mëshirë. Ai që u jep krijesave gjerësi materiale dhe shpirtërore.

**MUHSI:** ai që e di çdo gjë një më një dhe me të gjitha hollësitë.

**DHULXHELAL UE’L-IKRAM:** zotërues i ashpërsisë dhe i madhështisë. Dhurues dhe shprehës mirësie. I vetmi që është i denjë për respekt dhe që zotëron të gjitha madhësitë. Është Ai që krijon çdo nevojë trupore, në mënyrë që të gjitha gjallesat të vijnë jetesën. Ai është i ditur, shikues, dëgjues i çdo gjëje, që i mjafton forca për çdo gjë, zotëruesi i parë dhe i fundit i të gjitha krijesave, që nuk ka të shoq dhe të ngjashëm.

Zoti ynë kërkon të njihet vlera e mirësive që ofron dhe të vlerësohet ajo. Dhe ky vlerësim është falënderimi. E vetmja gjë që pret Allahu nga njeriu është të shprehë falënderim ndaj Tij. Edhe falënderimi mund të bëhet vetëm nga ata që njohin vlerën e këtyre mirësive. Nëse nuk njihet dhe mohohet vlera e mëshirës hyjnore, kjo është mosmirënjohje. Në shumë ajete, fjala mohim përdoret në kuptimin e mirënjohjes. Sepse mohim do të thotë të mos njohësh vlerën e mirësive që Allahu tregon ndaj njerëzve dhe të shprehësh mosmirënjohje ndaj mirësisë.



“Ne kemi krijuar në tokë kopshte hurmash dhe vreshta, kemi bërë të shpërthejnë në to burime uji, që ata t’i hanë frutat e tyre. Këto nuk i bënë duart e tyre; ndaj, përse nuk duan të jenë mirënjohës?!” (*Jasin, 36/34-35*)

## 5

### Emrat e bukur të Allahut, që shprehin fuqinë e tij



- Allahu, me vullnetin dhe dëshirën e Tij, ka krijuar gjithësinë, çdo gjë që është në të, ka krijuar një rregull e harmoni.
- Dielli, hëna dhe trupat e tjerë qiellorë vijojnë lëvizjet e tyre brenda një rregulli dhe një harmoni marramendëse.
- Me qëllim që të kuptohet fuqia e tij e pafund, Allahu kërkon me ngulm që të shihet çfarë gjendet në tokë e në qiell dhe që të mendojnë mbi këto.



“Është Ai që e ka shtrirë tokën, duke krijuar në të male dhe lumenj. Dhe për çdo lloj fruti, Ai ka krijuar nga një çift. Ai ka bërë që nata ta mbulojë ditën. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (*Ra’d, 13/3*)

68

**MUTEKEBBIR:** ka kuptimin se Allahu është krijues shumë i madh i çdo gjëje dhe zot i madhësisë. Madhësia është e drejta e Tij. Në individualitetin, cilësitë dhe punët e tij, Allahu është zotërues i vetëm i madhësisë në kuptim absolut. Nuk mund të bëhet fjalë për një madhësi të tillë për asnjë njeri. Dihet se sa të vegjël janë përballë fuqisë dhe madhësisë së Allahut ata që e supozojnë veten si të mëdhenj. Për zhdukjen e atyre që kaplohen në dashurinë e madhësisë, nganjëherë bëhet shkak një ngjarje shumë e vogël, madje dhe një krijesë shumë e vogël, qoftë edhe një mikrob. **KAHHAR:** është sfidues dhe i aftë për çdo gjë dhe çdo gjë është nën fuqinë e Tij.

## Ajeti Kursi

Në ajetin e njohur si “Ajeti Kursi” dhe që këndohet shpesh, Allahu e prezanton veten kështu:



“Allahu! Nuk ka Zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përvetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej e në tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd, pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursiu i Tij shtrihet mbi qiejt dhe tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!” (*Bakara, 2/255*)

**ALIJJ:** është i lartë, i madh; është më i larti në dije, gjykim, vullnet dhe në të gjitha cilësitë e tjera të larta. Çdo gjë është nën gjykimin dhe urdhrin e Tij.

**BARI:** krijimi i krijesave nga Allahu mbi një rregull të pastër dhe të shëndoshë; vjen në kuptimin që i pjek dhe i afirmon ata dhe i krijon në cilësi të ndryshme nga njëri-tjetri. Pa dyshim Allahu është ai që i zgjedh krijesat, që i rregullon dhe i formon e i krijon çdonjërin në cilësi të posaçme.

**BASIR:** ai që sheh çdo gjë në mënyrë të plotë, që u jep edhe krijesave shqisën e shikimit.

**XHAMI':** mbledhës, që gjen çdo gjë nën forcën e tij, që mbledh në çastin dhe vendin që dëshiron atë për të cilën shpreh dëshirë.

**XHELIL:** madhësia e Tij është më e lartë. Në cilësi dhe në emra, çdo madhësi i përket atij.

**HABIR:** që ka informacion për çdo gjë, për anën e brendshme dhe të jashtme të çdo gjëje, që lë pas dënimet e tyre duke u sjellë me butësi ndaj teje.

**HALIK:** është një cilësi që bën të ditur se Allahu është krijues. Ndërsa të krijosh do të thotë t'i japësh ekzistencë diçkaje, të krijosh diçka që nuk ka të ngjashme. Në këtë kuptim, nuk ka krijues tjetër përveç Allahut. Ai është Krijues i çdo gjëje. Ato që bëjnë njerëzit nuk janë krijime, janë përfitime të diçkaje të re nga gjërat që tashmë ekzistojnë.

**KABID:** Allahu është krijuesi më i lartë, zotërues i fuqisë, që zotëron fuqi të pafund, që është i aftë të bëjë çdo gjë ashtu siç dëshiron. Çdo lloj fuqie dhe force ekziston tek Ai.

**KAUI:** është zotërues i forcës madhore, i fuqishëm dhe i fortë. Çdo gjë është e pafuqishme përballë fuqisë dhe forcës së Tij.

**KAJJUM:** që është i përhershëm dhe i përjetshëm; është qenia e vetme që me fuqi dhe vullnet mund të vijoje ekzistencën e tij.

**KEBIR:** do të thotë i madh dhe i lartë. Ky emër ka kuptimin e drejtimit të çdo gjëje nën fuqinë dhe vullnetin e Tij, që merr nën gjykim dhe urdher çdo gjë.

**METIN:** është i matur, me forcë madhore, asgjë nuk është e vështirë për Të.

**MUHJI:** ringjallës, gjallërues dhe dhurues jete. Askush nuk mund t'i japë jetë atij që Ai i ka marrë shpirtin.

**MUKTEDIR:** është ai, forca e të cilit mjafton për çdo gjë, që e sjell çdo gjë në formën që dëshiron, që vepron ashtu siç dëshiron mbi ata që zotërojnë forcë.

**SHEHID:** ai që dëshmon çdo gjë, që e sheh çdo gjë ashtu siç është, që është i informuar dhe që vepron sipas kësaj.



#### **Të studiojmë – Të mësojmë**

Studioni nga Esmā-i Husnā emrat që kanë lidhje me cilësitë xhelal të Allahut!



“Është Ai që e ka shtrirë tokën, duke krijuar në të male dhe lumenj. Dhe për çdo lloj fruti, Ai ka krijuar nga një çift. Ai ka bërë që nata ta mbulojë ditën. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (Ra’d, 13/3)



## Përmbledhja e kapitullit



- Të besosh në ekzistencën e Allahut të vetëm është kushti i parë i të qenit besimtar. Në mënyrë që të kuptohet më mirë ekzistenca e Tij, duhet të shihet se si është krijuar gjithësia, natyra, çka është në natyrë, si dhe të mendohet mbi to.
- Rregulli dhe harmonia funksionale, krijimi i çdo gjëje në vendin e saj, rregullimi i krijesave të gjalla dhe jo të gjalla, sipas synimeve të tyre, është një vepër e ekzistencës dhe njëjësisë së Tij.
- Allahu mund të njihet vetëm me cilësitë e tij. Ai nuk ngjan me asnjërën nga gjallesat.
- Është e pamundur që njeriu ta perceptojë individualitetin e Allahut me shqisat që zotëron.
- Cilësitë e Allahut ndahen në dy kategori: individuale dhe qenësore.
- Allahu i do shumë krijesat që ka krijuar. Dashuria e Allahut është mbi çdo dashuri dhe është e pafund.
- Emrat e Allahut, që shprehin në mënyrën më të mirë dashurinë dhe dhembshurinë e Tij dhe që citohen më shumë në Kur’an, janë Rahman dhe Rahim.
- Allahu është një krijues shumë i madh dhe zotërues i madhështisë. Madhështia është e drejta e Tij. Asnjë prej krijesave nuk e zotëron këtë të drejtë. Në individualitetin e Tij, në cilësi dhe në punë Allahu është zotëruesi i vetëm i madhështisë absolute.

70



## Të rishikojmë kapitullin



1. Si e njohim ekzistencën dhe njëjësinë e Allahut?
2. Në sa kategori ndahen cilësitë e Allahut? Numërojeni.
3. Përmendni pesë emra që shprehin dashurinë e Allahut dhe thoni kuptimet e tyre.
4. Përmendni pesë emra që shprehin mëshirën e Allahut dhe thoni kuptimet e tyre.
5. Përmendni pesë emra që shprehin madhështinë e Allahut dhe thoni kuptimet e tyre.



## Pyetje vlerësuese



**1. Cilën nga këto alternativa shpreh ajeti i mposhtëm: "Nëse në tokë dhe në qiell do të kishte zotë të tjerë përveç Allahut, me siguri do të prishej rendi i të dyve"?**

- A) Njëjësinë                      B) Fuqinë                      C) Fjalën  
D) Mëshirën                      E) Krijimtarinë

**2. Cila nga alternativat e mposhtme është cilësi individuale e Allahut?**

- A) Jetë                              B) Dije                              C) I Paraqenë  
D) Krijim                          E) Fuqi

**3. Cila nga alternativat e mposhtme është njëra prej cilësive që shpreh dashurinë e Allahut?**

- A) Dashamirës                      B) Falës                              C) Shpagimtar  
D) Mëshirues                      E) I butë

**4. Cila nga alternativat e mposhtme është njëra prej cilësive që shpreh dashurinë e Allahut?**

- A) Mëshirues                      B) Krijues                              C) Mëshirëbërës  
D) Bujar                              E) Falës

**5. Cila nga alternativat e mposhtme është njëra prej cilësive që shpreh dashurinë e Allahut?**

- A) Uasi - I gjerë në dije dhe mëshirë                      B) Mutekebbir - Madhështor  
C) Kabd - Rrëmbyes i shpirttrave                      D) Halik - Bërës, Krijues  
E) Habir - I informuar



besimi im  
besimi im



Kapitulli


5





# Besimi te melekët

1. Veçoritë e melekëve
2. Detyrat e melekëve
3. Qenie të tjera të padukshme përveç melekëve



### RRETH KAPITULLIT

Gjithësia brenda së cilës jetojmë përbëhet nga shumë gjallesa. Disa prej tyre arrijmë t'i dallojmë me sy të lirë, ndërsa pjesën tjetër jo. Në këtë kapitull trajtohen gjallesat e padukshme.

- Po ashtu, tregohen cilësitë dhe detyrat e melekëve ndër gjallesat e padukshme.
- Përveç kësaj, pasi jepen informacione mbi krijesat e tjera të padukshme, si xhindi dhe shejtani, analizohet se cilët janë besimet besëtyte në lidhje me xhindet dhe ç'dëme shkaktjnë këto.
- Duke u bërë e ditur se si tregohet shejtani në Kur'anin e Madhërueshëm, aludohet mbi anët negative të adhurimit të shejtanit.

### SYNIMET E KAPITULLIT

Në fund të këtij kapitulli pritet të zotëroni dijet e mëposhtme:

1. Të thoni emrat e krijesave që janë të padukshme.
2. Të shpjegoni dallimet ndërmjet krijesave të padukshme.
3. Të shprehni veçoritë e melekëve.
4. Të thoni detyrat e melekëve.
5. Të perceptoni veçoritë e xhindeve duke u nisur nga Kur'ani i Madhërueshëm.
6. Të shprehni se cilat janë besimet besëtyte në lidhje me xhindet.
7. Të shpjegoni përse janë të gabuara këto besime.
8. Të kritikoni besimet besëtyte në lidhje me xhindet.
9. Të thoni veçoritë e shejtanit duke u nisur nga Kur'ani.
10. Të shpjegoni se si mund të ruhem nga shejtani.
11. Të shpjegoni përse satanizmi është një besim i gabuar

### NDËRSA MËSOJMË KAPITULLIN

Ndërsa studiojmë këtë kapitull:

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni çështjet që lidhen me ato pika, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Plotësojini patjetër ushtrimet dhe veprimtaritë analitike që jepen brenda kapitullit.
3. Studioni librat që mund të siguronin nga literatura në fund të veprës.



“Atë e mbikëqyrin melekë të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.”  
(*Tahrim, 66/6*)

# 1

## Veçoritë e melekëve



Besimi në melekë: Rreth nesh gjenden mjaft qenie të gjalla dhe sende. Një pjesë prej këtyre arrijmë t’i shohim (për shembull guri, dheu, shtëpia etj.), një pjesë tjetër mund t’i shohim vetëm me ndihmën e disa mjeteve (si mikrobi, bakteret, galaksitë etj.). Ekzistojnë edhe disa gjallesa që nuk mund t’i shohim as me sy të lirë, por as edhe nëpërmjet ndonjë mjeti. Mirëpo besojmë edhe në ekzistencën e disa gjallesave që gjenden në këtë botë dhe që nuk arrijmë t’i shohim me sy të lirë. Një kategori e këtyre gjallesave janë melekët.

Të besojmë në ekzistencën e melekëve është njëri prej kushteve themelore të Islamit. Në Kur’anin e Madhërueshëm, besimi në Allah dhe në melekë është cituar bashkërisht. Fjala melek ka kuptimin delegat, lajmëtar dhe forcë.

- Melekët janë krijesa të krijuara nga nuri (drita).
- Në Kur’an bëhet e ditur se njerëzit janë krijuar nga dheu, ndërsa xhindet dhe shejtani nga zjarri, mirëpo nuk përcaktohet qartësisht nga se janë krijuar melekët.
- Faktin që melekët janë krijuar nga drita (nuri), e bën të ditur Pejgamberi ynë i dashur (*Ahmed, Musned, VI/158; Muslim, Zuhd, 10, (60), III/2294*).




Melekët nuk hanë, nuk pinë, nuk flenë, nuk martohen dhe nuk kanë gjini  
(*Isra, 15/40; Saffat, 37/150; Zuhruf, 43/19*).

“Allahu është i Mirë me robërit e Vet dhe i jep begati kujt të dojë; Ai është i Plotfuqishëm dhe i Pushtetshëm.” (*Zuhruf, 43/19*)



## Katër melekët e mëdhenj dhe detyrat e tyre



### Ç'JANË MELEKËT?

Melekët e Allahut,  
janë krijesa prej nuri,  
kanë kapluar arshin dhe tokën,  
janë të besueshëm në shërbimin e tyre.


Nuk hanë e nuk pinë,  
e as kanë gjini,  
kufirin nuk e tejkalojnë,  
shumë detyra kanë.

(Tunçalp, 36)



### Le të mendojmë

Flisni për veçoritë e melekëve, duke u nisur edhe nga poezia e mësipërme.



## 2

## Detyrat e melekëve



- Së pari, melekët realizojnë të gjitha detyrat që u ka dhënë Allahu i Lartmadhëruar.
- Detyrë kryesore e tyre është të ndihmojnë njerëzit, të plotësojnë detyrat që u përkasin në funksionimin e gjithësisë.
- Njëri prej mjeteve të krijimit të kontaktit të Allahut (xh.sh.) me njerëzit janë melekët.
- Melekët u përcjellin peygamberëve shpalljen hyjnore.

## Xhebraili

Xhebraili është meleku i shpalljes hyjnore.



*"Me vullnetin e Tij, Ai ia dërgon melekët (Xhibrilin) me shpallje kujt të dojë prej robërve të Tij (duke u thënë): "Paralajmëroni se s'ka Zot tjetër të vërtetë përveç Meje, prandaj të më kini frikë Mua!" (Nahl, 16/2)*

**XHEBRAILI**

Është njëri ndër katër melekët më të mëdhenj,  
që është më i afërt me Zotin.

U ofron peygamberëve  
urdhëresat e Zotit.

Është lumi që mbyl në mëshirë, horizontet e tokës.

(Tunçalp, 41)

## Mikaili

Ka melekë, të cilët me urdhër të Allahut janë ngarkuar për funksionimin e sipërfaqes së tokës. Meleku i madh i ngarkuar me këtë punë është Mikaili.

**MIKAIL**

Era, shiu, begatia,  
janë fusha e shërbimit të tij.

Gjallëri fiton atdheu yt,  
ai e gjelbëron arën tënde.

Ai që e lidh riskun në vendim,  
pa dyshim që është Zoti i Madhëruar.

Ai që e mundëson këtë ndarje,  
Mikaili është pa dyshim.

(Tunçalp, 43)

## Azraili

Ka melekë që janë ngarkuar me detyrën e marrjes së shpirttrave nga Allahu. Meleku i madh i ngarkuar me këtë detyrë është Azraili.



*“Thuaju: ‘Shpirtin do t’jua marrë meleku i vdekjes, i cili është caktuar për ju, e pastaj do të ktheheni te Zoti juaj.’ (Sexhde, 32/11)*

### AZRAILI

Pa dyshim që çdo gjallesë,  
vdekjen do ta përjetojë.  
Zoti i Madhëruar urdhëron  
kthimin hyjnor.  
Pa dyshim që vdekja  
është urdhëresa e prerë e Zotit, dije.  
Për këtë shërbim të ashpër  
Azraili i ngarkuar është.

(Tunçalp, 41)

## Israfili

Njëra prej detyrave që Allahu u ka dhënë melekëve, është njoftimi i kohës kur do të fillojë ngjarja e kiametit. Meleku që do ta kryejë këtë detyrë është Israfili.



*“Dhe toka do të shndrisë me dritën e Zotit të vet dhe do të vendoset Libri (i veprave). Pastaj do të sillen pejgamberët dhe dëshmitarët e ata do të gjykohen me drejtësi, e nuk do t’u bëhet asnjë padrejtësi.” (Zumer, 39/69)*

### ISRAFILI

Edhe Israfili është një melek,  
i respektuar dhe i mbarë.  
Është përgjegjës për detyrat,  
që kanë lidhje me kiametin.  
Do të marrë urdhër,  
dhe së fundi, surin do të fryjë.  
Do të fillojë kiameti;  
ky është realiteti i padyshimtë.

(Tunçalp, 44)

## Melekët e tjerë dhe detyrat e tyre

Përveç katër melekëve të mëdhenj, të cituar më lart, ka edhe melekë të tjerë që janë ngarkuar me detyrë.

### *Melekët mbrojtës (Hafada)*

Këta melekë janë të ngarkuar me mbrojtjen e njerëzve. I orientojnë njerëzit drejt mirësisë, mundohen që t'i shmangin ata nga të këqijat. Të jemi në dijeni të faktit se pranë nesh gjenden melekë që na mbrojnë, është diçka që na fal besim, që mundëson të tregojmë kujdes në sjelljet tona. Melekët janë miq të njerëzve që i ndihmojnë ata me lejen e Allahut.



“Me të vërtetë, atyre që thonë: ‘Zoti ynë është Allahu’, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin melekët (para vdekjes) e do t’u thonë: ‘Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni xhennetit që u është premtuar. Ne jemi mbrojtësit tuaj në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër...’” (Fussilet, 41/30-31)

### *Melekët shkrues (Kiramen Katibin)*

Melekët shkrues vëzhgojnë sjelljet e njerëzve, shkruajnë si të mirat, ashtu edhe të këqijat.



“Ndonëse mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë), shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni.” (Infitar, 82/10-12)

“Dy melekë i rrinë atij nga e djathta dhe e majta.” (Kaf, 50/17)

### *Melekët pyetës (Munker-Nekir)*

Melekët pyetës janë të ngarkuar me hetimin e njerëzve në varr.



#### **Le të mendojmë**

Si ndikon te ne besimi ndaj melekëve?



## 3

## Qenie të tjera të padukshme përveç melekëve



## Xhindet në Kur'an

- Ndër krijesat që nuk arrijmë t'i shohim me sy janë edhe xhindet. Në lidhje me këto krijesa që nuk shihen me sy, ka shumë besime dhe mendime.
- Libri ynë i lartë, Kur'ani i Madhërueshëm, na lajmëron se ekzistojnë xhindet; mirëpo nuk jepen të dhëna të hollësishme se çfarë krijesash janë këta.
- Në Kur'an flitet për xhindet, madje gjendet edhe një sure e emërtuar "Xhind".
- Xhindet janë krijesa të krijuara nga Allahu. Në Kur'an urdhërohet: "Ndërsa xhindet i krijoi prej flakës së zjarrit." (*Rahman, 55/15*) Dhe nga kjo kuptohet se xhindet janë krijesa të krijuara nga zjarri.



"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë."  
(*Dharijat, 51/56*)

## 80

## Xhindet dhe pejgamberët

Edhe ndaj njerëzve janë dërguar pejgamberë.

"O grumbull i xhindeve dhe i njerëzve, a nuk ju patën ardhur të dërguar nga mesi juaj, për t'ju treguar shpalljet Tona dhe për t'ju paralajmëruar takimin me këtë ditë?" (*En'am, 6/130*)

Edhe nga xhindet ka që u besojnë paralajmërimeve të pejgamberëve e ka që nuk u besojnë.

"Thuaj (o Muhammed): 'Mua më është shpallur se disa prej xhindeve kanë dëgjuar (Kur'anin) dhe kanë thënë: 'Me të vërtetë, kemi dëgjuar një Kur'an të mrekullueshëm, i cili udhëzon në rrugën e drejtë dhe kemi besuar në të, prandaj nuk do t'i shoqërojmë më askënd Zotit tonë (në adhurim)!'" (*Xhin, 72/1-2*)

Edhe ndër xhindet ka të mirë dhe të këqij. Duhet të mbështetemi tek Allahu nga ata që janë të këqij.



## Le të mendojmë

- Çfarë mund të bëhet për t'u shmangur nga të këqijat e xhindeve?
- Shpjegoni kuptimin e sures "Nas".

## Besimet besëtyte në lidhje me xhindet

### *Thirrja e shpirtrave*

- Meqenëse xhindet janë qenie të padukshme, në lidhje me ta ka mjaft besime dhe thashetheme. Por, shumica e këtyre besimeve është besëtyte. Ne, në lidhje me xhindet dimë vetëm çka na bën të ditur Kur'ani.
- Një pjesë e besimeve besëtyte që lidhen me xhindet është thirrja e shpirtrave, falli dhe magjia.
- Disa njerëz mblidhen dhe pretendojnë se thërrasin shpirtrat, se flasin me shpirtrat, se marrin nga ata lajme në lidhje me të shkuarën dhe të ardhmen. Mundohen të rregullojnë jetesën e tyre sipas këtyre lajmeve dhe të marrin vendime.
- Në Kur'an bëhet e ditur se shpirtrat e njerëzve të vdekur nuk vijnë më në botë.
- Nuk gjendet asnjë ajet apo hadith që bën të ditur se shpirtrat e të vdekurve krijojnë kontakt me të gjallit. Prandaj, të marrësh vendime dhe të shprehësh sjellje duke u besuar të dhënave që pretendohet se janë përfituar me metodën e thirrjes së shpirtrave, është diçka e ndaluar.



## Magjia

- Sipas fesë sonë, të angazhohesh me magji dhe të kërkosh të bësh magji, është diçka e ndaluar në mënyrë kategorike.
- Pejgamberi ynë i dashur, angazhimin me magji e konsideron si një ndër gjynahet e mëdha.
- Duhet të shmangemi nga besimet besëtyte.
- Gjithmonë duhet të mbështetemi tek Allahu nga rreziqet që tejkalojnë fuqinë tonë dhe nga të këqijat e mundshme.



“Thuaj: ‘Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit, që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar, nga sherri i natës, kur kaplon terri dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji) dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë.’” (Felek, 113/1-5)

## Falli

- Fallxhorët përdorin kureshtjen e njerëzve për të mësuar të sotmen dhe të nesërmen, atë që ka për t’u ndodhur. Mashtrojnë njerëzit duke ushqyer këtë merak të tyre. Ndërkohë që është e pamundur t’i dinë ngjarjet që do t’u ndodhin njerëzve në të ardhmen.
- Madje, edhe pejgamberët mund të dinë vetëm atë që u bën të ditur Allahu. Si rrjedhojë, Hz. Nuhu, atyre që kishte përreth u thotë:



“Unë nuk ju them se kam thesarin e Allahut apo që e di të padukshmen...” (Hud, 11/31)

- Falli merr trajtën e një lloj manie, që pengon njohjen e së “vërtetës”. Duhet të jetë për këtë arsye që mjaft njerëz, të cilët veprojnë sipas atyre që thonë fallxhinjtë, mund të zhgënjehen më pas.

## Falli, abuzimi dhe keqpërdorimi

Feja jonë e ndalon angazhimin me punë të tilla si falli dhe parashikimi i fatit, po ashtu edhe angazhimin e njerëzve me punë të tilla.



“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyra nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!” (Maide, 5/90)



### Le të mendojmë

Cilët janë dëmet e magjisë?

## Shejtani në Kur'an

- Njëra prej krijesave që nuk shihen me sy të lirë është shejtani.
- Njëri prej emrave të shejtanit që citohet në Kur'an është Iblisi.
- Shejtani është një qenie, ekzistenca e së cilës njoftohet në Kur'an dhe që mundohet t'i devijojë njerëzit nga rruga e drejtë.
- Shejtani është simboli i së keqes.
- Shejtani, duke ua treguar njerëzve si të këndshme punët që bëjnë, i devijon ata nga rruga e drejtë.
- Edhe disa nga njerëzit, herë pas here mund të djallëzohen.



"Shejtani ua kishte zbukuruar veprat e veta atyre dhe i kishte shmangur nga rruga e drejtë." (Ankebut, 29/38)

- Shejtani, duke bërë që njerëzit të grinden me njëri-tjetrin dhe duke krijuar armiqësi mes njerëzve, mundohet t'i shmangë ata nga kryerja e punëve të mira.



"Vërtet, shejtani me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit..." (Maide, 5/91)

"Kjo është punë e shejtanit! Ai është armik i betuar i njeriut dhe ngatërrestar i hapur!" (Kassas, 28/15)

- "Dorëshpuarit janë vëltet vëllezërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij." (Isra, 17/27)



### Le të mendojmë

Sipas ajeteve të mësipërme, cilat janë veçoritë e shejtanit? Shpjegojini.



"Thuaju robërve të Mi që të flasin atë që është më e mira. Në të vërtetë, shejtani mbjell ngatërresa ndërmjet tyre." (Isra, 17/53)

## Mbështetja tek Allahu nga shejtani

Të besosh tek Allahu për t'u mbrojtur nga shejtani: Për t'u mbrojtur nga shejtani, i cili bën armiqësi ndaj njeriut, së pari duhet të besojmë tek Allahu dhe të mbështetemi tek Ai. Sepse ata nuk mund të bëjnë keq ndaj njerëzve që besojnë dhe mbështeten tek Allahu. Kjo situatë cilësohet kështu në Kur'an:



“Në të vërtetë, shejtani nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten te Zoti i tyre. Pushteti i shejtanit është vetëm mbi ata që i binden atij dhe adhurojnë zota të tjerë veç Allahut.” (*Nahl, 16/99-100*)

Të kryesh vepra të mira për t'u mbrojtur nga shejtani: Përveç kësaj, në të gjitha punët që bëjmë, duhet të mundohemi t'i bëjmë mirë dhe bukur, si dhe t'u përshtatemi urdhëresave dhe ndalesave të Allahut..



“O njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e shejtanit, sepse ai është në të vërtetë armiku juaj i hapur.” (*Bakara, 2/168*)

Të përdorësh mendjen dhe vullnetin për t'u mbrojtur nga shejtani: Allahu i ka dhënë njeriut mendje dhe vullnet, i ka paralajmëruar ata duke dërguar peygamberë. Njeriu, duke përdorur mendjen dhe vullnetin, mund të kryejë vepra të mira dhe të bukura, mund të qëndrojë larg të këqijave të shejtanit dhe orientimeve të tij. Për t'u mbrojtur nga të këqijat e shejtanit duhet të plotësojmë detyrat që bien mbi ne dhe të mbështetemi tek Allahu.



“Thuaj: ‘Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve, prej së keqes së cytësit që fshihet, i cili bën cytje në zemrat e njerëzve, qoftë ai (cytësi) nga xhindet, qoftë nga njerëzit.’” (*Nas, 114/1-6*)

## Adhurimi ndaj shejtanit (satanizmi)

### Shejtani

Shejtani, duke mos plotësuar urdhrin e Allahut për të kryer sexhde në krijimin e njeriut, për shkak të mendjemadhësisë së tij, është dëbuar nga xhenneti. Prandaj edhe është bërë armik me njeriun. Mirëpo njeriu nuk ka shprehur pretendim se “është zot”. Pavarësisht kësaj, disa njerëz e kanë sjellë njeriun në pozitën e shejtanit dhe kanë filluar ta adhurojnë atë.



“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuroni shejtanin, se ai është vërtet armik i hapur i juaji, por të më adhuroni vetëm Mua?! Kjo është rruga e drejtë. Sigurisht që ai (shejtani) ka shpënë në humbje një mizëri prej jush; vallë a nuk po mendoni?!” (*Jasin, 36/60-62*)

## Satanizmi

Në ditën tonë, adhurimi ndaj shejtanit emërtohet si “satanizëm”, ndërsa ata që adhurojnë shejtanin emërtohen si “satanistë”. Satanistët pranojnë shejtanin si zot dhe e adhurojnë atë. Historiku i satanizmit shtrihet deri në Mesjetë.

Në Mesjetë, në mes të shekujve 14-16, janë bërë fajtorë magjistarët për adhurimin ndaj shejtanit. Satanizmi është shfaqur për herë të parë si rebelim ndaj kishës dhe si sfidë ndaj saj.

Satanizmi kundërshton të gjitha fetë dhe vlerat e shenjta, duke filluar kryesisht nga Krishterimi; ai reagon ndaj tyre. Në ditët tona, mentalitetin e satanizmit e merr përsipër La Vej në Amerikë, në vitet 1960.

## Satanistët dhe veprimet e tyre

Satanizmi është një rrymë besëtyte, që i orienton njerëzit drejt besimeve të gabuara dhe zbatimeve të dëmshme. Satanistët orientohen drejt veprimeve çnjerëzore, të tilla si alkooli, konsumimi i lëndëve narkotike, vrasja e gjallesave, sakrifikimi i gjallesave si kurban.

Në ritualet e tyre, satanistët torturojnë kafshët dhe njerëzit. Madje, herë pas here këto tortura rezultojnë me vdekje. Ndërkohë që njëri prej synimeve të feve është të mbrojtë ekzistencën e njerëzve dhe të japë kontribut në zhvillimin e shoqërisë.



### Le të mendojmë

Ç'duhet të bëjmë për t'u mbrojtur nga rryma të dëmshme si satanizmi?





## Përmbledhja e kapitullit



Breth nesh gjenden shumë gjallesa. Një pjesë prej tyre mund t'i shohim me sy të lirë, ndërsa një pjesë tjetër nuk mund t'i shohim. Mirëpo, pavarësisht se nuk arrijmë t'i shohim me sy të lirë, besojmë në ekzistencën e tyre.

Njëra prej kategorisë së gjallesave që nuk mund t'i shohim me sy të lirë janë melekët. Fjala melek ka kuptimet e mëposhtme: delegat, lajmëtar dhe fuqi. Melekët janë gjallesa të krijuara nga nuri. Melekët janë krijesa shpirtërore, të cilat nuk hanë, nuk pinë, nuk flenë, nuk martohen dhe nuk kanë gjini.

Melekët nuk shprehin rebelim ndaj Allahut dhe i plotësojnë urdhrat e Tij pa përtesë. Ata janë të aftë të kryejnë punët më të mëdha që u jepen dhe të shkojnë në vendet më të largëta, në kohën më të shkurtër.

Melekët dhe detyrat e tyre: T'u besosh melekëve është një marrëdhënie e afërt me besimin në Kur'an dhe në peygamberë. Melekët kanë detyra të ndryshme. Së pari, ata plotësojnë në mënyrë të saktë detyrat që u jep Allahu. Ndër këto detyra, kryesorja është t'u ndihmojnë njerëzve, të kryejnë detyrat që u bien për funksionimin e gjithësisë. Meleku që u përcjell shpalljen hyjnore peygamberëve është Xhebraili. Meleku i ngarkuar me funksionimin në sipërfaqen e tokës është Mikaili. Ndërsa ai që është i ngarkuar me marrjen e shpirtave është Azraili. Meleku që lajmëron kur do të fillojë ndodhia e kiametit është Israfil. Përveç katër melekëve të mëdhenj, ka edhe melekë të tjerë. "Melekët mbrojtës" janë të ngarkuar me detyrën e mbrojtjes së njerëzve. Melekët i orientojnë njerëzit drejt mirësisë, mundohen t'i shmangin ata nga të këqijat. Të jemi në dijeni të faktit se pranë nesh gjenden gjithmonë melekë që na mbrojnë, është diçka që na fal besim, dhe kjo bën të mundur që të tregojmë kujdes në sjelljet tona.

Një tjetër kategori e gjallesave që nuk i shohim me sy janë xhindet. Në lidhje me këto krijesa, të cilat nuk i shohim me sy, gjenden mjaft besime dhe ide të ndryshme. Libri ynë i lartë, Kur'ani, na lajmëron se xhindet ekzistojnë, por nuk jep hollësi në lidhje me faktin se si janë ato. Xhindet janë krijesa të krijuara nga Allahu. Në Kur'an bëhet e ditur se xhindet janë krijuar nga zjarri. Edhe xhindet, ashtu si njerëzit, janë përgjegjës të njohin Allahun dhe të kryejnë adhurim ndaj Tij. Edhe ndër xhindet ka prej tyre që u besojnë paralajmërimeve të peygamberëve, por ka edhe prej atyre që nuk u besojnë. Mes tyre gjenden të mirë dhe të këqij. Duhet të mbështetemi tek Allahu nga ata që janë të këqij.

Ngaqë xhindet janë krijesa të padukshme, në lidhje me ta ka mjaft besime dhe thashetheme. Ne, në lidhje me xhindet u besojmë vetëm atyre që bën të ditur Kur'ani ynë. Ndër njerëzit, njëri prej besimeve besëtyte të përhapura është shikimi i fallit. Fallxhorët përdorin kureshtjen e njerëzve për të ditur të sotmen dhe të ardhmen, për të ditur atë që do t'u ndodhë. Sipas fesë sonë, të angazhohemi me magji dhe të shprehim kërkesën për ta bërë këtë, është e ndaluar rreptësisht.

Po ashtu, njëra prej krijesave që nuk shihet me sy të lirë është shejtani. Shejtani është një krijesë, për ekzistencën e së cilës njoftohemi nga Kur'ani dhe që mundohet të devijojë njerëzit nga rruga e lirë. Shejtani është simboli i së keqes. Për t'u mbrojtur nga shejtani që bën armiqësi ndaj njeriut, së pari duhet të besojmë tek Allahu dhe të mbështetemi tek Ai. Sepse atyre që besojnë dhe mbështeten tek Allahu, shejtani nuk mund t'u bëjë dëm. Por, nuk duhet të harrojmë se, herë pas here, edhe disa nga njerëzit mund të shejtanizohen.

Shejtani, duke mos plotësuar urdhrin e Allahut për të kryer sexhde në krijimin e njeriut, për shkak të mendjemadhësisë së tij, është dëbuar nga xhenneti. Prandaj edhe është bërë armik me njeriun. Mirëpo njeriu nuk ka shprehur pretendim se "është zot". Pavarësisht kësaj, disa njerëz e kanë sjellë njeriun në pozitën e shejtanit dhe kanë filluar ta adhurojnë atë. Ja, pra, të adhurosh shejtanin konsiderohet si "satanizëm", ndërsa ata që adhurojnë shejtanin emërohen si "satanistë". Satanistët e pranojnë shejtanin si zot dhe e adhurojnë atë.

Historiku i satanizmit shtrihet deri në Mesjetë. Në Mesjetë, në mes të shekujve 14-16, janë fajësuar magjistarët për adhurimin e shejtanit. Për herë të parë, satanizmi është shfaqur si rebelim ndaj kishës dhe si sfidë kundrejt saj. Satanizmi është një rrymë besëtyte që i orienton njerëzit drejt besimeve të gabuara dhe zbatimeve të dëmshme. Satanistët orientohen drejt veprimeve çnjerëzore, të tilla si alkooli, konsumimi i lëndëve narkotike, vrasja e gjallesave, sakrifikimi i gjallesave si kurban. Në rituale, satanistët torturojnë kafshët dhe njerëzit. Madje herë pas here këto tortura rezultojnë me vdekje. Ndërkohë që njëri prej synimeve të feve është të mbrojë ekzistencën e njerëzve dhe të japin kontribut në zhvillimin e shoqërisë.





## Të rishikojmë kapitullin



1. Përgatisni një tabelë ku të tregohen veçoritë e përbashkëta dhe të ndryshme të krijesave.
2. Mendoni se si mund të klasifikohen krijesat. Përcaktoni emrat e gjallesave që nuk arrini t'i shihni. Përse nuk arrijmë t'i shohim ato?
3. Cilat janë veçoritë e melekëve?
4. Çfarë ndikimi ka mbi sjelljet tona besimi në melekë? Shpjegojeni.
5. Në shoqërinë që ju rrethon, cilat janë besimet në lidhje me xhindet? Përse njerëzit orientohen drejt këtyre besimeve të gabuara? Shqyrtojini.
6. Përse satanizmi është një besim besëtyt? Shpjegojeni.



## Pyetje vlerësuese



### 1. Cila nga veçoritë e mëposhtme është një ndër veçoritë e melekëve?

- A) Janë krijuar nga nuri
- B) Të ngrënit-të pirit
- C) Të qenit mashkull apo femër
- D) Të martohen
- E) Të plaken

### 2. Te cila nga alternativat e mëposhtme bëjnë pjesë melekët që janë përgjegjës për regjistrimin e të mirave dhe të këqijave të njerëzve?

- A) Munker-Nekir
- B) Melekët mbrojtës
- C) Kiramen Katibin
- D) Xhebrail-Israfil
- E) Mikail-Azrail

### 3. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është njëra ndër veçoritë e melekëve?

- A) Të adhurojnë Allahun
- B) Të sjellin shpalljen hyjnore
- C) Të marrin në hetim njerëzit
- D) Të ndihmojnë njerëzit
- E) T'i binden Allahut

### 4. Cilat nga veçoritë e mëposhtme nuk është njëra ndër veçoritë e xhindeve?

- A) Nuk mund të shihen me sy të lirë
- B) Ka ndër ata që besojnë
- C) Ka ndër ata që nuk besojnë
- D) Janë krijuar nga zjarri
- E) Sjellin shpalljen hyjnore

### 5. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk ka të bëjë me besime besëtyte?

- A) Të kërkosh të të shohin fallin
- B) Satanizmi
- C) Të kërkosh të bëjnë magji
- D) Të këndosh dua për mbrojtje nga syri i keq
- E) Të kërkosh të bësh magji

besimi im  
besimi im



Kapitulli

6





# Besimi në libra

1. Shpallja hyjnore dhe nevoja që ndihet për të
2. Librat hyjnorë
3. Zbritja e Kur'anit
4. Shkrimi i Kur'anit dhe përgatitja e tij në trajtën e Mus'hafit
5. Modeli i njeriut që synon Kur'ani në pikëpamje të dijes
6. Modeli i njeriut që synon Kur'ani në pikëpamje të besimit
7. Modeli i njeriut që synon Kur'ani në pikëpamje të sjelljes



### RRETH KAPITULLIT

- Trajtohet çështja e besimit në libra, si një ndër kushtet e besimit në fenë tonë të lartë.
- Shpjegohet kuptimi i shpalljes hyjnore dhe përse njerëzit ndiejnë nevojë për shpalljen hyjnore.
- Jepen të dhëna në lidhje me librat hyjnorë, si Teurati, Zeburi, Ungjilli dhe Kur'ani; si dhe jepen informacione të përgjithshme.
- Shpjegohet në linjat të përgjithshme se si iu zbrit Kur'ani Pejgamberit tonë, trajtohet shkrimi i tij dhe përgatitja në formën e mus'hafit.
- Synimi i Kur'anit është t'i udhëzojë njerëzit dhe të mundësojë që të kalojnë një jetë në përputhje me pëlqimin e Allahut. Në këtë kuadër, te ky kapitull do të shqyrtohen edhe veçoritë e njeriut në pikëpamje të dijes, besimit dhe sjelljes.

92

### SYNIMET E KAPITULLIT

Në fund të këtij kapitulli synohet që të zotëroni aftësitë e mëposhtme:

1. Të thoni kuptimin e shprehjes hyjnore.
2. Të shpjgoni nevojën që ndihet për shpalljen hyjnore.
3. Të shprehni veçoritë e librave hyjnorë.
4. Të shpjgoni veçoritë e modelit të njeriut në Kur'an nga pikëpamja e dijes.
5. Të shpjgoni veçoritë e modelit të njeriut në Kur'an nga pikëpamja e besimit.
6. Të shpjgoni veçoritë e modelit të njeriut në Kur'an nga pikëpamja e sjelljes.

### NDËRSA MËSOJMË KAPITULLIN

Ndërsa studiojmë këtë kapitull:

1. Mendoni nëse i keni arritur synimet e kapitullit të përmendura në fillim të tij. Rilexojini sërish çështjet që lidhen me synimet që mendoni se nuk i keni arritur.
2. Plotësojini patjetër ushtrimet dhe veprimtaritë analitike që jepen brenda kapitullit.
3. Mos u mjaftoni vetëm me tekstin në fjalë për të mësuar mbi çështjet që trajton ky kapitull. Shqyrtoni edhe veprat që mund të arrini nga literatura që gjendet në fund të librit.



“O besimtarë! Besojini Allahut, të Dërguarit të Tij, Librit, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librit që i ka zbritur më parë...” (Nisa, 4/136)

1

## Shpallja hyjnore dhe nevoja që ndihet për të



### Shpallja hyjnore

Shpallja hyjnore ka kuptimin e të folurit fshehtazi, të njoftosh fshehurazi dhe në mënyrë të shpejtë, dërgim dhe shenjë.

- Shpallja hyjnore është rruga e përcjelljes të peygamberët, të atyre informacioneve që Allahu e shih të nevojshme.
- Njëkohësisht, këto informacione të përcjella quhen si shpallje hyjnore.
- Në Kur'an, në lidhje me çështjen e vahjit, thuhet kështu:



“Asnjë njeriu nuk i është dhënë t’i flasë Allahu, përveçse me anë të frymëzimit, pas perdes, ose me anën e një kumtuesi (meleku) të dërguar me lejen e Tij, për të shpallur vullnetin e Tij.” (Shura, 42/51)

### Kumtesa dhe thirrja hyjnore

Allahu u është drejtuar njerëzve nëpërmjet peygamberëve që ai ka zgjedhur mes njerëzve; mesazhet e tij, urdhëresat dhe ndalesat i ka transmetuar po me këtë metodë. Peygamberët e kanë transmetuar shpalljen hyjnore ashtu siç e kanë marrë nga Allahu, e kanë shpjeguar dhe i kanë treguar se si do të zbatohet.



#### Le të mendojmë

Përse Allahu u është drejtuar njerëzve me anë të shpalljes hyjnore?

### Dobitë e shpalljes hyjnore

Allahu ka mundësuar mirësi, ndihmë dhe mbështetje të madhe ndaj njerëzve, duke u dërguar shpallje hyjnore.

Informacionet e ardhura me anë të vahjit, mundësojnë që njeriu të gjejë rrugën e drejtë, të mbrohet nga gabimet; jepen parimet e një jete të lumtur, të besueshme dhe të qetë, në përputhje me vullnetin e Allahut.

Me qëllim që njeriu të mbrojë krijimtarinë naive dhe të pastër, ka nevojë për ndihmën e Allahut dhe për udhërrëfimin e tij. Allahu ia ka prezantuar njeriut veten dhe krijuesin nëpërmjet shpalljes hyjnore; e ka orientuar marrëdhënien e njeriut me Allahun dhe universin dhe i ka dhënë atij një plan për jetën.



### Le të mendojmë

Shpjegoni arsyen përse Allahu jep të dhëna në lidhje me marrëdhëniet njeri-Allah, njeri-univers dhe marrëdhënien e njerëzve me njëri-tjetrin.

## Shpallja hyjnore dhe mendja e njeriut

- Njeriu është një krijesë që zotëron mendjen. Në saje të mendjes mund të dallojë të mirën dhe të keqen, të drejtën dhe të gabuarën.
- Allahu, duke dërguar shpallje hyjnore, e ka orientuar mendjen e njeriut drejt gjërave të mira, të drejta dhe të bukura; po ashtu, edhe ka shprehur urtësitë e larta që njeriu mund të mos i gjejë me mendje.
- Njeriu mund t'i përfitojë disa gjëra në botë me mendjen dhe eksperiencën e tij dhe mund t'i zhvillojë këto.
- Shpallja hyjnore është një udhërrëfyes jete; është tërësia e vlerave të larta, të nevojshme që jeta të jetë në përputhje me vullnetin hyjnor.
- Shpallja hyjnore jep vlera paragjyquese mbi fjalët, sjelljet e njeriut dhe të shoqërisë, madje edhe për synimet e tyre; tregon se tek Allahu ata janë të mira ose të këqija, të drejta ose të gabuara.
- Duke qëndruar brenda këtyre vlerave që shpall vahji, njeriu me moral të bukur e modelon veten në trajtën e një krijese të virtytshme.

94



### Le të mendojmë

Si kontribuon shpallja hyjnore në virtytshmërinë e njeriut?

## Shpallja hyjnore dhe marrëdhënia botë-ahiret

- Shpallja hyjnore jep të dhëna edhe në lidhje me ekzistencën e Allahut, krijimin e botës, jetën pas vdekjes dhe krijesat shpirtërore.
- Këto çështje, që tejkalojnë forcën perceptuese të njeriut, mund të kuptohen në saje të vahjit. Kështu, njeriu kupton se e vërteta është shumë më tutje asaj që vëzhgohet dhe, jeta, në përputhje me vullnetin hyjnor, përparon në rrugën e arritjes së kuptimit dhe synimit të vërtetë.
- Përveç kësaj bote, njeriu ka edhe jetën e ahiretit. Njeriu e ka të pamundur që, nëpërmjet mendjes, të perceptojë informacione në lidhje se me çfarë do të përballet ai në jetën e kësaj bote dhe situatat, me të cilat do të përballet këtu, sipas përfitimeve në këtë botë.
- Për çështje të tilla si ringjallja pas vdekjes, dita e kiametit, gjykimi, xhenneti, xhennemi, apo çështje të tjera, burimi i informacioneve është shpallja hyjnore.
- Njeriu që pajiset me informacione në jetën e kësaj bote, me sjelljet në përputhje me këtë, jo vetëm zbukuron botën, por mund të fitojë edhe lumturinë e ahiretit, që është botë e pafund.

## 2

## Librat hyjnorë



## Besimi te librat


- T'u besosh librave është një ndër kushtet themelore të fesë sonë të lartë.
- Besimi te librat nënkupton dërgimin e librave nga Allahu kundrejt një pjese të pejgamberëve dhe të besosh se të gjitha këto janë të drejta e të vërteta.
- Librat hyjnorë janë librat që u janë dërguar njerëzve nëpërmjet pejgamberëve nga Allahu, ku përfshihen të dhëna, urdhëresa dhe ndalesa që Allahu ua bën të ditur njerëzve.
- Quhen ndryshe edhe libra qiellorë. Në këta libra është përdorur gjuha e shoqërisë brenda së cilës jetonin pejgamberët (*Ibrahim, 14/4*).
- Synimi themelor i librave hyjnorë është që, duke siguruar pëlqimin e Allahut, të bëjë të lumtur njerëzit në jetën e botës dhe të ahiretit. Çdonjëri prej tyre është një udhëzues që u tregon njerëzve rrugën e drejtë.
- Edhe pse librat hyjnorë janë dërguar në kohë dhe në shoqëri të ndryshme, të pashtrembëruar dhe të pandryshuar, thirrja e të gjithëve është në të njëjtin drejtim.
- Synimi përfundimtar i këtyre librave është t'i bëjnë njerëzit zotërues të një besimi të fuqishëm, të një sjelljeje të drejtë, t'u krijojë mentalitetin e një marrëdhënieje që bazohet në të drejtë dhe në të vërtetë, si dhe t'i bëjë ata zotërues të moralit të bukur.
- Kur'ani pranon se para tij janë dërguar edhe libra të tjerë hyjnorë. Jep edhe të dhëna në lidhje me këta libra.
- Në pikëpamje të të qenit shpallje hyjnore të Allahut, nuk ka asnjë dallim ndërmjet varianteve origjinale të librave hyjnorë.
- Kur'ani bën të ditur se përkrahësit dhe vartësit e këtyre librave i kanë shtrembëruar ata më pas.
- Urdhëron që t'u besojmë të gjithë atyre librave në formën që kanë ardhur nga Allahu:



“Ai të ka shpallur ty Librin, me të vërtetën e saktë, duke vërtetuar shpalljet e mëparshme. Më parë Ai ka zbritur Teuratin dhe Ungjillin, si udhërrëfyes për njerëzit dhe ka zbritur edhe Dalluesin (e së vërtetës nga e pavërteta).”  
(*Al-i Imran, 3/3-4*)



Librat hyjnorë, sipas vëllimeve të tyre, ndahen në dy grupe: në suhuf (fletë) dhe në libra.



96

## Suhuf

Ka kuptimin e fletëve të një libri ose të fletëve prej pergamene. Kur’ani aludon edhe mbi suhufin e Hz. Ibrahimit (*Nexhm, 53/37; A’la, 87/19*).

Transmetohet se numri total i fletëve të dhëna ndaj disa pejgamberëve është 100 dhe se ndër këta 10 i janë dhënë Ademit, 50 Shitit, 30 Idrisit dhe 10 Ibrahimit, mirëpo asnjëra prej këtyre fletëve nuk ka arritur në ditët e sotme (*Sujuti, ed-Durru’l-Mensur, VIII/489*).


## Libri

Në krahasim me suhufin libër quhet tërësia e shpalljeve hyjnore me shumë fletë, që mund t’u japë përgjigje nevojave të bashkësive më masive, të cilat jetojnë në një gjeografi të gjerë dhe në një rreth social të gjerë. Në fjalor, kuptimi i Librit është ai i shkrimit dhe i dokumentit të shkruar. Ngaqë hebrenjve dhe të krishterëve u është dërguar libër, ata janë quajtur si ehli kitap. Numri i librave është katër dhe, sipas radhës së zbritjes, janë: Teurati, Zeburi, Ungjilli dhe Kur’ani. Kur thuhet librat qiellorë, së pari kuptohen këta katër libra.



### Le të mendojmë

Përse Allahu u ka dërguar njerëzve libër në periudha periodike?



## Teurati

- Libri i Teuratit u është dërguar njerëzve nëpërmjet Hz. Musait.
- Fjala Teurat ka kuptime si: ligji, ligji i shenjtë, urdhër dhe udhëzues. Ai quhet edhe Ahd-i Atik, që do të thotë Dhiata e Vjetër.
- Teurati është shkruar në ibranisht, por është përkthyer edhe në gjuhë të tjera.

## Kapitujt e Teuratit

Teurati përbëhet nga pesë kapituj, të cilët citohen më poshtë në mënyrë të përmblodhur:

1. Tekuin: në këtë pjesë trajtohet njeriu i parë dhe krijimi i universit, tufani i Hz. Nuhut, jeta e Hz. Jusufit në Egjipt, ardhja e fisit izraelit në Egjipt dhe gjynahu i parë që kryen njeriu.
2. Huruxh/Dalja: këtu tregohen vështirësitë që përjeton fisi izraelit, shfaqja e Hz. Musait dhe kalimi i tyre nga Egjipti në Sina.
3. Levitiku: flitet mbi detyrat e klerikëve fetarë hebrenj, rregullat fetare dhe morale të tyre. Jepen të dhëna në lidhje me shlyerjen e gjynaheve, ushqimet që janë të ndaluara, me pastërtinë, martesën, ritualet fetare, bajramet dhe zotimet.
4. Numrat: tregohen jeta dhe ngjarjet që përjetuan izraelitët në shkretëtirë.
5. Ligji i përtërirë: në këtë pjesë përfshihen këshillat që Hz. Musai u dha hebrenjve para se të vdiste, vdekja e Hz. Musait, varrimi dhe zia e mbajtur në lidhje me të.

Në Kur'an bëhet e ditur se Teurati është njëri prej librave që Allahu ua ka dërguar njerëzve për të treguar udhën.

## Zeburi

- Zeburi është libri që iu dërgua Hz. Davudit (*Isra, 17/55*).
- Fjala Teurat vjen në kuptimin e librit dhe të letrës.
- Gjuha e Zeburit është ibranishtja.
- Zeburi, si më i vogli i librave hyjnorë nga pikëpamja e numrit të faqeve, ndryshe nga Teurati, nuk ka sjellë dispozita fetare.

- Zeburi përbëhet nga lëvdatat ndaj Allahut, ndjenjat e falënderimit, fjalët e urta, këshillat morale dhe ilahi.
- Aktualisht, Zeburi është përfshirë brenda Dhiatës së Vjetër në emrin Psalmet. Psalme është emri i dhënë ndaj çdonjëres prej sureve të Zeburit dhe këndohet në formën e ilahive.
- Hebrenjtë dhe të krishterët këndojnë pjesë nga psalmet gjatë adhurimeve.

## Ungjilli

- Libri që iu dërgua Hz. Isait është Ungjilli.
- Fjala Ungjill ka kuptimin lajm i mirë, sihariq dhe mësimdhënës.
- Gjuha e kopjes më të vjetër të Ungjillit dhe që gjendet në dorë të të krishterëve është në greqishte.
- Me kalimin e kohës u shfaqën qindra kopje të Ungjillit. Ungjijtë që pranon sot shumica e botës së krishterë janë katër: Mateu, Marku, Luka dhe Gjoni.
- Në ungjij përfshihen çështje të tilla si jeta e Hz. Isait, mrekullitë e tij, dashuria, drejtësia dhe modestia.
- Nga pikëpamja e të treguarit të tërësisë së traditës së shpalljes hyjnore, në Ungjill spikasin këto fjalë:

98



“Mos mendoni se kam ardhur për të shfuqizuar Ligjin e Shenjtë dhe fjalët e pejgamberëve. Unë nuk erdha të shfuqizoj, por të plotësoj.” (*Mateu, 5:17*)

- Kur’ani bën të ditur se në periudhën kur erdhi, Ungjilli ka qenë një udhëzues dhe këshillë për ata që donin të gjenin rrugën (*Maide, 5/46*).

## Kur’ani i Madhërueshëm

- Fjala Kur’an ka kuptimin të lexosh, të mbledhësh dhe të bashkosh. Është emri i librit tonë të shenjtë: “Ky është vërtet një Kur’an i nderuar.” (*Uakia, 56/77*)
- Ai është burimi themelor i fesë sonë dhe i fundit i librave hyjnorë.
- Ngaqë gjuha e shoqërisë ku jeton Pejgamberi ynë i dashur është arabisht, edhe Kur’ani është zbritur në arabisht:



“Dhe kështu, pra, Ne të kemi shpallur ty një Kur’an në gjuhën arabe, për të paralajmëruar popullin e Mekës dhe ata rreth saj.” (Shura, 42/7)

## Përse përmendet me emrin ‘Kur’an’?

Njëra prej arsyeve të dhënies së emrit Kur’an ndaj librit tonë është fakti se në të bashkohen shpalljet hyjnore, prej të cilave formohet, por edhe ngaqë mban në vetvete thelbin e të gjithë librave që Allahu ka dërguar më parë.

## Emrat e tjerë të Kur’anit

Janë emrat Kitap, Furkan (Dallues), Huda (Udhëzues në rrugën e drejtë), Tenzil (Zbritje), Kelamullah (Fjalë e Allahut), Bejan (Shpallje), Shifa (Shërim) dhe Mubin (I qartë).



### Të shqyrtojme – Të mësojmë

Përse i janë dhënë Kur’anit këto emra? Diskutoni.

## Kur’ani dhe brendia e tij

Libri ynë i lartë, Kur’ani, përbëhet nga suret dhe ajetet. Gjatësia e sureve dhe e ajeteve është e ndryshme nga njëra-tjetra.

## Çështjet themelore të Kur’anit

Çështjet themelore të Kur’anit janë Allahu, gjithësia, krijimi, besimi, morali, adhurimi, dija, tregimet mbi pejgamberët dhe popujt e shkuar, urdhëresat, ndalesat dhe këshilla ndaj sjelljeve të njeriut.

- Kur’ani është mrekullia më e madhe e Pejgamberit tonë.
- Kur’ani është një udhëzues jete. Kur’ani e udhëzon njeriun në marrëdhëniet me Allahun, gjithësinë dhe njerëzit e tjerë. Kur’ani i orienton njerëzit drejt së mirës dhe së bukurës, u jep këshilla, i përkujton dhe i paralajmëron. Shpjegon të vërtetat, i ndriçon ato dhe na ndihmon t’i japim kuptim jetës sonë.



“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kur’anin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.” (Hixhr, 15/9)



### Të studiojmë – Të mësojmë

Argumentoni faktin që Kur'ani është mrekulli dhe shqyrtoni oratorinë në të. Flisni për dashurinë, gëzimin dhe entuziazmin e muslimanëve të parë ndaj Kur'anit!



## Zbritja e Kur'anit



- Kur'ani i është zbritur Pejgamberit tonë, Hz. Muhammedit, nëpërmjet shpalljes hyjnore.
- Shpallja hyjnore, e cila filloi të zbresë në Mekë, vijoi në Medine dhe zgjati për 23 vjet, deri kur vdiq Pejgamberi ynë.
- Gjatë këtij procesi, ajetet kanë zbritur mbi një ngjarje, një pyetje, kanë zbritur për të nxjerrë Pejgamberin nga një situatë, brenda së cilës ka qenë i përfshirë, ose mbi një problem që duhej të zgjidhej për muslimanët.

## Ajetet që zbritën në Mekë

- Ajetet që zbritën në Mekë, në përgjithësi janë të shkurtra dhe të përmbledhura. Këto ajete përmbajnë fjalë me ngarkesa të pasura kuptimore.
- Në këto ajete trajtohen në mënyrë intensive kushtet e besimit, njëjësia e Allahut, solidariteti, qëndrimi larg idhujtarisë dhe moralit të shirkut, ringjallja, gjykimi i njeriut për ata që kryen dhe çështje të tjera të ngjashme me këto.
- Në këto ajete parashtrohen edhe besimet dhe mendimet e gabuara të idhujtarëve.
- Përveç kësaj, jepen tregimet e pejgamberëve të mëparshëm, skenat e kiametit, xhennetit dhe të xhehennemit.
- Ajetet që zbritën në Mekë, në përgjithësi fillojnë me fjalët: "O njerëz!"

## Ajetet që zbritën në Medine

- Ajetet që zbritën në Medine janë më të gjatë dhe shoqërohen me më shumë shpjegime në krahasim me ata që zbritën në Mekë.
- Kryesisht, në këto ajete bëhen të ditura adhurimet që duhet të kryejnë muslimanët, parimet që duhet të respektohen në marrëdhëniet me njerëzit.
- Edhe thirrja në këto ajete, në përgjithësi bëhet në trajtën: "O besimtarë!"



### Të studiojmë – Të mësojmë

Shpjegoni se nga sa fletë, ajete dhe sure përbëhet Kur'ani!



“Ky është vërtet një Kur'an i nderuar.” (Uakia, 56/77)

## Zbritja e Kur'anit në trajtën e ajeteve

Shoqëria është formuar në përputhje me proceset e mesazheve që u përhapën në gjithë jetën e Pejgamberit tonë, Hz. Muhammedit. Kjo situatë ka mundësuar lehtësime në kuptimin dhe zbatimin e parimeve që ka sjellë Kur'ani. Nëse Kur'ani do të zbritej njëherësh, muslimanët, në një moment do të hynin nën një përgjegjësi të madhe dhe nuk do të mund ta përballonin dot.



“Jobsimtarët thonë: ‘Përse Kur'ani nuk është shpallur i tëri përnjëherë?!’ Ne ta kemi shpallur kështu për të forcuar zemrën tënde dhe ta kemi zbuluar qartazi varg pas vargu.” (Furkan, 25/32)



### Është radha juaj

Shpjegoni dobitë e zbritjes së Kur'anit pjesë-pjesë.

Njohja e procesit të zbritjes së Kur'anit është një ndihmë e madhe në kuptimin e drejtë të ajeteve. Disa ajete ose sure kanë zbritur në bazë të një ngjarjeje a pyetjeje. Prandaj edhe është shumë e rëndësishme të dihet se në ç'mjedis, për cilat sjellje dhe persona kanë zbritur ajetet.

## 4

### Shkrimi i Kur'anit dhe përgatitja e tij në trajtën e Mus'hafit



## Pejgamberi ynë, Hz. Muhammedi dhe procesi i vahjit

- Pejgamberi ynë (s.a.s.) i ka kushtuar shumë rëndësi mësimit përmendësh dhe shkrimit të vahjit që i vinte.
- Ai, kur vinte shpallja hyjnore, thërriste menjëherë një nga sahabet që dinte shkrim-lexim dhe urdhëronte shkrimin e ajeteve të ardhura.
- Individët që shkruan ajetet e ardhura të Kur'anit quhen daktilografë të vahjit.



- Pejgamberi ynë nuk u mjaftua vetëm me mësimin përmendësh të Kur'anit, por i ruajti edhe të gjitha pjesët e vahjit, shkrimin e të cilave e urdhëroi.

- Edhe daktilografët kanë shkruar nga një kopje të ajeteve dhe sureve që kishin hedhur në shkrim dhe e kanë mësuar përmendësh atë.

- Në procesin e zbritjes së Kur'anit, këto shpallje hyjnore që erdhën pjesë-pjesë, jo vetëm janë shkruar nga shumë sahabe, por edhe është mësuar përmendësh gjithë Kur'ani dhe janë formuar qindra hafizë. Nëpërmjet metodës së shkrimit dhe të mëimit përmendësh, Kur'ani është marrë nën një mbrojtje të dyfishtë.

## Shkrimi i Kur'anit

Duke qenë se ndër arabët që jetonin në zonën e Hixhazit në atë periudhë, shkrimleximi nuk ishte shumë i

përhapur, materialet e shkrimit nuk ishin zhvilluar shumë dhe ishin mjaft të kufizuara.

- Kur'ani shkruhej mbi lëkurë të hollë, degë hurme me lëvore të qëruar, gurë të bardhë dhe të sheshtë, klavikula, copa dërrasash, të cilat atë kohë përdroreshin në vend të letrës dhe ishin të volitshme për të shkruar mbi ta.

- Gjithë Kur'ani është shkruar sa që gjallë Pejgamberi, vendet e ajeteve dhe sureve janë radhitur e përpiluar në formën që ka treguar ai. Ngaqë ardhja e vahjit vijoi pothuajse deri në çastet e fundit të jetës së tij, Kur'ani është sjellë në formën e mus'hafit kur ai ishte gjallë dhe nuk është arritur të përgatitet në formën e librit.

## Bashkimi i Kur'anit

- Pas vdekjes së Hz. Pejgamberit, në periudhën e Hz. Ebu Bekrit, duke u bashkuar pjesët e Kur'anit, mbi të cilat ishte shkruar me materiale të ndryshme shkrimi, teksti u përgatit në formën e mus'hafit dhe u mor nën mbrojtje duke u shkruar mbi të njëjtin material shkrimi.

## Përgatitja e Kur'anit në trajtën e një libri

- Kopja e Kur'anit që u përgatit me një kujdes të madh në trajtën e një libri, nën kryesinë e Zejd b. Thabitit, ndër daktilografët e Kur'anit, pas vdekjes së Hz. Ebu Bekrit i është dorëzuar kalifit të dytë, Hz. Omerit dhe më pas i është dorëzuar bashkëshortes së Pejgamberit, Hz. Hafsës.

## Kopjimi/shumimi i Kur'anit

- Procedura e shumimit të kopjeve të Kur'anit është realizuar në periudhën e kalifit të tretë, Hz. Osmanit. Si rezultat i zgjerimit të gjeografisë islame dhe i shtimit në numër të muslimanëve, në këtë periudhë u shfaqën disa forma të ndryshme të leximit, gjë që e bëri më të vlitshme leximin në arabisht. Për këtë arsye dhe arsye të tjera të ngjashme, unanimiteti i muslimanëve mbi një kopje dhe pranimi i kësaj kopjeje nga të gjithë muslimanët, pa dallim, mori trajtën e detyrimit në aspekt të vendosjes së qetësisë dhe harmonisë shoqërore.

## Shkrimi i Kur'anit

- Hz. Osmani, duke marrë për bazë kopjen që gjendej te Hz. Hafsa, me qëllim që të mundësonte unitetin e leximit ndër muslimanët, urdhëron një komision të përzgjedhur, brenda të cilit gjendej edhe Zejd b. Thabiti, që ta shkruajnë dhe kopjojnë atë. Thuhet se numri i këtyre ishte njëqind e pesëdhjetë. Njëra prej kopjeve është lënë te Hz. Osmani në qytetin e Medines.

## Shpërndarja e Kur'anit

- Edhe kopjet e tjera u shpërndanë në Mekë, Basra, Kufe, Damask, Jemen dhe Bahrej, si vendbanime të rëndësishme. Numri i kopjeve u shtua shpejt pas shumimeve që u bënë këta. Kur'ani, që sot gjendet në duart e muslimanëve në të gjithë botën, është i njëjtë me kopjet, shkrimin dhe shumimin e të cilave e ka urdhëruar Hz. Osmani dhe ka arritur në ditët e sotme pa pësuar asnjë ndryshim.





## 5

## Modeli njerëzor që synon Kur'ani në pikëpamje të dijes



Allahu e ka pajisur njeriun me disa aftësi, që nuk gjenden te gjallesat e tjera me të cilat jeton në univers, duke filluar që nga mendja. Arsyeja kryesore e konsiderimit si të lartë dhe të vyer të njeriut në Kur'an, lidhet me aftësinë e mendimit, kuptimit, perceptimit dhe të marrjes së informacionit.

Në sajë të dijes që e bën të përzgjedhur njeriun, ka urdhëruar që krijesat frymore dhe jofrymore përreth, t'i shërbejnë njeriut dhe i ka orientuar ato drejt dobive të tyre. Dija shfaqet nga marrëdhënia mes qenies së njohur dhe njeriut të ditur ose objektit të njohur dhe njeriut të ditur. Dija prodhohet për të gjetur të vërtetën, për të lehtësuar jetën e njeriut, për të arritur në perfeksionim nga çdo pikëpamje. Si rezultat i kësaj, edhe individi, edhe shoqëria bëhen të virtytshme.

### Urtësitë e dijes

- Dija që e çon njeriun drejt urtësisë zgjidh lidhjet që pengojnë njohjen e vetë personit dhe të Zotit.
- Duke e liruar atë nga krijesat dhe nga dëshirat epshore, e drejton drejt së vërtetës absolute.
- Për sa kohë njeriu pajiset me dije, përfiton mundësinë e vlerësimit në formë të drejtë të ekzistencës.
- Dija mundëson zgjidhjen e problemeve individuale, shoqërore dhe ekzistenciale.
- Dija e shpëton njeriun nga mosekzistenca.
- Kur'ani i bën thirrje njeriut t'i vërë veshin dijes që përputhet me gjykimin e shëndoshë, tërheq vëmendjen mbi shoqëritë imitative që bien në mohim nga besimi, mendimi dhe veprimi i pabazuar në dije. (*Shih Bakara, 2/170*)

### Nxitja e Kur'anit për informim

Kur'ani nxit dijen që e çon njeriun tek e vërteta, që jep kontribut ndaj pjekurisë morale dhe tërheq vëmendjen në përgjegjësinë e personave që zotërojnë dije:



“Thuaj: ‘A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?!’ (*Zumer, 39/9*)

Kur'ani, i cili i jep një rëndësi të veçantë aspektit moral të dijes, angazhohet veçanërisht me faktin se për ç'synim duhet të përfitohet dija.



“Për ata që besojnë në atë që të është shpallur ty (o Muhammed), në atë që është shpallur përpara teje dhe që me bindje i besojnë jetës tjetër.”  
(*Bakara, 2/4*)

Në Kur'an dija lëvdohet, ndërsa padija paraqitet si negative. Kur'ani e lëvdon dijen dhe atë që di. Ajetet që zbritën së pari urdhërojnë dijen dhe të diturin, mësimnxënien dhe mësimdhënien, e vendos theksin veçanërisht mbi lapsin që përfaqëson dijen dhe informimin (*Alak, 96/3-4*). Kur'ani aludon se takvaja e bazuar në dije dhe informacion, është ndër kriteret më të para të epërsisë ndër njerëzit.

Kur'ani urdhëron shmangien e njerëzve nga injoranca. Vetë Kur'ani e shpreh se duhet të mbështetemi tek Allahu nga qëndrimi në injorancë e pa dije, që të mos përfshihemi në grupin e injorantëve dhe të kthejmë fytyrë nga ata (*shihni Bakara, 2/67; Hud, 11/46; En'am, 6/35; A'raf, 7/199*). Kjo sepse injoranca, në pikëpamje të mungesës së dijes dhe të aspekteve morale, njëkohësisht do të thotë të mos shohësh të vërtetat me këmbëngulje dhe të sillesh indiferent. Injorancë është edhe mbyllja e vetvetes ndaj të vërtetave.

## Tërësia e dijes dhe e sjelljes në Kur'an

Libri ynë, Kur'ani, thekson se dija dhe sjellja duhet të jenë në një përputhje të plotë. Njeriu i ditur nënkupton njeriun që sillet në përputhje me ato që di. Njeriu që Kur'ani e tregon si model në pikëpamje të dijes, është njeriu që përvetëson dijen. Ata që nuk arrijnë të hyjnë në rrugën që tregon dija, kritikohen në Kur'an ngaqë nuk arrijnë të mbajnë mbi vete përgjegjësinë që ngarkon dija dhe ngaqë sillen në mospërputhje me ato që dinë (*Teube, 9/34*).

Në Kur'an thuhet se ata që e njohin siç duhet Allahun janë vetëm njerëz dijetarë. Në saje të kësaj forcohet besimi i njeriut në Allah dhe ata janë më të afërt me Të: “... Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...” (*Fatir, 35/28*)

## Marrëdhënia dije-besim në Kur'an

Edhe ndaj marrëdhënies së afërt ndërmjet dijes, besimit dhe çështjes se dija e ka të nevojshme besimin, Kur'ani vendos një theks të veçantë: “Mirëpo të thelluarit në dituri prej tyre (hebrenjve) dhe besimtarët besojnë në atë që të është shpallur ty (o Muhammed) dhe në atë që është shpallur para teje.” (*Nisa, 4/162; Al-i Imran, 3/7*)

Qoftë këshillat e Kur'anit, që janë udhëzuese kundrejt atyre që njohin përgjegjësinë ndaj Allahut, ashtu edhe mësimet e tij, mund t'i kuptojnë dijetarët.





“Këta shembuj Ne ua paraqesim njerëzve, por ata nuk i kupton kush, përveç dijetarëve.” (*Ankebut, 29/43*)

“Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë.” (*Rum, 30/22*)

“Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët.” (*Fatir, 35/28*)



## Modeli i njeriut që synon Kur’ani në pikëpamje të besimit



### Paralajmërimet e Kur’anit

- Kur’ani, në mënyrë që njerëzit të arrijnë në udhë të drejtë dhe në shpëtim, në mjaft ajete bën të ditur se ata duhet të përvetësojnë besimin e drejtë dhe se duhet të qëndrojnë larg nga çdo besim besëtyt apo i pabazë.
- Edhe synimi i thirrjeve që kanë realizuar të gjithë pejgamberët në historinë e njerëzimit është që t’i udhëzojnë njerëzit drejt besimit të drejtë.
- Besimi që shtrihet në themelin e dijes së shëndoshë, të drejtë dhe të besueshme, e çon njeriun drejt sjelljes së drejtë.

### Dija dhe besimi i shëndoshë

- Ata që mendojnë drejt, zotërojnë dije dhe besim të shëndoshë, do të mund të shohin të drejtën dhe të vërtetën. Edhe kjo aftësi mund të arrihet me anë të bashkimit dije-besim.
- Së pari, duhet të njihen gjërat që duhet të besohen, pastaj të bëhet fjalë për besim. Për këtë arsye, Kur’ani u bën thirrje njerëzve që të mendojnë, të hetojnë dhe të jenë zotërues të dijes mbi krijesat dhe ngjarjet (*shih Xhathije, 45/3-4*). Nga ana tjetër, është e qartë se vetëm dija nuk është e mjaftueshme në formimin e besimit.

### Besimi dhe zgjedhja e lirë

- Për besimin, krahas dijes nevojitet edhe një zgjedhje e lirë. Sepse besimi, si në lidhjen e posaçme mes Allahut dhe njeriut, varet nga zgjedhja e njeriut, pranimi dhe varësia.

### Besimet dhe përgjegjësitë

- Kemi detyrimin të jemi të vetëdijshëm ndaj detyrave dhe përgjegjësiive që na ngarkon besimi ynë, si dhe të plotësojmë ato që nevojiten. Nëse nuk veprojmë kështu, besimi mbetet vetëm në fjalë dhe nuk pasqyron moralin tonë. Në këtë

pikë shfaqet rëndësia e hyrjes në zemër të besimit dhe vendosjes së tij aty (*shih Huxhurat, 49/14*).

- Të jesh zotërues i besimit të vërtetë është diçka që realizohet bashkë me tërësinë dhe unifikimin e besimit me fjalët dhe sjelljet. Nga ky aspekt, Kur'ani thekson marrëdhënien e afërt ndërmjet besimit dhe veprës së mirë (*shihni Buruxh, 85/11; Fussilet, 41/33; Asr, 103/3*).



### Le të mendojmë

Lexoni ajetet dhe suret, numrat e të cilave janë cituar më lart!

Në pikëpamje të besimit, Kur'ani e ka përshkruar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme modelin e njeriut besimtar që synon. Njeriu që arrin të mbrojë boshtin dije-besim-vepër dhe që e shndërron atë në praktikë jetësore, është njeriu shembull. Në lidhje me ajetet që shprehin disa cilësi të besimtarëve të vërtetë në Kur'an, mund të jepen si shembuj ajetet e mëposhtme.

## Modeli njerëzor që synon Kur'ani



"Ata besojnë Allahun dhe ditën e kiametit, e urdhërojnë të mirën, e ndalojnë të keqen dhe nxitojnë për të bërë punë të mira. Këta janë ndër të drejtët." (*Al-i Imran, 3/114*)

"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten." (*Enfal, 8/2*)

"Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre, të cilët shmangen nga fjalët e kota, të cilët japin zekatin, të cilët e ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)." (*Mu'minun, 23/1-5*)

## 7

### Modeli i njeriut që synon Kur'ani në pikëpamje të sjelljes



## Kur'ani këshillon drejtësinë dhe mirësitë

- Kur'ani jep urdhra dhe këshilla që bëjnë të drejta, të bukura dhe të dobishme mendimet, ndjenjat dhe sjelljet tona.
- Njeriu që i formëson sjelljet në kuadër të shpjegimeve, paralajmërimeve dhe urdhëresave, fiton kënaqësinë e Allahut dhe arrin në lumturinë e vërtetë.



- Feja jonë synon atë njeri, i cili në thelb, në fjalë dhe në sjellje është i drejtë, që është përfaqësuesi i së drejtës dhe i virtytit dhe që bie në përputhje me të. Sepse një person, tek i cili ka mospërputhje ndërmjet besimeve dhe sjelljeve, nuk mund të arrijë në qetësinë e vërtetë dhe e humbet respektin dhe besueshmërinë kundrejt njerëzve.



### Le të mendojmë

Përse nuk është i qetë njeriu që ka mospërputhje ndërmjet besimit dhe sjelljes?

Njeriu që tregohet si model në pikëpamje të sjelljeve, me shprehjen e Kur'anit është njeri vepërmirë, është zotërues i veprave të mira dhe lëvdohet në shumë ajete:



“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: ‘Unë, me të vërtetë jam musliman?’” (*Fussilet, 41/33*)

108

Në mjaft ajete të librit tonë të lartë, Kur'anit, besimi dhe vepra e mirë përmenden bashkërisht. Sepse sjellja që parashtrahet në kuadër të besimit tregon lidhjen e njeriut me besimin dhe sinqeritetin e tij. Persona të tillë Allahu do t'i përqafojë me dashuri dhe do të vendosë dashuri në zemrat e tyre (*shih Merjem, 19/96*). Ata janë persona që meritojnë vlerësimin me shpërblim të Allahut:



“Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira ka çdo mirësi dhe vendbanim të mrekullueshëm!” (*Ra'd, 13/29*)

“Kurse për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të ketë kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Kjo është fitorja madhështore.” (*Buruxh, 85/11*)

## Munafikët

Në Kur'an, Allahu i cilëson si negativë munafikët, për shkak të mospërputhjes ndërmjet besimeve dhe sjelljeve të tyre (*shih Munafikun, 63/1-3*). Allahu paralajmëron atë që nuk sillet në përputhje me atë që beson, kërkon respektimin e tërësisë besim-sjellje dhe fjalë-sjellje.

Njeriun, të cilin Kur'ani e tregon si model në pikëpamje të sjelljes, Pejgamberi ynë e përshkruan kështu:



“Kushdo që vendos në zemër besimin e sinqertë dhe që pastron anën e tij të brendshme, vendos fjalën e drejtë në gjuhë, përçon nefsën në qetësi e prehje, sjell në formë të drejtë traditën, moralin dhe sjelljen, ka arritur në shpëtim.” (Ahmed, Musned, V/147)

## Marrëdhënia besim, dije dhe sjellje

Ndërmjet besimit dhe sjelljes gjendet një marrëdhënie dhe ndikim reciprok. Një njeri me vetëdije mbron ekuilibrin dhe përputhjen mes besimit dhe sjelljes. Sjellja është një rezultat që shfaqet në kuadër të dijes dhe besimit. Ajo që e bën të vetëdijshme sjelljen dhe që i jep mbështetje asaj, është dija dhe besimi. Libri ynë i shenjtë, Kur’ani, kërkon që në sfondin e sjelljeve të individit të gjendet dija e saktë dhe ekzistenca e besimit.



### Përmbledhja e kapitullit



Njëri prej kushteve themelore të besimit në fenë tonë të lartë, në Islam, është t’u besojmë librave. Allahu u është drejtuar njerëzve me anë të vahjit. Allahu, si një mirësi hyjnore dhe si ndihmë ua ka dërguar njerëzve vahjin nëpërmjet pejgamberëve.

Librat hyjnorë, librat qiellorë, janë Teurati, Zeburi, Ungjilli dhe Kur’ani. Ka edhe libra që quhen suhuf, me vëllim të vogël dhe në formën e fletëve. Mirëpo këta nuk kanë arritur deri në ditën e sotme. Synimi i dërgimit të të gjithë librave është të mund t’u përçojnë qetësi, besim dhe lumturi njerëzve në jetën e botës dhe të ahiretit, duke fituar pëlqimin e Allahut. Librat hyjnorë janë udhërrëfyes që tregojnë udhën e drejtë, të drejtën dhe të vërtetën.

Kur’ani i është zbritur Pejgamberit tonë në një periudhë kohore prej 23 vitesh. Kjo ka mundësuar një lehtësim të madh në kuptimin dhe zbatimin e urdhëresave dhe ndalesave, të parimeve themelore.

Kur’ani nisi të regjistrohet nën udhëzimin dhe vëzhgimin e Pejgamberit tonë. Vahji që erdhi menjëherë u kalua në shkrim dhe pas vdekjes së Pejgamberit tonë u përgatit në formën e mus’hafit. Këto procedura të realizuara në këtë periudhë kanë mundësuar që Kur’ani të mbrohet në formën që ka ardhur. Kjo është veçoria më themelore që e dallon atë nga librat e tjerë qiellorë. Sepse librat e tjerë nuk kanë arritur të ruhen në formën që zbritën, madje janë shtrembëruar nga ithtarët e tyre.

Në Kur’an përcaktohen cilësitë e njeriut model besimtar që synohet në pikëpamje të dijes, besimit dhe sjelljes. Sipas kësaj, besimi duhet të bazohet në dije dhe të mbështetet me sjellje. Libri ynë i lartë jep këshilla që i bëjnë të drejta, të bukura dhe të dobishme mendimet dhe sjelljet tona. Gjithë përpjekjet e Pejgamberit tonë u bënë për të formuar

modelin e njeriut të virtytshëm; thelbi, fjala dhe sjellja e Pejgamberit janë një, që është mbrojtësi i së vërtetës dhe që nuk shfaq mospërputhje. Personi, besimi dhe sjelljet e të cilit nuk janë të përputhura, jo vetëm nuk arrin qetësinë e vërtetë në botën e brendshme, por paraqitet edhe si negativ kundrejt Allahut dhe humbet respektin e besueshmërinë përballë njerëzve.



## Të rishikojmë kapitullin



1. Cili është kuptimi i vahjit?
2. Përse njerëzit ndiejnë nevojën e vahjit?
3. Cili është kuptimi i fjalës suhuf, cilit pejgamber dhe sa suhufë i janë dërguar?
4. Thoni veçoritë dalluese të Teuratit, Zeburit dhe Ungjillit.
5. Shpjegoni dallimin mes Kur'anit dhe librave të tjerë hyjnorë.
6. Çfarë modeli të njeriut synon Kur'ani në pikëpamje të dijes?
7. Thoni kuptimin e një ajeti të lidhur me modelin e njeriut që synon Kur'ani në pikëpamje të besimit.
8. Cilat janë veçoritë e njeriut model që synon Kur'ani në pikëpamje të sjelljes?



## Pyetje vlerësuese



### 1. Cilit prej peygamberëve të mëposhtëm nuk i është dërguar libër?

- A) Hz. Musait                      B) Hz. Isait                      C) Hz. Junusit  
D) Hz. Daudit                      E) Hz. Muhammedit

### 2. Cila nga alternativat e mëposhtme është mrekullia më e madhe e Pejgamberit tonë?

- A) Hadithet e sakta                      B) Lartësimi në miraxh                      C) Migrimi në Medine  
D) Kur'ani i Madhërueshëm                      E) Ndarja e hënës

### 3. Cila nga alternativat e mëposhtme është përkufizimi i fjalës suhuf?

- A) Janë vahij të përbëra nga disa fletë.  
B) Është çdo fletë e Kur'anit.  
C) Është libri hyjnor që iu dërgua Hz. Nuhut.  
E) Është një emër tjetër i Kur'anit.

### 4. Cila prej alternativave të mëposhtme ka si synim themelor dërgimin e librave hyjnorë ndaj njerëzve?

- A) Të informojnë mbi Allahun.  
B) Të mësojnë si këndohen lutjet.  
C) Të japin të dhëna në lidhje me universin.  
D) T'u tregojnë njerëzve rrugën e drejtë.  
E) Të japin të dhëna në lidhje me krijimin.

### 5. Cila nga alternativat e mëposhtme e dallon Kur'anin nga librat e tjerë hyjnorë?

- A) Fakti që është shkruar kur Hz. Pejgamberi ishte gjallë.  
B) Fakti që kopjet janë shumuar.  
C) Fakti që është sjellë në formën e mus'hafit.  
D) Fakti që ka zbritur me gjuhën e popullit ku ka zbritur.  
E) Fakti që ka ardhur me anë të vahjit.



besimi im  
besimi im



Kapitulli

7





# Besimi te pejgamberët

1. Nevoja për profetësi dhe për pejgamberë
2. Veçoritë e pejgamberëve
3. Detyrat e pejgamberëve
4. Mrekullia dhe kerameti
5. Citime nga jeta e disa pejgamberëve

## RRETH KAPITULLIT

- Në këtë kapitull trajtohet çështja e besimit te peygamberët, si një ndër kushtet e besimit në Islam.
- Kemi nevojë për peygamberë.
- Detyra e delegimit ndërmjet Allahut dhe njerëzve quhet profetësi.
- Me mendje, njeriu mund të kuptojë ekzistencën e Allahut, njëjesisë dhe lartësimin, mirëpo, në lidhje me të, nuk mund të përfitojë të dhënat që bëhen të ditura nga peygamberët me anë të vahjit.
- Nëpërmjet mendjes, njeriu nuk mund të arrijë në një rezultat të drejtë në lidhje me çështjet se si duhet të bëjmë adhurim ndaj Allahut dhe në lidhje me ahiretin.
- Peygamberët u tregojnë udhën e drejtë njerëzve për të gjetur atë që është e drejtë dhe e dobishme, për të arritur te virtyte të tilla si dallimi, urdhëresa hyjnore dhe mësimi i të vërtetave, si dhe për të arritur në virtyte morale.
- Mrekulli janë ngjarjet e jashtëzakonshme që tregojnë peygamberët me ndihmën e Allahut, me qëllim që të vërtetojnë profetësinë e tyre.
- Ngjarjet e jashtëzakonshme, të cilat i realizojnë ata që nuk janë peygamberë, nuk quhen mrekulli.
- Keramet quhen ngjarjet e jashtëzakonshme që tregohen nga robërit e përzgjedhur të Allahut, të cilët u besojnë me sinqeritet peygamberëve dhe respektojnë me përpikëri sunnetin e tij.
- Kur'ani ka paraqitur shembuj fragmentesh nga jeta e disa peygamberëve dhe ka nxjerrë në pah njëren prej veçorive të tyre.
- Në këtë kapitull, si shembull merret kërkimi i Allahut nga Hz. Ibrahim, bashkudhëtari i Hz. Musait dhe ngjarjet e mbushura me virtyte;
- Durimi i Hz. Ejjubit kundrejt sëmundjes;
- Shembujt e dashurisë në tregimin e Jusufit;
- Detyra dhe vetëdija e përgjegjësisë te Hz. Jusufi;
- Karakteri i Hz. Isait dhe dhënia e sihariqit nga ana e tij për ardhjen e Hz. Muhammedit (s.a.s.).

## SYNIMET E KAPITULLIT

Në fund të këtij kapitulli pritet të zotëroni aftësitë e mëposhtme:

1. Të shpjgoni se ç'është detyra e profetësisë.
2. Të perceptoni nevojat e njerëzve për peygamberë.
3. Të shpjgoni cilësitë e peygamberëve.
4. Të thoni detyrat e peygamberëve.
5. Të thoni përkufizimet e mrekullisë dhe të kerametit.
6. Të shpjgoni se me ç'cilësi njihen peygamberët që përmenden në Kur'an.

## NDËRSA MËSOJMË KAPITULLIN

Ndërsa mësojmë kapitullin:

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni çështjet që lidhen me ato pika, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Plotësojini patjetër ushtrimet dhe veprimtaritë analitike që jepen brenda kapitullit.
3. Studioni librat që mund të siguron nga literatura në fund të veprës.

## 1

## Profetësia dhe nevoja që ndihet për pejgamberët



## Besimi te pejgamberët

- Njëri prej kushteve themelore të besimit në fenë tonë të shenjtë, në Islam, është besimi në pejgamberë.
- Ky kusht nevojitet miratimin e atyre që Allahu i zgjedh ndërmjet njerëzve si pejgamber dhe se të gjitha të dhënat që ata marrin nga Allahu e i sjellin janë të drejta dhe të vërteta.
- Në Kur'an Allahu bën të ditur se duhet t'u besojmë të gjithë pejgamberëve pa bërë asnjë dallim.
- Ka konsideruar si mohim besimin e shprehur ndaj një pjese pejgamberësh dhe mosbesimin ndaj disa të tjerëve.

## Besimi në pejgamberë dhe kuptimi i këtij besimi

- Fjala pejgamber vjen nga persishtja dhe do të thotë delegat dhe lajmëtar. Kështu quhen ata që Allahu zgjedh mes njerëzve dhe të cilët i ka ngarkuar me detyrën e përcjelljes së urdhëresave dhe të ndalesave të marra me anë të vahjit ndaj njerëzve. Në arabisht, në vend të fjalës pejgamber përdoret fjala resul, në kuptimin delegat dhe i dërguar, si dhe nebi, në kuptimin lajmëtar.
- Resul quhen pejgamberët që janë dërguar ndaj njerëzve me një libër të ri dhe me një fe të re.
- Risalet dhe nubuvvet: Ka kuptimin profetësi.
- Profetësia është emri i detyrës së delegimit ndërmjet Allahut dhe njerëzve. Profetësia nuk mund të përfitohet me punën dhe vullnetin e njeriut, por është diçka e dhuruar nga Allahu.
- Ai zgjedh mes njerëzve atë person që dëshiron.
- Ai i zgjedh pejgamberët mes shoqërive, në të cilat jetojnë. Kjo situatë ka mundësuar lehtësim në kuptimin e vahjit dhe në pranimin e saj. "Kjo është dhuntia e Allahut; Ai ia jep atë kujt të dojë." (*Xhum'a, 62/4*)
- Gjatë gjithë historisë së njerëzimit, Allahu nuk e ka lënë njeriun vetëm, as pa mbështetje dhe pa udhërrëfyes; ai ka dërguar një pejgamber ndaj çdo bashkësie njerëzore: "Çdo popull ka pasur të dërguar." (*Junus, 10/47; Nahl, 16/63*)



"...Nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues." (*Fatir, 35/24*) Profetësia ka përfunduar bashkë me Hz. Muhammedin (s.a.s.): "Muhammedi... është i Dërguari i Allahut dhe vula e pejgamberëve." (*Ahzab, 33/40*)



## Le të mendojmë

Përse është dërguar pejgamber ndaj çdo bashkësie njerëzore?



## Mendja e njeriut dhe peygamberët

- Njeriu mund të kuptojë me mendje ekzistencën, njëjësinë dhe lartësinë e Allahut, mirëpo nuk mund të përfitojë në lidhje me të informacionet që sjellin peygamberët.
- Allahu i Lartmadhëruar, në të gjithë librat që dërgoi, jep të dhëna të mjaftueshme ndaj njerëzve në lidhje me ekzistencën, atributet dhe veprimet, duke prezantuar kështu veten.
- Në Kur'anin e Madhërueshëm janë dhënë informacione të mjaftueshme në lidhje me këtë çështje, si dhe jepen orientime se si duhet të shprehim besimin ndaj Allahut.
- Në lidhje me çështjen se si do të bëjmë adhurim dhe në lidhje me ahiretin, njeriu nuk mund të ketë informacione thjesht nëpërmjet mendjes. Sidomos për çështje të tilla, njeriu ndien nevojë për informimin nga peygamberët dhe për udhërrëfimin e tij.

## Përgjegjësia e njeriut

- Njeriu është përgjegjës për besimin, mendimin, fjalët dhe sjelljet.
- Njeriu mund ta mësojë vetëm nga peygamberi se cila është e drejtë dhe përfituese e sevapit ndër këta, se cili veprim është i gabuar dhe nevojit dënimit. Po ashtu, vetëm nga peygamberi mund të mësojë se cili veprim është hallall dhe haram, është farz dhe vaxhib, teuhid dhe mohim.

## Detyra e peygamberëve

- Peygamberët u tregojnë udhën njerëzve në gjetjen dhe dallimin e asaj që është e drejtë dhe e dobishme, në çështjen e arritjes së virtyeteve morale. Në saje të kësaj, njeriu, duke fituar kënaqësinë e Allahut, arrin në shpëtimin dhe lumturinë e botës dhe të ahiretit.
- Peygamberët, me urdhëresat, ndalesat, këshillat dhe shpjegimet që sjellin, mundohen që njeriu të mos bjerë pre e kërkesave dhe dëshirave epshore, e mjedisit të keq, kulturës së prishur dhe traditave të pabaza, të mos qëndrojë indiferent përballë të vërtetës.
- Peygamberët kanë detyrën e dhënies së sihariqit dhe të paralajmërimit. Ata i paralajmërojnë shoqëritë mbi çdo çështje, parainformojnë për çdo rrezik hyjnor, qiellor dhe botëror që mund të ndodhë.



“(Këta janë) të dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve...” (Nisa, 4/165)



### Le të mendojmë

Në cilat çështje japin sihariqe dhe shprehin paralajmërimet peygamberët?


## Pejgamberët janë udhërrëfyesit e qytetërimit

- Pejgamberët janë udhërrëfyesit e njerëzimit për qytetërimin. Ashtu si në fushën shpirtërore, edhe në atë materiale bëjnë udhërrëfim për njerëzimin.
- Hapat qytetërues që kanë marrë parasysh të gjitha aspektet njerëzore në sipërfaqen e tokës, kanë arritur të hidhen në saje të dijeve të sjella prej tyre.
- Me parimet morale që sollën, ata u dhanë drejtim qytetërimeve; duke u angazhuar me profesione si bujqësia, arti dhe tregtia, kanë parashtruar shembuj në lidhje me aspektin material të jetës.
- Në formimin e kulturës, teknikës dhe qytetërimit në formë të shëndetshme dhe ekuilibruese nga shoqëritë, historia ka dëshmuar shumë herë për rolin e pejgamberëve.

## 2

### Veçoritë e peygamberëve

- Kur'ani i Madhërueshëm thekson se pejgamberët janë njerëzorë. Bën të ditur se edhe ata janë njerëz, se në aspektin e të qenit njeri janë të barabartë me njerëzit e tjerë.
- Edhe ata ulen, ngrihen, shëtisin, punojnë, hanë, pinë, martohen, bëhen me fëmijë, sëmuren dhe vdesin.
- Kanë përgjegjësi kundrejt Allahut njësoj si çdo njeri. Ata janë njerëz të përzgjedhur, të cilët Allahu i zgjedh mes njerëzve dhe u jep detyrën e vahjit.
- Në këtë pikëpamje, ata janë lartësuar në një nivel më të ngritur krahasuar me njerëzit e tjerë, janë pajisur me cilësi të posaçme dhe janë bërë të përzgjedhur dhe shembullorë. Ky pozicion ka bërë të detyrueshëm që tek ata të gjenden disa veçori dalluese.
- Këto veçori, të përkufizuara si atributet dhe veçoritë e peygamberëve, janë si më poshtë:



## Sidk (drejtësia e besnikëria)

- Sidk do të thotë të jesh i drejtë. Është një ndër veçoritë më të rëndësishme të pejgamberëve.
- Çdonjëri prej pejgamberëve është fjalëdrejtë. Ata janë njerëz të drejtë, me një drejtësi dhe besnikëri jo vetëm në fjalë, por edhe në veprime (*Shih Merjem, 19/41, 54-58*).
- Ata, edhe para se të bëheshin pejgamberë, por edhe pasi u bënë të tillë, nuk kanë gënjyer kurrë dhe janë njohur në popujt e tyre me faktin e të qenit fjalëdrejtë. Njerëzit që kanë pasur përreth nuk kanë arritur të thonë për asnjë pejgamber: "Ti më parë gënjeje."
- Pejgamberët ua kanë përcjellë njerëzve urdhëresat dhe ndalesat që ka bërë të ditur Allahu në mënyrë të drejtë, ashtu siç u janë transmetuar.
- Pejgamberët janë bërë shembuj duke konkretizuar në jetën e tyre parimet morale që kanë sjellë.
- Nuk janë ndarë nga e drejta në fjalë dhe në sjellje, në marrëdhëniet me njerëzit, me fqinjët, në marrëdhëniet miqësore, shoqërore, në shitblerje etj., dhe kanë fituar besim.



### Le të mendojmë

Ç'do të thotë të kesh përputhje në fjalë dhe në sjellje?

## Amaneti (besueshmëria)

- Do të thotë të jesh i besueshëm. Pejgamberët janë persona të sigurt dhe të besueshëm. Ata nuk tregojnë mungesë respekti ndaj amanetit (*shih Al-i Imran, 3/161*) dhe zgjidhen ndër njerëzit e besueshëm. Edhe pejgamberët, në shpalljet e tyre hyjnore, kanë nxjerrë në plan të parë veçoritë e të qenit persona të besueshëm (*shih Shura, 26/107, 125, 143, 162, 178*).
- Pejgamberi ynë i dashur, Hz. Muhammedi (s.a.s.), edhe para se të ishte pejgamber, ngaqë ishte personi më i besueshëm në shoqëri, ata që kish përreth e kishin emëruar si Emin (i besueshëm).



### Le të diskutojmë

Diskutoni mbi kontributin që mundëson në pranimin e vahjit veçoria e të qenit i besueshëm nga pejgamberët.

## Ismet (të qenit i pafajshëm)

- Ismet do të thotë të mos kryesh gjynahe, të jesh i mbrojtur nga gjynahet.
- Pejgamberët jo vetëm nuk kanë kryer në asnjë çast të jetës së tyre gjynahe të konsideruara si shirk; në të vërtetë, ata nuk kanë kryer asnjë lloj gjynahu, as në mënyrë të hapur, as në mënyrë të fshehtë.
- Herë pas here, ata kanë pasur qëndrime të quajtur si zel'le (gabime të vogla).
- Këto gabime të vogla, që nuk përfshihen te gjynahet dhe që emërtohen si zel'le, janë rregulluar menjëherë pas paralajmërimit të ardhur nga Allahu.
- Ata, duke qenë persona që merren si shembull në çdo aspekt, kanë qëndruar larg sjelljeve që tronditin këtë pozicion të tyre.
- Ata janë mbrojtur nga Allahu në çështjen e përcjelljes te njerëzit e vahjit të marrë.

## Fet Janet (zgjuarsia)

- Do të thotë të jesh i mençur dhe i zgjuar.
- Pejgamberët janë njerëz të mençur, të zgjuar, me ndjenjë dhe shqisë të fortë perceptimi dhe njerëz të vetëdijshëm.
- Me këto veçori të tyre, ata kanë mundësuar që njerëzit t'u besojnë dhe kanë tërhequr popujt e tyre nga errësira në ndriçim.
- Detyrën e pejgamberit, e cila ka një përgjegjësi të lartë, të vyer dhe mjaft të vështirë e të rëndë, mund ta plotësojnë vetëm personat që e kanë këtë aftësi.
- Në Kur'an ka ajete që aludojnë se pejgamberët janë të mençur dhe të zgjuar (*shih Enbija, 21/51*).



## Tebliğ (kumtimi dhe shpallja hyjnore)

- Tebliğ do të thotë të transmetosh dhe të bësh të ditur.
- Tebliğ është detyra themelore e pejgamberëve.
- Urdhëresat dhe ndalesat që kanë marrë nga Allahu, hallallin dhe haramin, ata i kanë përcjellë plotësisht ndaj popujve të tyre. "O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve." (*Maide, 5/67*) Kur'ani i Madhërueshëm i emërton të gjithë pejgamberët si kumtues dhe shpallës hyjnorë (*shih Nahl, 16/82; Nur, 24/54*).



## 3

## Veçoritë e peygamberëve



Detyra e peygamberëve është t'u përcjellin shpalljen hyjnore njerëzve ashtu siç e marrin nga Allahu (teblig). Kur e bëjnë këtë, nuk mjaftohen vetëm me shpjegimin e shpalljes hyjnore me fjalë, por bëhen shembull edhe duke e zbatuar atë. Pjesë e detyrës së kumtimit dhe shpalljes hyjnore është edhe paralajmërimi i njerëzve dhe dhënia e sihariqit.

Allahu i Lartmadhëruar, si domosdoshmëri e mëshirës hyjnore, mirësisë dhe dhuntisë, ka ngarkuar njerin prej tyre me detyrën e peygamberit. Detyra e tyre është të ftojë njeriun tek Allahu, ta shmangin atë nga të këqijat, ta thërrasin atë drejt gjërave të mira dhe të bukura. Peygamberët, qoftë në aspekt individual, qoftë në aspektin shoqëror, kanë treguar parimet e udhërrëfimit në rrugë të drejtë, pa u penguar dhe pa rënë në depresion a pesimizëm.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të peygamberëve mund të përmbliidhen si më poshtë:

- *Davet (ftesë hyjnore)*: detyra e tyre themelore është t'i ftojë njerëzit drejt besimit të teuhidit, duke i pastruar nga çdo lloj shirku e duke i ftuar të besojnë vetëm te një Allah dhe t'i bëjnë adhurim vetëm Atij. Pas kësaj vjen thirrja e ftesës së tyre për në ahiret. Sepse të besosh në këto dy kushte themelore, është diçka që i paraprin edhe rënies morale të popullit dhe të shoqërisë. Ndërsa të bëjnë thirrje në kushtet e tjera të besimit bën pjesë në thelbin e thirrjes hyjnore.
- *Inzar (paralajmërim)*: në historinë e njerëzimit, asnjë shoqëri nuk është lënë pa paralajmërim nga Allahu dhe detyra e këtij paralajmërimi është plotësuar nga peygamberët. Të gjithë peygamberët, së pari kanë plotësuar detyrën e paralajmërimit ndaj shoqërive të tyre në lidhje me rreziqet që do të hasin në jetën e përjetshme. Peygamberët, duke i informuar ata për rreziqet e kësaj bote dhe të botës tjetër, në rast se nuk i rregullojnë gjendjet e tyre, i kanë paralajmëruar popujt ndaj të cilëve janë dërguar. Në Kur'anin e Madhërueshëm, duke u bërë thirrje ndaj Peygamberit tonë është thënë: "Çohu dhe paralajmëro!" (*Mudeth-thir, 74/2*) Kur'ani, detyrën e paralajmërimit të peygamberëve e bën të ditur me të qenit të tyre paralajmërues, frikësues dhe tërheqës vëmendjeje (*A'raf, 7/184; Hud, 11/12*). Në një ajet, në lidhje me Peygamberin tonë, thuhet kështu: "... Ai është dërguar vetëm që t'ju paralajmërojë para një dënimi të rëndë." (*Sebe', 34/46*) "Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe di nga Allahu atë që ju nuk e dini." (*A'raf, 7/62*)
- *Bejan (sqarim dhe qartësim)*: peygamberët i kanë sqaruar parimet e fesë që kanë sjellë. Ata kanë shpjeguar kuptimet e fshehta të fjalëve që bartin shpalljen hyjnore dhe dispozitat fetare, si dhe mënyrën e zbatimit të tyre. Për shembull, Peygamberi ynë i dashur ka sqaruar nëpërmjet fjalëve dhe zbatimeve të tij aspektet e paqarta të koncepteve të tilla si salat, zekat dhe haxh. Kështu është formësuar sunneti si shembull konkret në përjetësimin e Kur'anit.



“(Të dërguarit i çuam) me prova të qarta dhe libra. Ndërsa ty (o Muhammed) të zbritëm Përkujtesën (Kur’anin), me qëllim që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë.” (Nahl, 16/44)

- Të japin sihariq: pejgamberët kanë dhënë sihariqin e fitimit të pëlqimit të Allahut, lumturisë së botës dhe të ahiretit ndaj njerëzve që kanë respektuar thirrjen e tyre, që kanë besuar dhe kanë kryer vepra të mira, kanë marrë parasysht paralajmërimet e tyre, që kanë rregulluar veten. Në çështjen e nxitjes së njerëzve drejt asaj që është e drejtë, e mirë dhe e dobishme, në çështjen e përvetësimit, të pëlqimit, zotërimit dhe fitimit të vetëbesimit, kjo dhënie e sihariqit ka pasur një kontribut të rëndësishëm.
- Ata, duke i plotësuar në formë të suksesshme detyrat e tyre, kanë fituar zemrat e njerëzve dhe i kanë tërhequr njerëzit në radhët e tyre. Kur’ani bën të ditur se çdonjëri prej tyre është dhënësi i sihariqit (beshir dhe mubesh-shir). Duke përmendur së bashku detyrën e tyre të paralajmëruesit dhe të dhënësit të sihariqit, ka nxjerrë në pah faktin se ata duhet të sillen të ekuilibruar sa i përket kësaj çështjeje (shih A’raf, 7/188; Ahzab, 33/45).



#### Le të mendojmë

- Pejgamberët, duke konstatuar situatën, në të cilën gjendeshin popujt e tyre, nevojat dhe problemet e tyre, nëpërmjet shpalljes hyjnore të marrë nga Allahu, sërish nëpërmjet kësaj shpalljeje, kanë treguar rrugëzgjdhjet në lidhje me ta.
- Kanë bërë përpjekje për të treguar atë që është e drejtë; me qëndrimet dhe sjelljet e tyre, kanë qenë modele dhe shembuj në çdo fushë të jetës.

## 4

Muxhize (mrekulli) dhe keramet (demonstrimi i gjendjeve të jashtëzakonshme)



## Profetësia dhe argumentet

Vërtetimi i profetësisë është i mundur nëpërmjet demonstrimit të një argumenti të prerë dhe që nuk lë vend për dyshim. Ky argument i qartë mund të jetë në dy forma:

- Forma e parë është mrekullia (muxhize), e cila mund të vëzhgohet nëpërmjet shqisave. Kjo formë është e vlefshme për njerëzit që kanë jetuar në kohën e Pejgamberit.
- Forma tjetër është mrekullia që nxirret në pah nëpërmjet informacionit mutevatir, që shpreh informacion të prerë. Kur’ani, mrekullia më e madhe e Pejgamberit tonë, Hz. Muhammedit, ka arritur tek ne nëpërmjet lajmit mutevatir.



## Mrekullia

- Fjala mrekulli ka kuptime si ngjarje e jashtëzakonshme, që të lë pa fjalë, ngjarje e pashmangshme.
- Ngjarja që demonstron Pejgamberi me mirësinë dhe dhuntinë e Allahut, në mënyrë që të vërtetojë profetësinë, ngjarje të ngjashme të së cilës njerëzit nuk janë të aftë ta realizojnë, quhet muxhize (mrekulli).
- Pejgamberët, mrekullitë që kanë treguar me ndihmën e Allahut ndaj njerëzve, në mënyrë që të vërtetojnë se janë pejgamberë, i kanë parashtruar si dokumente të profetësisë së tyre.
- Për këtë arsye, ndër njerëzit mund të demonstrojnë mrekulli vetëm pejgamberët.
- Mrekullia realizohet bashkë me krijimin e Allahut. Meqë tregohet nëpërmjet pejgamberëve, emërtohet edhe si 'mrekulli e pejgamberëve'. Në Kur'an tregohen mrekullitë e Hz. Ibrahimit, Hz. Salihut, Hz. Jakupit, Hz. Musait, Hz. Sulejmanit dhe Hz. Isait.



### Le të mendojmë

Cila është mrekullia e Hz. Sulejmanit që bëhet e ditur në Kur'an?

122

## Kerameti (demonstrimi i ngjarjeve të jashtëzakonshme)

Ngjarjet e jashtëzakonshme, të cilat shfaqen me ndihmën e Allahut nga personat që janë tërësisht të lidhur me pejgamberin dhe që e respektojnë sunnetin e tij me kujdes, duke u bërë kështu ndër miqtë e Allahut, quhen keramet. Ngjarjet e jashtëzakonshme, të cilat i realizojnë individët që nuk zotërojnë këto cilësi, nuk quhen keramet.



### Skena nga jeta e disa pejgamberëve

#### Hz. Ibrahim: kërkimi i Allahut

Pejgamberi Ibrahim, edhe në moshën e fëmijërisë, nuk arrinte t'i jepte kuptim faktit përse babai dhe personat rreth tij adhuronin idhujt që kishin krijuar vetë. Sa herë që e shihte thoshte me vete: "Çfarë epërsie ka ky gur ndaj nesh?" dhe e konsideronte të habitshme me mendjen e një fëmije gjendjen e këtyre njerëzve të mëdhenj, që adhuronin këta idhuj.


Sa më shumë rritej në moshë, aq më shumë i shtoheshin edhe dyshimet në lidhje me zotin dhe zotërimin. Nga fundi i periudhës së rinisë, pyetjet që kishte në mendje

iu shtuan edhe më shumë: “Këta janë gurë, janë thjesht gurë. Të pashpirt, pa gjuhë, shurdh, të verbër dhe të fortë. Ç’është kjo punë kështu? I gdhend, e bëhen zotë. O Zot! Ky nuk mund të jetë zot, duhet të ketë një Zot tjetër. Dikush që nuk ngjan me gurin e dheun, me ne dhe me ata që janë në univers.”

Kishte ardhur tashmë koha që të gjendej një përgjigje e vërtetë mbi çështjen e Zotit nga ana e Ibrahimit (a.s.). Ai e gjeti përgjigjen e tij dhe popullit të tij ia rrëfeu me shembullin e mposhtëm: Ndërsa kishte rënë errësira e natës, ngre kokën dhe sheh qiellin. Pa një det krejt në errësirë, që nuk kishte të sosur; pa yje që ndizeshin dhe shuheshin sikur do të shponin errësirën. Ndër ta i tërhoqi vëmendjen një yll i madh e i ndritshëm. Bërtiti fort: “Ja, e gjeta atë!”

Ndriste në thellësitë e qiellit. Për më tepër, nuk ishte si gurët, pa ndriçim dhe i ngrirë. Por vezullonte fort! “Më në fund e gjeta atë.” Po e shihte yllin me gëzim. Nuk i ndante sytë nga ai.

Por, ç’të bësh! Ndërsa zbardhte dita, ylli kishte humbur dhe i kishte rënë një pikëllim në zemër.



Ibrahimi tha: “Atëherë ylli nuk mund të jetë zoti im. Unë nuk mund të kem kurrë një zot që më braktis mua, një yll që humbet.”

Hz. Ibrahim ishte i vendosur në gjetjen e Zotit të vërtetë. Besonte me gjithë zemër se do ta takonte atë. E kërkonte atë nëpër male, në dete dhe në qiej. Përsëri një ditë, ndërsa ishte zhytur në mendime i pashpresë dhe në muzg, kishte parë hënën të plotë. Ajo ishte më e madhe se ylli që kishte parë, por edhe krejt e ndriçuar! “Ja, e gjeta atë! Si është e mundur që nuk e kam vënë re më parë? Ja ku është një kandil që ndriçon natën, një qenie që zotëron bukuri të paarritshme...” Por sërish gëzimi i zgjati pak.

Kur hëna kishte filluar të humbiste, për Ibrahimin tashmë kishte filluar procesi i kërkimit të ri. Ibrahim i

kishte kuptuar se edhe hëna nuk mund të ishte Zot. Ishte shumë i gëzuar që Allahu i pati treguar udhë në këtë mënyrë, e falënderonte Atë pafund ngaqë nuk ishte fiksuar në një mendim të gabuar.

Ndërsa kërkimi vijonte, një ditë i tërhoqi vëmendjen dielli. Mendoj: “I zoti i dritës dhe i nxehtësisë. A mund të jetë ky Zoti që më jep jetë mua dhe çdo gjëje mbi sipërfaqen e tokës, që pjek të mbjellat, perimet dhe frutat, që ndriçon botën?” Pa mbi kodra, male dhe fusha.



Në çdo anë ku ktheu shikimin, pa dritën e tij, ndjeu nxehtësinë e tij. Sa keq që edhe dielli e plotësoi detyrën ditore dhe humbi në horizont e u zhduk. Përsëri do të vijonte kërkimin. "Zoti im i Lartë nuk është as dielli. Po kush je ti? Ti kurrë nuk mund të jesh humbës dhe perëndues. Ti je i papërfunduar dhe i pahumbur. Ti je ai që më ke krijuar mua, familjen time, botën dhe çdo gjë. Fuqia jote mjafton për çdo gjë. Nuk arrij të të shoh, por ti je në çdo vend... Ekzistenca jote përqafton gjithë unin tim."

Hz. Ibrahim i bën kështu të qarta të gjitha mendimet e tij të ndërlikuara, gjen përgjigjen e vërtetë të të gjitha pyetjeve. Duke e ndier ekzistencën e tij në thellësi të zemrës, shpreh falënderime të pafundme për këtë. I përgjërohet atij në lot, kishte arritur lumturinë e pafund në praninë e Zotit të botëve.

Kishte rezultuar i drejtë në brengat dhe dyshimet se populli i tij zotëronte një besim të gabuar në Zot. U kthye i qetë në shtëpi dhe filloi të thurë plane se si do ta ndante këtë lumturi me të gjithë të tjerët (*shih En'am, 6/74-78*). Ibrahim e përfundoi kërkimin me këto fjalë, kur iu drejtua kështu popullit të tij:



"Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!" (*En'am, 6/79*)

124



#### Le të mendojmë

Si e formulon me shembuj Hz. Ibrahim gjetjen e Allahut?

## Hz. Musai dhe bashkudhëtari i tij: Urtësia

Veprimet rebeluese dhe të vazhdueshme të izraelitëve ndaj Hz. Musait tashmë kishin filluar ta bezdisnin atë. Një ditë i thotë shokut të ri që kishte pranë se donte të udhëtonte:

- Unë nuk do të ndaloj deri në vendin ku bashkohen dy detet, ose do të vazhdoj rrugën për një kohë të gjatë.

Një mendim i tillë udhëtimi nuk ishte i paqëllimshëm. Kishte një shkak që e konsideronte të rëndësishëm dhe një urtësi në vetvete. Ai donte të hapte perdet e urtësisë pas disa ndodhive. Musai e kishte kërkuar këtë nga Zoti i tij dhe Ai e kishte lejuar këtë shëtitje. Ata u nisën për udhë, duke marrë me vete edhe një peshk për ushqim. Kur arritën në vendin ku bashkohen dy detet, e harruan peshkun e tyre dhe filluan udhëtimin. Musai i thotë mikut të tij të ri:

- Nxirre ushqimin që morëm. Ky udhëtim na lodhi.

Ai ia ktheu:

- Pa shih, pa shih! E paskam harruar peshkun te shkëmboret. Ose më saktë, shejtani më bëri që të harroj të të them ty.

Në të vërtetë, shoku i tij e kishte parë se peshku pati rrëshqitur në det dhe kishte ikur. Mirëpo kishte harruar ta lajmëronte Musain për këtë situatë, e cila i qe dukur kaq interesante. E gjitha kjo, në një kohë kur, ajo që kërkonte Musai ishte pikërisht

një ngjarje e tillë e çuditshme. Sepse do ta ndihmonte një ndodhi e tillë për të gjetur personin që do ta zhyste në detin e urtësisë. Për këtë arsye, në vend që të zemërohej me shokun e tij, ai e shpreh kështu gëzimin:

- Gjithsesi, kjo ishte ajo që kërkonim.

Pavarësisht gjithë lodhjes së tyre, u kthyen pas duke ndjekur gjurmët e veta. Këtë herë, në shkëmbore gjetën një ndër robërit e dashur të Allahut, të cilit i ishte falur mëshirë dhe i ishte mësuar dije. Thuhet se ky person ishte Hizri. Më në fund, Musai e kishte gjetur atë që kërkonte dhe menjëherë filloi ta pyesë:

A mund të vij pas teje, që të më mësosh mua nga dijet që të janë mësuar, një dije që të orienton drejt së drejtës.

Burri ia ktheu:

- Në fakt, ti nuk mund të rezistosh të qëndrosh me mua, nuk mund të rezistosh ndaj atyre që kryej unë. Si mund të durosh ndaj diçkaje, anën e brendshme të së cilës nuk e percepton dot?

Musai i tha:

- Inshallah do të shohësh që do të jem i durueshëm. Nuk do të të kundërshtoj ty në asnjë punë që do të bësh.

Burri vazhdoi:

- Nëse do të më bindesh mua, mos më pyet në lidhje me asgjë para se unë të të tregoj. Marrëveshja mes Musait dhe burrit (Hizrit) ishte e vendosur. U nisën bashkë për udhë. Diku hipën në një anije. Burri shpoi anijen në të cilën hipën.

Musai:

- Mos vallë e shpove anijen për të mbytur ata që janë brenda? Në të vërtetë bëre një punë për t'u habitur.

Burri ia ktheu:

- A nuk të thashë se ti nuk reziston dot pa reaguari ndaj punëve që bëj unë?

Musai:

- Harrova, por ti mos u zemëro me mua, mos më bëj përgjegjës për diçka, të cilën nuk e zotëroj dot!

U nisën sërish për udhë. Ndërsa ecnin, rrugës u takuan me një djalosh. Burri e vrau menjëherë djalin.

Musai:

- Mos vrave dikë të pafajshëm, pa arsye? Beto hem që ke bërë një punë shumë të keqe!

Burri:

- A nuk të thashë se nuk u reziston dot punëve që bëj unë?

Musai:

- Nëse pas kësaj do të të pyes sërish në lidhje me ato që bën, mos më shoqëro më. Kërkoj falje për herë të fundit.

Përsëri u nisën për udhë. Në fund të udhëtimit arritën në një qytezë, ku kërkuan ushqime nga njerëzit e atyshëm. Populli nuk donte t'i priste. Ndërkohë, panë një mur që gati po shembej. Burri e drejtoi menjëherë murin dhe e forcoi.

Musai:

- Po të dëshiroje mund të merrje një pagesë për këtë punë që bëre.



Burri:

- Ja, pra, tani gjendemi në situatën që duhet të ndahemi nga njëri-tjetri. Tani do të të tregoj anën e brendshme të atyre që ti nuk u rezistove dot pa pyetur. Anija që shpova u përkiste disa personave të varfër detarë. Doja që ajo të kishte diçka të mangët, sepse pas tyre kishte një mbret, i cili merrte me forcë çdo anije. Sa i përket fëmijës, nëna dhe babai i tij ishin besimtarë. Ata kishin frikë se mos fëmija i shtynte në rebelim dhe në pabesi. Kërkuan që Zoti i tyre t'u jepte atyre një fëmijë më të hajrit dhe më të mëshirshëm. Ndërsa muri u përkiste dy fëmijëve jetimë në qytet. Poshtë tij kishin një thesar. Zoti yt kërkoi që ata të arrijnë në moshën e pjekurisë dhe të nxjerrin thesarin si një mëshirë nga Zoti i tyre.

Unë nuk i bëra vetvetiu këto. Ja, pra, kjo është ana e brendshme e punëve që ti nuk u rezistove dot. (*Shih Kehf, 18/60-82*)

Hz. Musai, në këtë udhëtim të shkurtër të detit të urtësisë, u kthye te populli i tij duke mësuar eksperiencë mbi aspektin e vërtetë të bazuar në përcaktimin hyjnor.



### Le të studiojmë – Të mësojmë

Vlerësoni ngjarjet që ndodhën mes Hz. Musait dhe bashkudhëtarit të tij.

## H. Ejjubi: shembulli i durimit

Allahu e prezanton Pejgamberin Ejjub si një rob durimtar dhe e tregon atë si shembull ndaj njerëzve kur thotë: "... Ne e gjetëm atë të durueshëm, rob të mrekullueshëm. Ai kthehej vazhdimisht me pendesë te Zoti!" (*Sad, 38/44*)

Ai i nënshtrohet çdo vështirësie, shpreh durim ndaj çdo gjëje që i ndodh, kurrë nuk ankohet.

Kur përmendet Ejjubi, së pari të vjen në mendje sëmundja dhe durimi i tij. Të gjitha vështirësitë i ka hasur gjatë viteve të profetësisë. Kur'ani e tregon kështu fillimin e sëmundjes dhe durimin që ai tregoi: "(Kujtoje) Ejjubin, kur iu lut Zotit të vet: 'Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!'" (*Enbija, 21/83*)

Ai e vuante në një gjendje shumë të rëndë sëmundjen që e kishte zënë. Ajo që kërkohet të tregohet në Kur'an, nuk është se cila sëmundje e kishte zënë Ejjubin. Në plan të parë del durimi që ai tregoi. Duhet të theksojmë këtu se gjërat e shëmtuara dhe të ekzagjeruara në lidhje me sëmundjen e tij nuk pasqyrojnë të vërtetën.

Ejjubi orientohet ndaj Allahut për të shpëtuar nga sëmundja e tij, e kishte kërkuar shpëtimin vetëm nga Ai, edhe Ai e kishte pranuar duanë e tij. "Ne iu përgjigjëm atij, ia larguam mjerimin që kishte dhe ia kthyem familjen të dyfishuar në numër. (Këtë e bëmë) nga mëshira Jonë dhe që të jetë përkujtesë për ata që Na adhurojnë." (*Enbija, 21/84*)

Në Kur'an tregohet kështu se si Ejjubi ka shpëtuar nga sëmundja. "(Ne iu përgjigjëm): 'Bjeri me këmbë tokës dhe aty do të dalë një burim me ujë të ftohtë për larje dhe pirje! Ne ia kthyem atij familjen dhe dy herë më tepër, si mëshirë prej Nesh dhe këshillim për të mençurit.'" (*Sad, 38/42-43*)

Ejjubi e kishte marrë shpërblimin e besimit dhe të durimit, si dhe kishte arritur në shpëtim. Ai e kishte fituar sprovën dhe kishte marrë sihariqin e tij; Allahu është bashkë me durimtarët (*Shih Bakara, 2/153-154*).



### Le të mendojmë

- Përse durimi është duaja më e efektshme?
- Çfarë tregohet në popull në lidhje me sëmundjen e Ejjubit? Vlerësoni se pse këto nuk mund të jenë të vërteta.

## Hz. Jusufi: shembuj të dashurisë

Në një sure të posaçme në Kur'an tregohet në shumë aspekte historia e jetës së Pejgamber Jusufit dhe kjo cilësohet si rrëfimi më i bukur (*Shih Jusuf, 12/3*). Ndër këta spikasin shembujt e dashurisë ndaj fëmijës dhe të dashurisë ndërvëllazërore. Kur flitet mbi dashurinë për fëmijën, së pari na vjen në mendje Jakubi, babai i Jusufit. Dashuria e madhe për djalin e tij të dashur, Jusufin, është shndërruar në legjendë. Pejgamber Jakubi kishte dymbëdhjetë djem. Dy të fundit prej tyre ishin Jusufi dhe vëllai i tij, Bunjamini.

Sprova e tij kishte qenë pikëllimi dhe dhimbja e ndjerë ndaj njërit prej fëmijëve dhe tradhtia e disa prej fëmijëve të tjerë. Ishte djegur nga malli që kishte për Jusufin, i kishte rënë e bardha në sy nga të qarit. E kishte fshehur pikëllimin dhe ishte zhytur në të, nuk i kishte thënë askujt se 'çfarë e mundonte', përgjërimit ia kishte shprehur vetëm Allahut, lutjet i kishte shprehur vetëm ndaj Tij. Ai nuk e kishte humbur për asnjë çast shpresën se do të takohej me të birin e tij, kishte pritur me durim dhe me shpresë. Dhe në fund ishte bashkuar me të birin e tij të dashur.



### Le të studiojmë – Të mësojmë

Ç'kishte parë Jusufi në ëndërr? Cili ishte komenti i babait të tij dhe këshilla që ai shprehu? Gjejini nga Kur'ani dhe lexojeni.

Dashuria që kishte Hz. Jakubi ndaj Hz. Jusufit i kishte shtyrë vëllezërit në një xheloz të tepruar. Madje kishin arritur deri aty sa të planifikonin edhe vrasjen e tij. Mendonin se kur të vdiste ai, gjithë dashuria e babait do të shkonte tek ata.



### Le të studiojmë – Të mësojmë

Çfarë kurthi i thurën vëllezërit Jusufit dhe çfarë u thanë baballarëve të tyre? Vlerësojeni. Lexoni ajetet që tregojnë këto ndodhi.

Jakubi nuk u kishte besuar atyre që i thanë djemtë, megjithatë nuk pati reaguuar dhe as i pati fajësuar rëndë ata, por kishte thënë kështu: "Jo! Ju gënjyen nefset tuaja dhe ju shtynë të bëni një punë të tillë. Tashmë ajo që më përket mua është një durim i bukur. Ndërsa ai, nga i cili mund të kërkoj ndihmë ndaj atyre që treguat ju, është vetëm Allahu." (*Jusuf, 12/18*) Sepse edhe ata ishin fëmijët e tij, në fakt edhe ata i donte shumë. Edhe ata sigurisht që kishin nevojë për dashurinë e babait. Fakti që babai i tyre ishte më i lidhur me Jusufin, e kishte një shkak ndryshe. Në të ardhmen ai do të bëhej pejgamber, mirëpo ata nuk e dinin këtë. Duke parë anën e jashtme, ata ishin kapluar nga mendimi se babai i tyre nuk i donte mjaftueshëm ata.







Në Egjipt dhe në rrethinë pati kapluar periudha e zisë, e cila do të zgjaste shtatë vjet. Nga çdo anë karvanët ishin orientuar drejt Egjiptit për të marrë ushqim. Jusufi ishte bërë vezir përgjegjës për thesaret e Egjiptit. Edhe vëllezërit e mëdhenj të Jusufit kishin ardhur me njërin prej këtyre karvanëve në Egjipt dhe ishin takuar me të.

Jusufi u thotë vëllezërve: "Merreni këtë këmishë, çojani babait tim dhe le të fërkojë sytë me të. T'i hapen sytë, pastaj merreni gjithë familjen dhe hajdeni tek unë." Karvani u nis për udhë që të kthehej nga Egjipti në shtetin e tyre. Jakubi pati një parandjenjë dhe u tha djemve: "Më besoni, unë e ndiej aromën e Jusufit. Ju

lutem mos më konsideroni të çmendur." (*Shih Jusuf, 12/93-95*)

Kur erdhi ai që do të sillte sihariqin, Jakubi i fërkoj sytë me këmishën e Jusufit dhe menjëherë iu kthye shikimi. Djemtë kërkuan nga babai që të bënte dua ndaj Allahut, që ai t'ua falte gabimet e tyre. Ai tha: "Do ta lus Zotin tim që t'ju falë. Pa dyshim që Ai është Falësi dhe Mëshirëploti". (*Jusuf, 12/96-98*)

Jakubi vajti bashkë me familjen në Egjipt pranë të birit. Jusufi e përqafoi nënën dhe babanë, i ngjiti ata mbi fron dhe ata u përkulën me respekt përballë tij. Jusufi tha: "O babai im, ky është shpjegimi i ëndrrës sime të dikurshme. Zoti im e përmbushi atë." (*Jusuf, 12/99-100*)

Në rrëfimin e Hz. Jusufit, njëri prej kriterëve më të rëndësishme është edhe dashuria që babai ka për të birin. Theksohet edhe dashuria ndaj vëllezërve, edhe se ata sillen herë pas here në mënyrë të gabuar. Pavarësisht xhelozisë së tyre, ata nuk kishin arritur të cenonin jetën e vëllait dhe në fund kishin kërkuar falje duke shprehur një pendesë të madhe. Dashuria e djalit ndaj babait, si dhe nevoja që ndiente për dashurinë e tij, është e fshehur ndërmjet vargjeve.

Nëse duhet ta themi në mënyrë të përmbledhur, me shembullin e Jusufit tregohet në mënyrë të përmbledhur dashuria e familjes, dashuria e individëve të familjes ndaj njëri-tjetrit. Në dashurinë e Allahut, e cila është më e larta e dashurive, ka vend për të gjitha dashuritë, mjafton që dashuritë e tjera të mos tentojnë të kalojnë në vend të dashurisë ndaj Tij.

## Hz. Junusi: vetëdija e detyrës dhe e përgjegjësisë

Junusi ishte dërguar Pejgamber ndaj popullit të Ninovës, të cilët ishin mizorë dhe adhures të idhujve. Zotëronte një identitet të lartë dhe shembullor, ashtu si çdo Pejgamber. Në Kur'an ekziston një sure që mbart emrin e tij. Ai e fton popullin të besojë në Allah, por gjatë 33 vjetëve, nga populli i tij vetëm dy persona i besuan.

Kjo situatë e lëndoi shumë atë. Me një pikëllim dhe zemërim të madh, e braktisi Ninovën. Në vetvete, kjo sjellje e tij nuk kishte të bënte me arratisjen ndaj detyrës dhe përgjegjësisë, por s'kishte as qëllim rebelimi. Kishte kërkuar të largohej nga këta njerëz, të cilët pavarësisht të gjitha përpjekjeve, nuk ia kishin vënë veshin.

Junusi i kishte thënë popullit se pas tri ditësh do të dënoheshin për shkak të përgënjeshtimit të popullit ndaj tij dhe pa pritur përfundimin e ditës së tretë e kishte braktisur qytetin në mesnatë. Kur populli e kuptoi vërtet se do t'u vinte dënimi, u kapluan në brengë dhe filluan të kërkojnë Junusin.

Pasi nuk e gjetën atë, morën me vete fëmijët dhe kafshët, braktisën qytetin dhe shkuan në shkretëtirë. Ata ishin penduar dhe kishin shprehur teube. Përballë kësaj situatë, i ishin dhimbsur Allahut dhe nuk i kishte dënuar.

Mirëpo, pa kaluar shumë kohë Junusi e kishte kuptuar gabimin e kësaj sjelljeje të nxituar. Ai e shihte veten të padrejtë, ngaqë kishte bërë një punë të tillë pa ardhur leje nga Allahu dhe e fajësonte veten vazhdimisht. Duaja e tij e përzemërt dhe pranimi i duasë nga Allahu shprehet kështu në Kur'an: "... S'ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar! Ne iu përgjigjëm atij dhe e shpëtuan nga brengosja. Kështu, Ne i shpëtojmë besimtarët." (Enbija, 21/87-88)



### Le të mendojmë

Përse Junusi është quajtur Dhun-Nun (i zoti i nunit)?

Vetëdija e detyrës dhe e përgjegjësisë e kishte kthyer Junusin sërish në Ninova. Jetën që i kishte mbetur e kaloi duke thirrur në besim popullin, të cilin e pati lënë në gjendjen e tyre. Gjithsesi, edhe detyra dhe përgjegjësia e Pejgamberit e bënte të domosdoshëm këtë veprim. Sepse ai ende nuk e kishte plotësuar detyrën dhe nuk e kishte çuar në vend e në mënyrën e duhur përgjegjësinë. Këtë herë e kishte përqafuar më me vetëdije detyrën e tij. Tashmë, përpjekjet e tij të palodhura, të vendosura dhe durimtare, kishin filluar të jepnin frytet e tyre.

Në fund, populli i tij e kishte braktisur mohimin dhe mizorinë dhe kishte arritur në shpëtim duke zgjedhur rrugën e fortë dhe të besueshme.



### Le të mendojmë

Vlerësoni të dyja sjelljet e Pejgamber Junusit në pikëpamje të detyrës dhe përgjegjësisë.



## Hz. Isai: identiteti dhe dhënia e sihariqit për Hz. Muhammedin (s.a.s.)

Allahu tregon në Kur'an një pjesë të jetës së Hz. Isait dhe disa nga vështirësitë që hasi ai gjatë detyrës së profetësisë, si dhe e lëvdon atë. Ashtu si të gjithë peygamberët, edhe Hz. Isai u është nënshtruar vështirësive dhe torturave të mëdha për shpëtimin dhe lumturinë e njerëzve. Ajo që i jepte forcë atij, rezistencë dhe vendosmëri, ishte dashuria e gjerë që kishte në zemër. Dashuria e ka të nevojshme shprehjen e përkushtimit të plotë për ata që duhen dhe mbartjen e përgjegjësisë që ngarkon dashuria.

Isai, i biri i Merjemit, nuk e humbi kurrë besimin se një ditë njerëzit do të shohin realitetet dhe ka shprehur dua ndaj Zotit të tij për mirësinë dhe shpëtimin e tyre.

Kur Isai u bë Peygamber, si libër i shenjtë iu dha Ungjilli. Ai i ftoi njerëzit drejt rrugës së drejtë, u dha këshilla të bukura atyre dhe demonstroi mrekulli të mëdha. Në këmbim të kësaj, njerëzit e përgënjeshtroan atë dhe bënë përpjekje për ta vvarë, mirëpo Allahu i çoi dëm planet e tyre të shëmtuara (*Shih Al-i Imran, 3/54-55*).

Pavarësisht të gjitha përpjekjeve, atij i kishin besuar shumë pak njerëz. Sipas Kur'anit: "Kur Isai vuri re mosbesimin e tyre, tha: 'Kush janë ndihmuesit e mi në rrugën e Allahut?' Nxënësit (e tij) u përgjigjën: 'Ne jemi ndihmuesit e (fesë së) Allahut. Ne e besojmë Allahun e ti (Isa) dëshmo se ne (i) jemi nënshtruar (Atij).'" (*Al-i Imran, 3/52*) Bëhet e ditur se numri i dishepujve të tij ishte dymbëdhjetë.

Në ajetet që tregojnë se Allahu foli me Isain në ditën e kiametit, hetohen besimet e gabuara, në të cilat kishin rënë ata që i besuan atij pasi ky u largua (*Shih Maide, 5/116-117*).

Në këtë pikë, përgjigjja që jep Hz. Isai është mjaft e spikatur sa i përket dashurisë së tij dhe nivelit me të cilin tregohet: "Nëse Ti i dënon ata - robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti." (*Maide, 5/118*)



### Le të mendojmë

Në ajetin e mëposhtëm vlerësoni se çfarë sihariqi i jep Hz. Isai njerëzimit.

Hz. Isai, ashtu siç ka vërtetuar dhe miratuar Teuratin e ardhur në të shkuarën, edhe në të ardhmen ka dhënë sihariqin më të madh ndaj njerëzimit: "Kujto kur Isai, i biri i Merjemes, tha: 'O bijtë e Izraelit, unë jam i dërguari i Allahut tek ju, për t'ju vërtetuar Teuratin e shpallur para meje dhe për t'ju sjellë lajmin e gëzueshëm për një të dërguar, emri i të cilit është Ahmed, që do të vijë pas meje.'" (*Saf, 61/6*)

Peygamberi ynë i dashur flet kështu në lidhje me Hz. Isain: "Unë jam më i afërti ndaj njerëzve me Isain, të birin e Merjemit, në botë dhe në ahiret." (*Buhari, Enbija, 48, IV/142*). "Nuk ka peygamber tjetër mes meje dhe Isait." (*Buhari, Enbija, 48, IV/142*).



## Përmbledhja e kapitullit



Detyra e delegimit mes Allahut dhe njerëzve emërtohet si profetësi. Të besosh në peygamberë, do të thotë të besosh tek ata që Allahu i ka zgjedhur mes njerëzve dhe te të gjitha informacionet, të drejta dhe të vërteta, që sjellin ata. Njeriu me mendjen e tij mund të dijë ekzistencën, njëjësinë dhe lartësinë e Allahut, mirëpo në lidhje me Të nuk mund të ketë të dhënat që transmetojnë peygamberët nëpërmjet vahjit. Njeriu, nëpërmjet mendjes, nuk mund të arrijë në një konkluzion të drejtë në lidhje me ahiretin dhe me çështjen se si do ta adhurojë Allahun.

Pejgamberët u tregojnë njerëzve udhën për të gjetur dhe dalluar atë që është e drejtë dhe e dobishme, apo për të arritur virtytet morale. Ata kanë konstatuar situatën brenda së cilës gjendej populli i tyre, nevojat dhe problemet, si dhe kanë treguar rrugëzgjidhje. Kanë bërë përpjekje për të treguar atë që është e drejtë. Me qëndrimet dhe sjelljet e tyre kanë qenë shembull në çdo fushë të jetës.

Vërtetimi i profetësisë është i mundur me demonstrimin e një argumenti të prerë, që nuk lë vend për dyshim. Ky argument i qartë mund të jetë në dy mënyra:

- Mënyra e parë është mrekullia (muxhize), e cila mund të vëzhgohet me anë të shqisave. Kjo është e vlefshme për njerëzit që kanë jetuar në kohën e Pejgamberit.
- Mënyra tjetër është mrekullia që nxirret në pah me anë të hadithit mutevatir (hadithit të përcjellë dhe pranuar në mënyrë masive) dhe që shpreh informacion të prerë. Mrekullia më e madhe e Pejgamberit tonë Hz. Muhammedit, Kur'ani, ka arritur te ne me anë të metodës mutevatir.

Ngjarjet e jashtëzakonshme që shfaqen me ndihmën e Allahut nga personat që janë tërësisht të lidhur me Pejgamberin, që e respektojnë sunnetin e tij me kujdes dhe që arrijnë kështu të jenë ndër miqtë e Allahut, quhen keramet. Ngjarjet e jashtëzakonshme që shfaqin personat, të cilët nuk mbartin këto cilësi, nuk quhen keramet.

Në Kur'an janë paraqitur disa skena nga jetët e peygamberëve dhe është nxjerrë në pah njëra prej veçorive të tyre. Ibrahim është prezantuar me kërkimin e Allahut, Musai me bashkudhëtarin dhe me përpjekjet për të kuptuar sjelljet e tij të gatuar me urtësi. Hz. Ejubi është treguar si shembull i durimit. Durimi që ai tregoi kundrejt sëmundjes që e kishte zënë është një sjellje shembullore. Tregimi i Hz. Jusufit ka dalë në plan të parë që nga fillimi me shembujt e dashurisë. Vetëdija e detyrës dhe e përgjegjësisë së Hz. Junusit e ka udhëzuar atë në sukses në detyrën e tij. Hz. Isai është bërë shembull me identitetin e tij; ka dhënë sihariqin për dërgimin e Pejgamberit tonë të dashur, Hz. Muhammedit (s.a.s.), si Pejgamber i fundit.





## Të rishikojmë kapitullin



1. Shpjegoni se ç'është detyra e profetësisë.
2. Përse njerëzit ndiejnë nevojën për peygamberë? Shpjegojeni.
3. Numëroni veçoritë që gjenden te peygamberët dhe shpjegojini.
4. Ç'është thotë mrekulli? Ndaj kujt tregohet mrekulli?
5. Bëni përkufizimin e kerametit dhe përcaktoni dallimin ndërmjet kerametit dhe mrekullisë.
6. Thoni se me cilat veçori janë prezantuar peygamberët e cituar në Kur'an.



## Pyetje vlerësuese



### 1. Cila nga alternativat e mëposhtme shpreh kuptimin e konceptit nubuvvet?

- A) Imamet (udhëzimi dhe drejtimi i ummetit islam)      B) Parashikim fati  
C) Dituri      D) Profetësi      E) Ndërmjetësim

### 2. Me cilën nga alternativat e mëposhtme ka lidhje koncepti i mrekullisë?

- A) Pejgamberët      B) Besnikët      C) Velinjtë  
D) Sahabet      E) Dëshmorët

### 3. Me cilin nga pejgamberët e mëposhtëm është tërësuar koncepti "durim"?

- A) Hz. Musai      B) Hz. Ejubë      C) Hz. Isai  
D) Hz. Junusi      E) Hz. Nuhu

### 4. Cila nga veçoritë e mëposhtme nuk është një ndër veçoritë e pejgamberëve?

- A) Drejtësia      B) Besueshmëria      C) Artizanati  
D) Mençuria      E) Kuntimi

### 5. Cila nga alternativat e mëposhtme është e gabuar në lidhje me pejgamberët?

- A) Pejgamberët janë persona të zgjedhur dhe të ngarkuar me detyrë nga Allahu.  
B) Pejgamberët, me sjelljet e tyre, janë njerëz shembullorë ndaj njerëzve.  
C) Pejgamberët janë persona që sjellin vahjin me gjuhën e popujve të tyre.  
D) Pejgamberët janë persona të zgjedhur ndër melekët.  
E) Pejgamberët janë persona që përcjellin vahjin ashtu siç e marrin nga Allahu.





Kapitulli

8



besimi im  
besimi im



# Besimi në ahiret

1. Besimi në ditën e ahiretit dhe rëndësia e tij
2. Vdekja dhe ringjallja pas vdekjes
3. Gjykimi i njerëzve për bëmat e tyre
4. Xhenneti dhe xhehennemi
5. Vdekja dhe besimet e gabuara në lidhje me jetën përtej vdekjes





### RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull;

- Trajtohet çështja e besimit në ahiret, si një ndër kushtet themelore të besimit në fenë tonë të shenjtë, Islamin. Shpjegohet me ajete dhe hadithe se çfarë jete do të ketë pas vdekjes, sidomos për njeriun.
- Në këtë kapitull citohen ajetet dhe hadithet që nxjerrin në pah ekzistencën e ahiretit dhe vihet theksi mbi ndryshimet që do të sjellë te njeriu besimi në një jetë të tillë.
- Jepen të dhëna mbi varrin, ringjalljen, mahsherin, shpirtin, marrjen në pyetje, xhennetin, xhehennemin, të cilat do të përjetohen gjatë jetës së ahiretit; trajtohet çështja e rimishërimit, e cila besohet në disa fe dhe filozofi, mirëpo që në pikëpamje të fesë islame nuk është e drejtë

### SYNIMET E KAPITULLIT

Në fund të këtij kapitulli pritet që të zotëroni aftësitë e mëposhtme:

1. Të vini re se pas vdekjes do të fillojë një jetë e re.
2. Të shpjgoni rëndësinë e besimit në ditën e ahiretit.
3. Të shpjgoni se ç'do të ndodhë pas vdekjes.
4. Të thoni se njerëzit do të shohin në ahiret këmbimin e gjërave që kanë kryer në këtë botë.
5. Të thoni se cilat janë besimet e gabuara në lidhje me vdekjen.

### NDËRSA MËSOJMË KAPITULLIN

Ndërsa mësojmë kapitullin:

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni çështjet që lidhen me ato pika, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Plotësojini patjetër ushtrimet dhe veprimtaritë analitike që jepen brenda kapitullit.
3. Studioni librat që mund të siguronin nga literatura në fund të veprës.



“O besimtarë! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, melekët e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe ditën e kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë...” (Nisa, 4/136)

# 1

## Besimi në ditën e ahiretit dhe rëndësia e këtij besimi



### Ahireti

Periudha kohore që fillon me ringjalljen e njerëzve dhe që do të vijojë deri në pafundësi quhet ahiret.



“Ne i kemi krijuar qiejt, tokën dhe gjithçka që gjendet ndërmjet tyre vetëm me urtësi. Ora (e kiametit) do të vijë me siguri, andaj ti (o Muhammed) sillu me zemërgjerësi.” (Hixhr, 15/85)

Të besosh në ekzistencën e ahiretit është njëri ndër kushtet e besimit, ndërsa të besosh në këtë kusht është farz. Nga ajetet Kur’anore kuptohet se besimi në ahiret e orienton njeriun drejt së mirës dhe së drejtës. Duke qenë se ata që besojnë në ahiret e dinë se si domosdoshmëri e besimit të tyre do të dënohen për veprimet e gabuara dhe se do të marrin shpërbllim për veprat e drejta, bëjnë më shumë përpjekje në rrugën e të qenit njeri i mirë.



“Ata besojnë Allahun dhe ditën e kiametit, e urdhërojnë të mirën, e ndalojnë të keqen dhe nxitojnë për të bërë punë të mira. Këta janë ndër të drejtët.” (Al-i Imran, 3/114)

Besimi në ahiret mundëson që jeta e kësaj bote të marrë kuptim. Ky besim e bën njeriun të vetëdijshëm për veprimet e tij dhe e pajis me ndërgjegjen se, sido që të veprojnë, mirë apo keq, kjo do të ketë një kuptim dhe një rezultat. Në veçanti, ngaqë është një ditë ku do t’u jepen të drejtat atyre që nuk kanë qenë të lumtur në këtë botë, që kanë pësuar disa padrejtësi, persona të tillë do të ruhen nga përballja me një padrejtësi të përgjeshme dhe nga presioni e depresioni shpirtëror që do të lindë ky përballim.

Besimi në ahiret i ndihmon personat me mundësi të mira ekonomike që të disiplinojnë jetën e tyre, të kuptojnë se janë përgjegjës për atë që zotërojnë dhe për faktin se si do t’i shpenzojnë dhe përse do t’i shpenzojnë pasuritë e tyre.

Besimi në ahiret, duke u zhvilluar njerëzve konceptimin se do të gjykohen për çdo gjë të mirë dhe të keqe, i udhëzon që të orientohen më shumë drejt së mirës dhe të shmangen nga e keqja.





“Atë ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t’u tregohen veprat e tyre: kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.”  
(Zilzal, 99/6-8)

## 2

### Vdekja dhe ringjallja pas vdekjes



#### Vdekja është një fillim i ri

Sipas fesë islame, vdekja nuk është zhdukje, përkundrazi është fillimi i një jete të re dhe të përjetshme.

Të gjitha gjallesat që jetojnë në këtë botë, një ditë do të vdesin. Këtë kriter Allahu i Lartmadhëruar e bën të ditur me ajetet: “Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen...” (*Al-i Imran, 3/185*); “Çdo gjë që është në tokë, do të zhduket...” (*Rahman, 55/26*)

Nuk ka shpëtim nga vdekja! “Frika ndaj vdekjes” është njëra prej ngjarjeve që shqetëson më shumë njerëzit. Njerëzit kërkojnë rrugët e shpëtimit nga vdekja dhe nga frika e saj. Mirëpo vdekja nuk mund të vonohet me disa masa të marra dhe nuk ekziston mundësia që të largohemi prej saj.

Krahas kësaj, edhe dëshira për të qenë të pavdekshëm ndikon si një realitet psikologjik universal. Sepse dëshira për jetesë është një ndër dëshirat më të thella dhe të fuqishme të njeriut. Frika e vdekjes të njeriut, buron sidomos nga mungesa e njohjes, nga vetmia, humbja e të afërmve, humbja e identitetit individual, dënimi për gjynahet pas vdekjes, shqetësimi për ata që mbeten pas, zhdukja dhe humbja e njerëzve që vlerësohen.

#### Vdekja dhe mësimxënia prej saj

- Vdekja është një ngjarje, nga e cila muslimani duhet të marrë mësim. Sepse vdekja i këshillon njeriut se përse jeton, ç’duhet të bëjë, si duhet të veprojë dhe të sillët.
- Feja islame tregon në mënyrë të qartë se çfarë është jetesa dhe vdekja, se ç’do të ndodhë pas vdekjes dhe përse është krijuar vdekja, përse njeriu një ditë vdes; ajo na jep të dhëna që të eliminojmë shqetësimet dhe brengat mbi këtë çështje.
- Sipas Islamit, vdekja nuk është zhdukje, por është fillimi i gjykimit të atyre që bëhen në këtë botë dhe fillimi i një forme të re të jetesës.
- Vdekja është një ndryshim dimensional në jetesë. Vdekja është ndarje nga jeta e përkohshme dhe portë kalimi në jetën e ahiretit, që është e përjetshme.

- Ata që bëjnë punë të mira, ata që e shpenzojnë jetën në mënyrë produktive, ata që kryejnë punë të bukura dhe të qëndrueshme për shoqërinë dhe njerëzimin, për ata vdekja nuk është diçka nga e cila duhet të frikësohen, por është një shtegtim në një jetë të re dhe të pafund, ku do të shpërblehen për atë që kanë bërë.

Vdekja do t'i vijë çdo gjallesë, herët apo vonë. Nuk është e mundur t'i largohemi asaj. Sepse Allahu na lajmëron: "Thuaj: 'Vdekja prej së cilës po ikni, do t'ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai do t'ju njoftojë për atë që keni bërë.'" (*Xhum'a, 62/8*)

Sipas Islamit, ata që besojnë në Allah dhe në ditën e ahiretit nuk duhet të frikësohen nga vdekja. Mirëpo ata që nuk i besojnë Allahut dhe ditës së ahiretit, frikësohen prej saj. Sepse për ata vdekja është zhdukje. Mirëpo një musliman, i cili duke menduar se një ditë gjithsesi do të vdesë, nuk duhet ta braktisë krejtësisht botën dhe të orientohet drejt ahiretit. Si rrjedhojë, në Kur'an urdhërohet kështu:



"Por, me atë që të ka dhënë Allahu përpiqu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu. Mos kërko ngatërresa në tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët." (*Kassas, 28/77*)

Vdekjen duhet ta kemi në mendje kur punojmë për botën, nuk duhet ta harrojmë atë. Kjo e ndihmon njeriun që të veprojë më me vetëdije, të kryejë punë më të bukura dhe më të dobishme në këtë botë.

## Shpirti

Sipas Islamit, shpirti i jepet njeriut pas krijimit të trupit. Pranohet se shpirti, natyra e të cilit nuk njihet shumë nga njerëzit, është një urdhër hyjnor.



"Do të të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: 'Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni.'" (*Isra, 17/85*)

"Pastaj bëri që pasardhësit e tij të krijohen prej një pike të lëngut të shpërfillur, së cilës pastaj i dha trajtë dhe i fryu shpirtin e krijuar prej Tij. Ai ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrën, por pak prej jush janë mirënjohës." (*Sexhde, 32/9*)

## Varri

Vendi ku varrosen njerëzit pasi kanë vdekur quhet varr. Në gjuhën tonë (gjuhën turke) përdoren edhe fjalët 'mezar' dhe 'makber'. Pasi njerëzit të vdesin, do të mbeten këtu deri në kiamet. Bashkë me fillimin e jetës së ahiretit, njerëzit që gjenden në varret e tyre do të ringjallen përsëri për t'u hetuar.





“Atë ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t’u tregohen veprat e tyre.” (*Zilzal*, 99/6)

“Ora (e kiametit) do të vijë, dhe për këtë nuk ka dyshim; Allahu do t’i ringjallë ata që janë në varre.” (*Haxh*, 22/7)

E ngulin gurin mbi varrin tim,  
nën hijen e kujt e fsheh kokën,  
nuk sheh babai të birin e vëllai të vëllanë,  
dalëngadalë rruga ikën e nuk kthehet pas.

## Kiameti

Kur’ani quan si kiamet zhdukjen e kësaj bote. Në ajetet e mëposhtme bëhet e ditur se askush, përveç Allahut, nuk mund ta dijë se kur do të ndodhë kiameti:



“Qoftë i lartësuar në lavdi Ai, të Cilit i përket pushteti i qiejve e i tokës dhe gjithçka që gjendet mes tyre. Vetëm Ai ka dijeni mbi orën (e kiametit) dhe tek Ai do të ktheheni!” (*Zuhruf*, 43/85)

140

## Ringjallja

Ngjarja e ringjalljes së të vdekurve në ditën e kiametit dhe nxjerrja e tyre në mahsher quhet hashr. Kur’ani na informon se njerëzit do të ringjallen pas vdekjes dhe se do të gjykohen për veprimet që kanë kryer në këtë botë, se ky është gjykimi i vërtetë dhe se kjo ngjarje quhet Hashr.



“Kushdo që i kthen kurrizin këshillës sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në ditën e kiametit, do ta ringjallim të verbër.” (*Ta-Ha*, 20/124)

## Mahsher

Pas kiametit, me lejen dhe përcaktimin e Allahut, pas një kohe të caktuar të gjithë njerëzit do të ringjallen dhe të gjithë do të mblidhen bashkë në një vend. Kështu do të fillojë një jetë e re. “Dhe ata përnjëherësh do të brofin (të ringjallur).” (*Nazi’at*, 79/14)

Ja, pra, ky vend ku do të mblidhen njerëzit pasi të ringjallen, quhet mahsher, ndërsa dita kur do të ringjallen quhet dita e mahsherit.

Në Kur’an bëhet e ditur se dita e mahsherit do të jetë shumë e vështirë, për shkak se të gjithë do të mendojnë për veten. Theksohet se është një vend ku askush nuk do të

mund të interesohet për të tjerët. "Por, kur të vijë ushtrimi, atë ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. Atë ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë." (Abese, 80/33-37)

Ndërsa ata që i besojnë Allahut do të jenë të lumtur. Ky kriter shpjegohet kështu në Kur'an:



"Atë ditë do të ketë fytyra rrëzëllore, të qeshura e të gëzuara. Atë ditë do të ketë (edhe) fytyra të pluhurosura, që do t'i mbulojë errësira. Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët." (Abese, 80/38-42)

## 3

### Gjykimi i njerëzve për veprimet e tyre



#### Marrja në pyetje

Në këtë botë, njeriu është gjallesa e vetme që zotëron mendje dhe vullnet. Pajisja e njeriut me mendje dhe me vullnet i ngarkon atij disa përgjegjësi. Ngaqë gjallesave të tjera nuk u janë dhënë këto veçori, atyre nuk u është ngarkuar as edhe ndonjë përgjegjësi. Ata nuk gjykohen për veprat e tyre, qoftë në këtë botë, qoftë në botën tjetër. Mirëpo njeriu do të gjykohet ditën e ahiretit për të gjitha sjelljet e tij gjatë jetës së botës.

Fëmijët dhe personat që nuk gëzojnë shëndet të plotë mendor nuk do të jenë përgjegjës për sjelljet e tyre. "(Melekëve do t'u thuhet): 'Mblidhni njerëzit e këqij, shokët e tyre (shejtanët) dhe idhujt që i kanë adhuruar krahas Allahut e tregojuni atyre rrugën e zjarrit flakërues! Ndalini ata, se do të pyeten.'" (Saffat, 37/22-24)

Përveç kësaj, edhe mirësitë që i janë dhënë njeriut në këtë botë, i ngarkojnë një përgjegjësi atij. Njeriu do të hetohet se si e ka përdorur trupin e tij, nëse i ka plotësuar përgjegjësitë përballë mirësive natyrore që i janë dhuruar apo jo, po ashtu, do të hetohet edhe për përgjegjësitë që ka ndaj njerëzve të tjerë.



"Pastaj, atë ditë do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!" (Tekathur, 102/8)

#### Llogaria

Në mahsher do të ndërtohet një gjykatë e madhe drejtësie, natyrën e së cilës nuk arrijmë ta perceptojmë dot. Të gjithë ata që kanë vdekur në moshën e pjekurisë në këtë botë do të kalojnë nga një gjykim shumë i hollësishëm. Do të hetohen për bëmata në këtë botë, do të shohin atje këmbimin e bëmave të tyre.

Allahu i Lartmadhëruar, nëpërmjet ajetit: “Pastaj, në ditën e gjykimit, ju do të grindeni para Zotit tuaj!” (*Zumer, 39/31*), bën të ditur se ky gjykim do të bëhet. Po ashtu, me ajetin e mëposhtëm, bën të ditur se, si rezultat i këtij gjykimi, njeriu do të marrë shpërblimin për çdo lloj mirësie të vogël që ka kryer, po ashtu edhe ai që ka bërë një të keqe shumë të vogël, do të vuajë dënimin e tij:



“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.” (*Zilzal, 99/7-8*)

Në ajetin e mposhtëm thuhet: “Ata do të sillen në radhë para Zotit tënd (e do t’u thuhet): ‘Tashmë Na erdhët ashtu siç ju krijuam herën e parë, ndonëse ju (o jobesimtarë) pretendonit se nuk do t’ju caktonim një takim (ringjalljen).’” (*Kehf, 18/48*)

Pejgamberi ynë i tregon kështu gjërat që do të ndodhin në ditën e gjykimit: “Personi nuk do të largohet nga vendi i tij pa u gjykuar se në ç’mënyrë e ka harxhuar jetën, se ku e ka munduar trupin, ku e ka fituar pasurinë dhe ku e ka shpenzuar, nëse ka vepruar me dijen e tij apo jo.” (*Tirmidhi, Kijame, 1, (2416), IV/612*)

142

## Mizan (peshorja)

Njihet si peshorja, në të cilën do të peshohen veprat e të gjithëve. Në saje të këtij kriteri, çdo gjë do të analizohet deri në pikën më të vogël, do të dalë në pah i drejti dhe i padrejti. Pasi të përcaktohet se kush i ka hyrë në hak dhe kujt i ka hyrë, ata që kanë pësuar padrejtësi në këtë botë do të marrin të drejtën e tyre. Edhe ata që kanë kryer padrejtësi do të vuajnë dënimin e tyre.



“Dhe, në ditën e kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.” (*Enbija, 21/47*)

Si rezultat i gjykimit, do të peshohen sevapet dhe gjynahet e të gjithëve. Ata që kanë më shumë të mira sesa të këqija, do të jenë të lumtur, ndërsa atyre që të këqijat u peshojnë më shumë, do të mërzhiten.



“Sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit do të rëndojnë në peshore, ai do të ketë një jetë të kënaqur (në xhennet). E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore, ai do të ketë si strehim humnerën (e xhehennemit). Kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është humnera (e xhehennemit)? Ajo është një zjarr i vrullshëm.” (Kari’a, 101/6-11)

Zemra që fluturon lart një ditë lodhet,  
një ditë peshorja e gjykimit ndërtohet.  
Çdo gjë që ka bërë çdokush hetohet një ditë,  
fillon, o Zot, gjuha dalëngadalë të flasë.

## 4

### Xhenneti dhe xhehennemi



Sipas Islamit, asnjë prej veprimeve që njeriu kryen në këtë botë, i mirë apo i keq, nuk do të mbetet pa u shlyer. Çdokush do të marrë shpërblim apo dënim për veprimet që ka kryer. Ata që kryejnë vepra të mira do të marrin shpërblim në xhennet, ndërsa ata që bëjnë vepra të këqija, do të marrin dënimin si shpërblim.

Ata që bëjnë të mira në këtë botë, ata që kryejnë vepra të mira në përputhje me kënaqësinë e Allahut, personat që nuk kanë gjynahe, ashtu siç do të jenë të lumtur në këtë botë, edhe pasi të kenë vdekur do të hynë në xhennet dhe atje do të arrijnë lumturinë e pafund. Robërit e mirë do të përfitojnë në xhennet nga të gjitha mirësitë dhe dhuntitë e Allahut, deri në pafundësi. Mundësitë më të mëdha, kënaqësitë më të larta do të parashtrihen në xhennet.



“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, gëzoji me kopshte të xhennetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Sa herë që t’u jepet si ushqim ndonjë frut i kopshteve, ata do të thonë: “Këtë e kemi ngrënë edhe përpara.” Por atyre do t’u jepen vetëm fruta të ngjashme me ato të tokës. Në xhennet ata do të kenë bashkëshorte të pastra dhe atje do të jetojnë përgjithmonë.” (Bakara, 2/25)

Ashtu si të gjithë nuk do të jenë në të njëjtin vend, po ashtu, jo të gjithë do të arrijnë mirësi të njëjta. Vendi i të gjithëve do të përcaktohet duke u bazuar në faktin se sa e ka fituar kënaqësinë e Allahut në këtë botë. “Secili do të ketë shkallën e tij, sipas veprave që ka bërë. Zoti yt nuk është i paditur për veprat e tyre.” (En’am, 6/132)

Ata që mohojnë Allahun dhe që kanë kryer gjynahe duke mos plotësuar urdhëresat e Allahut, pasi të vdesin do të dënohen në xhehennem. Në Kur’an Allahu e shpjegon kështu këtë kriter: “Nuk është kështu si thoni ju! Ata që bëjnë vepra të këqija dhe mbulohen nga fajet e veta, do të jenë banorë të zjarrit (të xhehennemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë.” (Bakara, 2/81)





## 5

## Vdekja dhe besimet e gabuara në lidhje me jetën përtej vdekjes (rimishërimi)



Njerëzit janë bërë kureshtarë të dinë se çfarë do të ndodhë pas vdekjes. Për jetën pas vdekjes në përgjithësi ka dy pikëpamje të ndryshme:

Konceptimi i parë: pas vdekjes do të fillojë një jetë e re.

Konceptimi i dytë: mendimi, sipas të cilit, pas vdekjes së njeriut ose të një gjallese tjetër, shpirti i saj do të kalojë në trupin e një gjallese tjetër.

Sipas konceptimit të parë, pas vdekjes do të fillojë një jetë e re. Këtë jetë ne e quajmë jeta e ahiretit.

Njerëzit do të gjykoohen për veprat e kësaj bote; ata që kanë kryer vepra të mira do të shkojnë në xhennet.

Ndërsa ata që janë të dëmshëm për veten dhe për shoqërinë, ata që nuk respektojnë urdhëresat e Allahut, do të vuajnë dënimin në xhehennem. Kjo është pikëpamja e fesë Islame.

Edhe Jahudizmi, Krishterimi dhe Zoroastrizmi e pranojnë këtë besim. Sipas këtyre feve, njeriu vjen vetëm një herë brenda një trupi të vetëm në këtë botë, jeton dhe vdes. Nuk ka më mundësi të vijë përsëri në këtë botë. Tashmë jeta e re do të vijojë në ahiret.

Ndërsa konceptimi i dytë është besimi që nënkupton se shpirti i njeriut ose i një gjallese tjetër pas vdekjes, do të vijë në këtë botë në trupin e një gjallese tjetër. Ky besim besëtyt quhet rimishërim. Në turqisht kjo quhet "shtegtim shpirti" dhe "tenasuh".

Fjala reenkarnasion (reincarnation), që vjen nga frëngjishtja, përkufizohet si kalimi i shpirtit, pas vdekjes, nga trupi ku gjendej, në trupin e një njeriu, kafshe ose në formën e një bime, ose si ardhja në botë disa herë njëra pas tjetrës.

Sipas këtij konceptimi besëtyt, të rëndësishëm janë shpirtrat. Trupat janë thjesht një veshje e jashtme. Shpirtrat, sa herë që të vijnë në botë, veshin një rrobë të re.

Rimishërimi, historiku i të cilit shtrihet deri mijëra vjet më parë, në filozofinë indiane, është veçoria dalluese e feve dhe filozofive të Hinduizmit, Budizmit, Xhainizmit dhe feve Sihe. Besimi në shtegtimin e shpirtit, duke filluar kryesisht nga një pjesë e madhe e Indisë dhe e Kinës, vijon të ekzistojë ende në disa pjesë të botës.

Si rrjedhojë e besimit në rimishërim, besohet se çdo gjallesë, përveç njeriut, duhet të kalojë në forma të ndryshme të jetesës, deri kur të lartësohet në trupin e njeriut.

Sipas besimit islam, shpirti nuk është i paraqenë dhe është krijuar më pas. Shpirti që ndahet nga trupi bashkë me vdekjen nuk do të vijë në botë përsëri në trupa të tjerë; kur trupi të krijohet sërish në ahiret, shpirti do të kthehet përsëri në trupin e tij.

Nëpërmjet ajetit të mposhtëm, në Kur'an bëhet e ditur se nuk ekziston diçka e quajtur shtegtim shpirti:



“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: ‘O Zoti im, më kthe që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!’ Kurses! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai (kot) e thotë! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen.” (Mu’minun, 23/99-100)



## Përmbledhja e kapitullit



Koha që fillon nga ringjallja e njerëzve dhe që zgjat deri në pafundësi, quhet dita e ahiretit. Kjo gjithësi është krijuar më pas dhe në të ardhmen do të zhduket. Zhdukja në fjalë është quajtur kiamet.

Në saje të besimit në ahiret njeriu e di se pas vdekjes nuk do të zhduket, duke u bërë i vetëdijshëm edhe mbi atë se çfarë është vdekja. Duke qenë një ditë ku do t’u jepen të drejtat atyre që nuk kanë qenë të lumtur në këtë botë, që kanë pësuar disa padrejtësi, persona të tillë do të ruhen nga përballja me një padrejtësi të përtejme dhe nga depresioni shpirtëror që do të lindë si rrjedhojë e kësaj përballjeje.

Feja islame tregon në mënyrë të qartë se çfarë është jeta dhe vdekja, se ç’do të ndodhë pas vdekjes, përse është krijuar vdekja dhe përse njeriu një ditë vdes. Ajo na jep të dhëna që i eliminojnë shqetësimet dhe brengat tona.

Shpirti është një forcë që përfaqëson aspektin shpirtëror të njeriut, të ndarë nga trupi. Vendi ku varrosen njerëzit pasi kanë vdekur quhet varr. Në gjuhën tonë (turke) përdoren edhe fjalët mezar dhe makber. Pasi njerëzit të vdesin, do të qëndrojnë këtu deri në kiamet. Bashkë me fillimin e jetës së ahiretit, njerëzit që gjenden në varret e tyre do të ringjallen përsëri për t’u gjykuar.

Mizan është një peshore drejtësie në mahsher, në të cilën peshohen veprat e të gjithëve. Sipas këtij kriteri, çdo gjë do të analizohet deri në pikën më të vogël, do të dalë në pah i drejti dhe i padrejti. Pasi të përcaktohet se kush ka hyrë në hak dhe kujt i ka hyrë, ata që kanë pësuar padrejtësi në këtë botë do të marrin të drejtën e tyre. Ndërsa ata që kanë kryer padrejtësi do të vuajnë dënimin e tyre.

Si rrjedhojë e besimit në rimishërim, besohet se çdo gjallesë, përveç njeriut, duhet të kalojë nëpër forma të ndryshme jetese, deri kur të lartësohet në trupin e njeriut.



## Të rishikojmë kapitullin



1. Në ç'kuptim vjen fjala 'dita e ahiretit'? Shpjegojeni.
2. Tregoni dobëtë e besimit në ditën e ahiretit.
3. Shpjegoni shkurtimisht se ç'do të ndodhë pas vdekjes.
4. Ç'do të thotë rimishërim? Shpjegoni vendin e tij në besimin islam.



## Pyetje vlerësuese



### 1. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk përfshihet ndër dobitë e besimit në ahiret?

- A) Ai që beson në ahiret është i sigurt nga frika e vdekjes.
- B) Ai që beson në ahiret tregon kujdes në sjelljet e tij.
- C) Ai që beson në ahiret e di përse është krijuar.
- D) Ai që beson në ahiret frikësohet më shumë nga vdekja.
- E) Ai që beson në ahiret i kushton rëndësi komunikimit të tij me Allahun.

### 2. Cila nga alternativat e mëposhtme është e gabuar në lidhje me vdekjen?

- A) Çdo gjallesë do ta shijojë vdekjen.
- B) Çdo gjallesë do të zhduket pas vdekjes.
- C) Vdekja është një ndodhi, nga e cila duhet të nxjerrim mësim.
- D) Vdekja është fillimi i jetës së pafund.
- E) Vdekja nuk është zhdukje.

### 3. Cili nga konceptet e mëposhtme nuk lidhet me vdekjen dhe jetën pas vdekjes?

- A) Xhehennem                      B) Mahsher                      C) Mizan
- D) Mukabele                      E) Xhennet

### 4. Cila nga alternativat e mëposhtme ka të bëjë me emërtimin e vendit ku do të mblidhen njerëzit pasi të ringjallen pas vdekjes për gjykim?

- A) Mizan                              B) Mahsher                      C) Hashr
- D) Xhennet                      E) Xhehennem

### 5. Në cilat prej feve të mëposhtme ekziston besimi i rimishërimit?

- A) Islami                              B) Hebraizmi                      C) Hinduizmi
- D) Zoroastrizmi                      E) Krishterimi

besimi im  
besimi im

Kapitulli

9





# Besimi në kada dhe në kader

1. Konceptet kada dhe kader
2. Disa veçori të njeriut në lidhje me kaderin
3. Disa koncepte në Kur'an që lidhen me kaderin

### RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull:

- Jepet përkufizimi i koncepteve kada dhe kader, shpjegohet marrëdhënia mes të dyve.
- Njeriu duhet ta ndërtojë marrëdhënien me kaderin si një qenie që zotëron intelektin, që është i lirë dhe përgjegjës. Konceptimi i kaderit që parashtrohet në Kur'an e bën përgjegjës njeriun për shkak të këtyre veçorive.
- Konceptet teuekkul (nënshtrim), risk, sukses, fatkeqësi dhe sëmundje janë koncepte që Kur'ani i sheh të lidhura me kaderin dhe që i vlerëson në kuadër të marrëdhënies njeri-kader.
- Njeriu i realizon sjelljet e tij si zotërues i lirisë dhe i përgjegjësisë. Në marrëdhënien e njeriut me kaderin nuk ekziston një situatë që shfuqizon plotësisht përgjegjësinë nga njeriu. Për këtë, në Kur'an tregohet se njeriu është përgjegjës për çështjen e sjelljeve dhe kërkohet nga ai që të plotësojë përgjegjësinë e tij

150

### SYNIMET E KAPITULLIT

Në fund të këtij kapitulli pritet që të zotëroni informacionet e mëposhtme:

1. Të vini re se në ç'kuptim vijnë konceptet kader dhe kada.
2. Të shpjegoni përse duhet të besojmë në kader dhe kada.
3. Të shpjegoni se Allahu e ka krijuar çdo gjë sipas një kriteri dhe rregulli.
4. Të perceptoni marrëdhënien ndërmjet kaderit të njeriut dhe lirisë e përgjegjësisë.
5. Të shpjegoni marrëdhënien e kaderit dhe të kadasë me ligjet universale.
6. Të thoni kuptimet e ajeteve në çështjen e kaderit dhe të kadasë.
7. Të shpjegoni marrëdhënien e kaderit me riskun dhe teuekkulin.
8. Të shpjegoni marrëdhënien e kaderit me suksesin, fatkeqësinë dhe sëmundjen.
9. Të shpjegoni marrëdhënien mes kaderit dhe përgjegjësisë së njeriut.

### NDËRSA MËSOJMË KAPITULLIN

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni çështjet që lidhen me ato pika, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Plotësojini patjetër ushtrimet dhe veprimtaritë analitike që jepen brenda kapitullit.
3. Studioni librat që mund të siguroni nga literatura në fund të veprës.



“Urdhri i Allahut është vendim i detyruar të ndodhë.” (*Ahzab, 33/38*)

“Çdo gjë tek Ai është me masë.” (*Ra’d, 13/8*)

# 1

## Konceptet kader dhe kada



- Njëri prej kushteve të besimit të fesë sonë të shenjtë, Islamit, është besimi në kader dhe në kada.
- Kaderi i njeriut vlerësohet brenda kufijve të kaderit dhe kazasë: “Urdhri i Allahut është vendim i detyruar të ndodhë.” (*Ahzab, 33/38*)
- Ajetet që lidhen me kaderin dhe kadanë bëjnë të ditur se Allahu e ka organizuar çdo gjë në univers sipas gërshetimit të ligjeve që ka përcaktuar (sunnetullah).
- Allahu e ka krijuar çdo gjë në botë sipas një kriteri. Ky kriter i ka bërë ata në vetvete të matur dhe të përshtatshëm: “Çdo gjë tek Ai është me masë.” (*Ra’d, 13/8*)



### Është radha juaj

Shpjegoni kuptimin e shprehjeve “fat i shkruar”, “e shkruar”.

- Në botë nuk ekziston asgjë e rastësishme.
- Çdo qenie është krijuar sipas një plani, programi dhe kriteri.
- Çdo lloj ushqimi, pijeje, çdo gjë që i nevojitet njeriut dhe që i ofrohet nga nëntoka a mbitoka, është krijuar sipas një kriteri, madhësie, peshe dhe dendësie të caktuar.
- Përveç kësaj, edhe dheu, uji, ajri, nxehtësia, ftohtësia etj., të cilat mundësojnë formimin e këtyre, janë krijuar sipas një kriteri (*shih Mu’minun, 23/18; Hixhr, 15/19*).
- Allahu, i cili e ka krijuar çdo gjë sipas një kriteri, çdo gjallesë në gjithësi i ka falur strukturë, formë, veçori dhe aftësi të përshtatshme me punën që do të bëjë (*shih A’la, 87/3*).

**Kader:** do të thotë të matësh, të përcaktosh. Nënkupton dijen dhe përcaktimin e kohës, të vendit dhe të veçorive të çdo gjëje që do të ndodhë nga fillimi deri në fund nga Allahu. Funksionimin e çdo gjallesë dhe ngjarjeje në univers, Allahu e ka lidhur me një kriter, rregull dhe ligj të caktuar (*Kamer, 54/49*). “... Ai ka krijuar çdo gjë dhe e ka rregulluar si duhet!” (*Furkan, 25/2*)

**Kada:** ka kuptimet urdhër, dispozitë, të plotësosh, të bësh duke matur dhe krijim. Krijimi, kur të vijë koha, i gjërave që Allahu i ka përcaktuar më parë, quhet kada.





### Është radha juaj

Shpjegoni shprehjen “çdo gjë ka një kader”.

- Të besosh në kader dhe kada do të thotë të besosh se çdo gjë e mirë dhe e keqe, e gjallë apo jo, është formuar me dijen, dëshirën, përcaktimin dhe krijimin e Allahut dhe se nuk ka krijues tjetër pos Tij.
- Të besosh në kader dhe në kada, në përgjithësi shpjegohet si të besosh se e mira dhe e keqja vijnë nga Allahu.
- Vepra e mirë vjen në kuptimin mirësi, punë e mirë dhe e dobishme. Veprimet që Allahu i Lartmadhëruar kërkon nga ne që t’i bëjmë, që i do dhe i pëlqen, janë hair.
- Ndërsa sherri nënkupton të keqen, punën e dëmshme dhe të padobishme. Sjelljet që Allahu nuk i pëlqen, që kërkon të mos i bëjmë, për të cilat nuk është i kënaqur, që nuk janë të drejta, quhen sherr.

Allahu i Lartmadhëruar e krijon të mirën dhe të keqen sipas zgjedhjes së robit. Ai u tregon njerëzve se ç’është e mira dhe e keqja, kërkon që të bëjmë mirësi dhe të shmangemi nga të këqijat. Përveç kësaj, bën të ditur se Allahu do të shpërblejë atë që bën mirësi, dhe se do të dënojë atë që bën të këqija. Ajo që është e keqe këtu, nuk ka të bëjë me krijimin e së keqes nga Allahu, por me të keqen që e zgjedh vetë robi dhe dëshirën e tij për ta bërë këtë, pavarësisht të gjitha paralajmërimeve.



### Është radha juaj

Shpjegoni shprehjen: “Allahu tregon pëlqim ndaj së mirës, nuk tregon pëlqim ndaj së keqes.”





### Pjesë leximi

#### Ti po e thua këtë fjalë, Ebu Ubejde?!

Një ditë, Hz. Omeri u nis për të vajtur në Damask, në periudhën e kalifatit të tij. Atë e presin komandantët e ushtrisë në Damask dhe e lajmërojnë se në qytet kish rënë sëmundja e murtajes.

Hz. Omeri, duke marrë masat e duhura, vendos të mos hyjë në vendin ku kishte rënë sëmundja ngjithëse dhe u thotë atyre që kishte pranë se do të kthehej pas. Pas këtyre fjalëve, Ebu Ubejde, ndër komandantët e ushtrisë, i thotë:

- O kalif! Mos vallë po largohesh nga kaderi i Allahut? Nëse Allahu e ka përcaktuar vdekjen tuaj nga kjo sëmundje, vdisni, nëse nuk e ka përcaktuar, nuk ju ndodh gjë.

Hz. Omeri e paragjykon shumë këtë fjalë të tij.

- O Ebu Ubejde! Ti po e thua këtë fjalë?

Më pas vazhdoi:

- Po... Po largohem nga kaderi i Allahut për të vajtur sërish drejt kaderit të Allahut. Po marr masat ngaqë nuk e di përcaktimin e Allahut në lidhje me ne.

Hz. Omeri, në mënyrë që çështja të kuptohet më mirë jep këtë shembull që spikat:

- Nëse ti do të kesh deve, të cilat do të zbrisnin në luginë nga dy anë. Nëse njëra prej luginave është prodhimtare, ndërsa tjetra jo, pra është e thatë, dhe ti do t'i kullosësh devetë në luginën prodhimtare, a do t'i kullosje me përcaktimin e Allahut? Nëse nuk do t'i kullosje atje, por në vendin e thatë, a nuk do t'i kullosje sërish me përcaktimin e Allahut? (*Ahmed, Musned, I/18*).



### Është radha juaj

Vlerësoni përgjegjësinë e njeriut dhe marrëdhënien e tij me kaderin sipas tekstit të sipërm.

## 2

### Disa veçori të njeriut në lidhje me kaderin



Njeriu është një qenie që zotëron mendjen, arsyetimin dhe intelektin.

- Mendja dhe arsyetimi e përkufizon të mirën dhe të keqen si aftësi për të dalluar të drejtën nga e gabuara.
- Mendja është një mjet që ndriçon udhën e njeriut. Ajo që i jep njeriut aftësinë e mendimit, të kuptimit dhe të përfitimit të dijes është mendja.
- Funkcioni më i rëndësishëm i mendjes është mendimi. Njeriu me mendje dhe që mendon, njeh veten, shoqërinë dhe krijuesin, percepton kuptimin e jetës. Mendon

se kush është, përse është krijuar, di pozicionin e tij në univers, vdekjen dhe jetën e përtejme, kërkon përgjigjen e këtyre pyetjeve. Feja e nxit njeriun të mendojë, e mbështet këtë përpjekje të tij dhe u jep përgjigje pyetjeve të tij.

- Njeriu, në saje të mendjes merr përgjegjësi dhe përfiton privilegjin e të qenit bashkëbisedues i Krijuesit, sillet në formë të përshtatshme me krijimin e tij. Ajo që e bën përgjegjës njeriun ndaj fesë është mendja e tij.
- Nëpërmjet mendjes së tij, njeriu percepton marrëdhëniet njeri-Allah, njeri-univers dhe njeri-njeri. Ai sillet në përputhje me pozicionin dhe përgjegjësinë e tij në univers. Për njerëzit që mendojnë, Allahu nxjerr në pah argumentet që vërtetojnë ekzistencën e tij.
- Mendja ndriçon udhën e njeriut.
- Mendja e bën njeriun që të mendojë se kush është, përse është krijuar, pozicionin e tij në univers, vdekjen dhe jetën e përtejme.

## Kur'ani i Madhërueshëm dhe personat e mençur

Kur'ani u drejtohet personave të mençur dhe kërkohet që njeriu të përdorë mendjen që zotëron. Sepse njeriu, çdo gjë për të cilën është përgjegjës, e kupton në saje të mendjes. Prandaj, edhe Kur'ani, ata që sillen e që mendojnë me mendje dhe vetëdije, ata që nxjerrin mësim, i ka lëvduar, ndërsa ata që nuk marrin si udhërrëfyese mendjen, që mundohen të gjejnë udhë në errësirë, i ka cilësuar si negativë (*shih Nahl, 16/12; Bakara, 2/221; Haxh, 22/46; Sexhde, 32/9*).



### Është radha juaj

Vlerësoni marrëdhënien e të qenit person me mendje të shëndoshë ndërmjet kaderit dhe kadasë.

## Të jesh i lirë

- Ekzistenca e njeriut dhe liria janë dy përbërës të ndarë nga njëri-tjetri. Liri është zgjedhja ndërmjet 'kryerjes' dhe 'moskryerjes së diçkaje'. 'Zgjedhja' dhe 'veprimi' janë kusht i detyrueshëm i të qenit i lirë.
- Njeriu është përgjegjës për veprimet e veta në raport me lirinë e tij. Po ashtu, njeriu ka përgjegjësi kundrejt çdo të drejte që zotëron.
- Po ashtu, ajo që i jep kuptim ekzistencës së ahiretit është veprimi në mënyrë të lirshme nga njeriu dhe, në këmbim të kësaj, ngarkimi i përgjegjësisë.

Për njeriun nuk ka liri të pakufishme. Vullneti i njeriut ka një kufi dhe një fund, është i vlefshëm në një kohë dhe vend të caktuar. Njeriu është i lirë në fushat që i interesojnë atij. Një liri vullneti e pakufishme dhe e pafund është e vlefshme vetëm për Allahun. Librat e shenjtë dhe pejgamberët i kanë ftuar njerëzit të jenë të vetëdijshëm për liritë dhe përgjegjësitë e tyre. Sepse liria është një faktor që e shpëton njeriun në të qenit i lidhur verbërisht pas diçkaje, që ia zhvillon jetën dhe që i jep gjallëri atij.

## Liria e zgjedhjes së njeriut

Allahu i jep njeriut forcën e zgjedhjes dhe të kryerjes së asaj që zgjedh. Për këtë arsye, njeriu është krijuar si një krijesë përgjegjëse, është mbajtur përgjegjës për respektimin e urdhëresave dhe të ndalesave të Allahut. Përveç kësaj, Allahu, çfarëdo që të zgjedhë njeriu, e ka vendosur si një ligj se do ta krijojë atë dhe ua ka bërë të ditur njerëzve këtë. Detyra e njeriut është ta dijë mirë këtë ligj dhe të sillet në përputhje me këtë.



### Le të mendojmë

“A është një sjellje e drejtë të kryesh gjynah duke thënë: “Allahu e ka shkruar kështu, kështu paska qenë fati?” Përse?

Veprimtari të tilla si frymëmarrja, rrahja e zemrës, sistemi tretës dhe funksionimi i organeve të brendshme janë të detyrueshme. Edhe situata të tilla si zgjedhja e nënës dhe e babait, përcaktimi i fisit, janë jashtë zgjedhjes sonë. Kjo sepse në këto çështje nuk kemi liri, nuk kemi as përgjegjësi.

## Zgjedhja e së mirës dhe së keqes

- Sjelljet e njeriut ndahen në dy kategori: në sjellje të detyrueshme dhe sjellje që zgjidhen.
- Njeriu ka liri të zgjedhë njërën prej tyre, të mirën apo të keqen dhe ta vërë atë në zbatim.

Sa u përket veprimeve tona të bazuara në zgjedhje, nuk jemi nën ndonjë detyrim dhe presion. Ngaqë në këtë fushë zotërojmë lirinë e zgjedhjes, kemi përgjegjësi.



Ngaqë Allahu është krijues i çdo gjëje, është po Ai që krijon çdo veprim tonin sipas zgjedhjes sonë, të mirë apo të keqe (*Zumer, 39/62*).



### Le të mendojmë

- Çfarë marrëdhënieje ka mes kaderit të njeriut dhe lirisë së tij?
- A e pengon lirinë e zgjedhjes fakti që Allahu e di paraprakisht çdo gjë? Përse?

Në Kur'an theksohet se njeriu që zotëron lirinë e sjelljes sa i përket zgjedhjes dhe zgjidhjes së tij, do të jetë vetë ai përgjegjës për të gjitha rezultatet që do të arrijë:



“Çdo njeri është peng i veprave të veta.” (*Tur, 52/21*)

“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon.” (*Bakara, 2/286*)



## Rregulli i Allahut

Allahu i Lartmadhëruar e ka rregulluar çdo gjë sipas ligjeve që ka vendosur (sunnetul-lah). Edhe kaderi i njeriut formohet brenda kufijve të këtyre ligjeve. Ajo që kërkon Allahu nga njeriu është që ky t'i dijë mirë këto ligje dhe të sillet në përputhje me këtë. Mirëpo njeriu që di se çfarë duhet të kryejë apo jo, e di edhe se është përgjegjës për zgjedhjet dhe veprimet e tij. Kështu, ai llogarit të bëjë atë që është e drejtë dhe të shmanget nga ajo që është e gabuar.

Zgjedhja e së mirës dhe e së keqes nga njeriu: Njeriu ka lirinë e zgjedhjes së të mirës dhe së të keqes. Bën atë që dëshiron, por është edhe përgjegjës për atë që bën. Allahu e krijon të mirën apo të keqen sipas zgjedhjes së njeriut. Sepse në univers ekziston vetëm një krijues, ai është Allahu, zotëruesi i forcës së plotë.

Ai iu ka treguar njerëzve se cila është e mira dhe e keqja, ka bërë të ditur se ka urdhëruar të mirën dhe ka ndaluar të keqen: i ka treguar njeriut udhën që duhet të ndjekë (*Nexhm, 53/39*). Sepse udha ka edhe anën e shtrembër të saj (*Bakara, 2/286*).

Përveç kësaj, Allahu ka bërë të ditur qartësisht se do të shpërblejë atë që bën mirësi, ndërsa do të dënojë atë që bën të këqija. E keqja këtu nuk nënkupton atë që krijon Allahu, por të keqen që robi e zgjedh vetë, pavarësisht çdo paralajmërimi, si dhe dëshirën që ka për ta kryer këtë.



### Le të mendojmë

Nëse Allahu do t'i jepte njeriut vetëm aftësinë e kryerjes së të mirës apo vetëm së të keqes, a do të kishte më kuptim të mbahej nën përgjegjësi njeriu? Përse?

## Të jesh përgjegjës

- Njeriu është një gjallesë që zotëron vullnetin, forcën e kryerjes apo të moskryerjes së diçkaje, të zgjedhjes dhe të dallimit.
- Ndërsa përgjegjësia është një rezultat i vullnetit të njeriut dhe i zgjedhjes së tij. Fakti që njeriu është qenia e vetme e lirë dhe përgjegjëse në univers, e ka ngritur atë në një pozicion më të lartë nga gjallesat e tjera (*shih Ahzab, 33/72*).
- Në Kur'an, qoftë në fushën individuale, qoftë në atë shoqërore, citohen mjaft shembuj në lidhje me përgjegjësinë e njeriut: njeriu i është falur aftësia e kryerjes së të mirës dhe së të keqes, po ashtu dhe përgjegjësia (*Shems, 93/8-10*). Ndaj askujt që ka përgjegjësi nuk ngarkohet përgjegjësia e askujt tjetër (*En'am, 6/164*). Allahu nuk i ka ngarkuar askujt diçka që tejkalon forcën e tij (*Bakara, 2/286*).
- Në librin tonë të shenjtë, në Kur'an, të gjitha çështjet që parashtrohen i tregojnë dhe i kujtojnë njeriut përgjegjësitë e tij. Sepse çdo gjë, për të cilën është i interesuar njeriu, i ngarkon atij një përgjegjësi (*Al-i Imran, 3/13*). Për këtë arsye, duhet që çdo gjë që zotëron njeriu, të përdoret në vendin e saj. Ai që nuk vepron kështu, që nuk vë në funksion mekanizmin e mendimit, të vlerësimit dhe të zbatimit, njeriu që nuk zotëron vetëdijen e përgjegjësive kritikohet në Kur'an (*Muhammed, 47/23-24*).
- Në Kur'an del në plan të parë përgjegjësia e njeriut në ajetet ku përcaktohen të këqijat që mund t'i ndodhin atij dhe urdhërohet kështu:



"... Allahu nuk u ka bërë padrejtësi atyre, por ata i kanë bërë padrejtësi vetvetes." (Al-i Imran, 3/117)

Fakti që njeriu i bën padrejtësi vetes, do të thotë që ai e bën zgjedhjen në anë të gabuar, me vullnetin e tij të lirë, dhe që përgjegjësia e kësaj i përket atij. Këtu, ai që udhëzon është Allahu, ndërsa ai që është i lirë në kryerjen apo jo të padrejtësisë dhe që do të përballet me rezultatin e kësaj, është vetë njeriu.



## Disa koncepte në Kur'an që lidhen me kaderin



### Teuekkul (Nënshttrim)

- Teuekkul ka kuptimet: të besosh, të mbështetesh, të kalosh. Do të thotë të mbështetesh tek Allahu dhe t'i besosh Atij, pasi personi të jetë orientuar drejt të gjitha shkaqeve shpirtërore dhe materiale për të arritur në një qëllim.
- Teuekkul është rezultat i besimit të kaderit.
- Ngjarjet realizohen brenda marrëdhënies shkak-pasojë, në kuadër të një rregulli dhe një ligji. Njerëzit mund t'i gjejnë shkaqet me mendjen dhe vullnetin e tyre të lirë.
- Nuk mund të korret prodhim pa mbjellë farën.
- Nuk arrihet në sukses pa punuar.
- Nuk mund të hyjmë në xhennet pa respektuar urdhëresat dhe ndalesat e Allahut.
- Personi që bën teuekkul, realizon atë që nevojitet për një punë dhe e pret rezultatin nga Allahu: "... Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai." (Al-i Imran, 3/159)
- Allahu ka kërkuar që besimtarët të mos i besojnë një gjallese tjetër, por t'i besojnë vetëm atij (Maide, 5/11); është bërë e ditur se atij që nënshtrohet, ai do t'i mjaftojë (Talak, 65/3).
- Pejgamberi ynë e ka paralajmëruar me këto fjalë beduinin që e kishte lënë të lirë devenë dhe thoshte se i ishte nënshtuar Allahut: "Së pari lidh devenë, pastaj nënshtroju Allahut!" (Tirmidhi, Kiamet, 60, (2517), IV/668).
- Nënshttrimi nuk ka asnjë lidhje me dembelizmin dhe me përtacinë. Të thuash "çfarë do që të jetë kaderi, atë pranoj", pra, pa realizuar përgjegjësitë që bien mbi ty, ky është një konceptim i gabuar teuekkuli.



- Njeriu punon duke respektuar ligjet e vlefshme në univers, përpiqet, mbështetet te shkaqet, më pas i beson Allahut.
- Nuk është teuekkul nëse njeriu e braktis punën dhe kalon në dembelizëm, duke ia lënë dikujt tjetër atë që duhet të bëjë vetë



### Është radha juaj

Shpjegoni marrëdhënien e teuekkulit me kaderin dhe kadanë.

- Personi që beson tek Allahu është në gjendje qetësie dhe prehjeje.
- Duke fituar durim, rezistencë dhe forcë përballë ndodhive, nuk bie në pesimizëm.
- Sepse ai ka bërë atë që i takon dhe rezultatin ia ka lënë Allahut.

## Risku

Fjala risk nënkupton diçka që hahet, pihet, ushqim, diçka nga e cila përfitohet.

- Çdo gjë që Allahu dhuron ndaj gjallesave për të ngrënë, pirë dhe përfituar, quhet risk.
- Ashtu siç është risk çdo gjë shpirtërore dhe materiale, nga e cila njeriu përfiton në botë, po ashtu çdo gjë që do t'i jepet atij në ahiret dhe që do ta bëjë të lumtur atë përfshihet te risku.
- Allahu, ashtu si çdo gjallesë, edhe riskun e njeriut e ka përcaktuar. Mirëpo ta kërkosh atë, ta gjesh e ta shtiesh në dorë, i është lënë në dorë atij.
- E thënë ndryshe, i përket njeriut të bëjë përpjekjen e duhur për të fituar riskun, ndërsa të krijojë riskun i përket Allahut: "S'ka asnjë gjallesë në tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij..." (Hud, 11/6)
- I vetmi që fal risk në botë dhe që e krijon atë është Allahu. Prandaj edhe emri Rezzak/dhënës i riskut, si njëri prej emrave të bukur të Allahut, është përdorur në Kur'an vetëm për Allahun. Ai që jep riskun është Allahu, ndërsa ata që kanë nevojë për riskun janë të gjitha krijesat e gjalla (*shih Dharijat, 51/58; Sebe', 34/39; Mu'minun, 23/72*).
- Njeriu duhet ta fitojë riskun duke zgjedhur rrugën e lejuar. Sepse Allahu i Lartmadhëruar nuk dëshiron kurrë që njeriu të fitojë risk në rrugë të ndaluar. E shmang atë rreptësisht nga harami dhe bën të ditur se ata që ushqehen me haram, do të dënohen me patjetër. Allahu ka urdhëruar që të ushqehemi me risk të lejuar, ndërsa ka ndaluar atë që është haram: "Ushqehuni me gjërat e lejuara dhe të mira që ju ka dhënë Allahu dhe falënderoni për mirësitë e Allahut, nëse vërtet e adhuroni Atë." (Nahl, 16/114)



### Është radha juaj

- Vlerësoni fjalinë: "Askush nuk mund të hajë riskun e askujt, çdokush ha riskun e tij."
- Shpjegoni shprehjet: "djersë balli" dhe "të marrësh shpërblimin e punës së kryer".



“S’ka asnjë gjallesë në tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij...”  
(Hud, 11/6)

## Suksesi dhe puna

Njëri prej ligjeve që Allahu ka vendosur në gjithësi, është përfitimi i shpërblimit të punës së kryer nga individit. Kushti paraprak për suksesin dhe punën është të bëhet mund dhe përpjekje. Për këtë arsye, feja jonë ka këshilluar të punojmë, ka bërë të ditur se për të arritur në sukses duhet të punojmë.



“Njeriu do të ketë vetëm atë, për të cilën ka punuar, se përpjekjet e tij do të shihen dhe se do të shpërblehet me shpërblim të plotë.”  
(Nexhm, 53/39-41)

Të fitosh dhe të korrësh sukses është e detyrueshme për një jetë të ndershme. Për këtë arsye, feja jonë e lartë këshillon që jeta e botës të mos kalohet më kot dhe të vlerësohet mirë çdo çast.

- Sukses do të thotë të përfitosh rezultatin e dëshiruar nga një punë e kryer prej njeriut.
- Arritja në sukses ka disa rregulla dhe mënyra.
- Suksesi është një rezultat që arrihet jo vetëm me anë të identitetit që e tregon individin si besimtar, por me plotësimin e veprimeve të nevojshme duke u kapur pas shkaqeve.
- Nuk ekziston mundësia që një person besimtar, i cili nuk bën asnjë punë, që ia lë punët gjithmonë Allahut dhe të tjerëve, të arrijë të ketë sukses.
- Ndërsa sa i përket asaj se cila gjë konsiderohet si sukses, kjo ndryshon sipas konceptimit besimor dhe botëror të njeriut.
- Kur’ani bën të ditur se një jetë e suksesshme vetëm në aspektin shpirtëror nuk do të jetë treguese se personi është në rrugë të drejtë (*shih Sebe’, 34/35-37*).

Njeriu fiton atë për të cilën punon dhe bën përpjekje. Nëse zgjedh të mirën dhe bën të mira, fiton të mirën; nëse zgjedh të keqen dhe bën të këqija, fiton të keqen. Edhe përgjegjësia e zgjedhjeve dhe veprimeve i përket sërish njeriut (*shih Fussilet, 41/46*). Në mënyrë që një rezultat i korrur në përfundim të punës të konsiderohet si sukses, duhet të jetë brenda kufijve të drejtësisë dhe të dobishmërisë. Edhe kufijtë e kësaj përcaktohen me parimet e përbashkëta të mendjes dhe të fesë. Sipas kësaj, sukcesi i vërtetë e lartëson njeriun në botë dhe në ahiret, e lumturon atë dhe e udhëzon në lumturi. Meqenëse ai që arrin në sukses a në humbje është vetë njeriu, edhe rezultatet do t’i korrë po ai. Është Allahu ai që e udhëzon njeriun në sukses në përputhje me zgjedhjet dhe me veprimet e tij. Nga kjo pikëpamje, edhe sukcesi është një koncept që lidhet me kaderin.





### Është radha juaj

Shpjegoni marrëdhënien e suksesit me kaderin dhe kadanë.

## Fatkeqësia

- Fatkeqësi quhen rastet fatkeqe dhe vështirësitë e mëdha, të cilat i ndodhin papritur njeriut dhe i shkaktojnë dëme në pasuri e në jetë.
- Edhe fjalët 'musibet' dhe 'bela' vijnë në kuptimin e fatkeqësisë. Ky koncept citohet më shumë në hadithet dhe në disa vepra të dijetarëve islamë.
- Në përgjithësi, edhe me fjalën fatkeqësi synohen fatkeqësitë që ndodhin pa ndërhyrjen e njeriut.
- Fatkeqësitë ndahen në dy kategori: në fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi shoqërore.
- Ka raste edhe kur fjala fatkeqësi është përdorur si koncept që lidhet me moralin. Faktorë të tillë si fatkeqësia e zemrës a fatkeqësia e gjuhës, të cilat e shtyjnë njeriun në veprime negative, quhen fatkeqësi. Këta janë konsideruar si fatkeqësi për shkak se kanë penguar formimin e njeriut dhe ngaqë e kanë orientuar atë në shkatërrim në aspektin shpirtëror.
- Allahu ka ligje fizike në botë dhe këta quhen "sunnetullah".
- Çdo gjallesë e vijon jetesën dhe funksionimin e saj brenda kufijve të këtyre ligjeve. Ambienti i jetës në gjithësi formohet me ligje fizike.
- Njeriu është i ngarkuar të mësojë funksionimin e këtyre ligjeve.
- Edhe kategoria e produkteve të teknologjisë që lehtësojnë kushtet e jetesës formohet sipas këtyre ligjeve.

Edhe fatkeqësitë natyrore nuk mbeten jashtë kufijve të këtyre ligjeve. Çfarë përgjegjësie mund të ketë njeriu përballë fatkeqësive natyrore si tërmeti, stuhia, përmytja, rrëshqitja e dheut etj.? Njerëzimi ka gjetur disa rrugë mbrojtjeje prej disa fatkeqësive natyrore, me të cilat është hasur gjatë historisë. Njeriu, sipas terrenit gjeografik ku jeton dhe pozitës së tij të posaçme, është i detyruar të krijojë një rregull të caktuar jetese.

Le të mendojmë për një person që banon në një zonë sizmike. Detyra e tij është të mundësojë një strukturë dhe ndërtesë që i reziston tërmetit. Pa e bërë këtë, nuk mund të anashkalojë përgjegjësinë, duke e konsideruar humbjen e pasurisë dhe të jetës si pasojë e kaderit.

## Njeriu, fatkeqësia dhe durimi

Njeriu duhet të nxjerrë mësim nga çdo ngjarje, me të cilën përballlet dhe duhet ta vlerësojë përvojën që ka fituar. Edhe në fatkeqësitë e tjera natyrore duhet ta vlerësojmë kështu përgjegjësinë e njeriut. Nëse njeriu dëmtohet nga një fatkeqësi pasi ka bërë atë që duhet, e vetmja gjë që do të bëjë është të durojë dhe të nxjerrë mësim. Çdo mësim dhe masë paraprake që ka marrë, do të mundësojë që të ruhet nga fatkeqësitë natyrore.

## Pikëshikimi i fatkeqësive në Kur'an

Në Kur'an nuk citohet koncepti i fatkeqësisë, në vend të saj përdoret koncepti 'musibet'. Thuhet se edhe për musibetet është përgjegjës vetë personi: "Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, kjo është pasojë e asaj që keni bërë vetë, por Ai fal shumë." (*Shura, 42/30*) "Dhe, që të mos thonë, kur t'i godasë dënimi, për atë që kanë bërë: 'O Zoti ynë, të na kishe çuar një të dërguar që t'i pasonim shpalljet Tuaja dhe të bëheshim besimtarë.'" (*Kassas, 28/47*)



### Le të mendojmë

A mund të parandalojë njeriu ndodhjen e fatkeqësisë?

Nëse njeriut i ndodh ndonjë fatkeqësi edhe pasi ka marrë masat e duhura, Kur'ani na bën të ditur që ky person duhet të tregojë durim (*Bakara, 2/155*). Theksohet se fatkeqësi të tilla janë sprova për njeriun dhe se ata që do të rezistojnë përballë kësaj, do të jenë të suksesshëm.



"Sigurisht që Ne do t'ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të ardhurave! Prandaj, përgëzoji të duruarit." (*Bakara, 2/155*)

Allahu i sprovon robërit në mënyra të ndryshme dhe kështu mat durimin dhe falënderimin e tyre. Edhe Pejgamberi ynë i dashur thotë se, nëse personi tregon durim pasi të jenë marrë të gjitha masat paraprake, shpërblimi i kësaj do të jetë i madh (*shih Muslim, Bir, 14, (45), III/1991*).

## Fatkeqësitë shoqërore

Në fatkeqësitë natyrore, njeriu nuk është përgjegjës për marrjen e masave dhe mbrojtjen. Ndërsa shkak për fatkeqësitë shoqërore është vetë njeriu. Sepse njeriu është një krijesë që ka përgjegjësi mbi jetën që jeton dhe veprimet e tij. Në të gjithë shembujt e dhënë nga historia e njerëzimit në lidhje me këtë çështje, njeriu është përgjegjës për të gjitha shembjet shoqërore dhe mbytjet.

## Ligjet shoqërore

Kur'ani e vlerëson edhe fatkeqësinë në kuadër të besimit të kaderit. Në të gjitha fatkeqësitë, me të cilat përballlet njeriu, aludohet mbi aspektin përgjegjës të tij. Njeriu, para se të përballlet me një fatkeqësi, do të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe nuk duhet ta lërë veten në rrezik.





### Është radha juaj

Shpjegoni marrëdhënien ndërmjet ligjeve fizike, biologjike, shoqërore dhe kaderit.

## Njeriu dhe ligjet biologjike

Njeriu e vizon jetën sipas ligjeve biologjike. Edhe të qenit e tij i shëndetshëm, sëmundja e tij, përmirësimi dhe vdekja, realizohen në kuadër të këtyre ligjeve. Në mënyrë që njeriu të mund të realizojë, në kuptimin e plotë, përgjegjësitë e tij, duhet që të jetë i shëndetshëm. Në mënyrë që njeriu të mbrohet nga sëmundjet duhet të jetë në dijeni të këtyre ligjeve dhe t'i zbatojë ato. Feja jonë i kushton shumë rëndësi qoftë ruajtjes së shëndetit shpirtëror, ashtu edhe atij fizik. Trupi dhe shëndeti ynë janë një amanet që nuk mund t'u përcaktohet vlera. Prandaj, të qenit e njeriut i shëndetshëm dhe mbrojtja e tij nga sëmundjet është konsideruar si detyrë fetare. Shoqëria që përbëhet nga njerëz të shëndetshëm është e fuqishme.

## Sëmundja

Në konceptimin e kaderit të përcaktuar në Kur'an, përgjegjësia e njeriut është ndër çështjet kryesore. Në këtë kuadër, çdo njeri është përgjegjës për ruajtjen e shëndetit shpirtëror dhe trupor. Brenda synimeve të fesë sonë, nën urdhëresat dhe ndalesat, është edhe mbrojtja e shëndetit. Pejgamberi ynë i dashur ka bërë paralajmërime mbi rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit, mbi nevojën e kurimit në rast sëmundjeje.



“Allahu ka krijuar edhe shërimin e çdo sëmundjeje që ka dhënë...” (Muslim, Selam, 26, (69), II/1729)

Njeriu, kur sëmuret, kërkon zgjidhje për të rifituar shëndetin e tij. Mundohet të gjejë metodat e kurimit për përmirësimin e sëmundjes. I drejtohet doktorit, përdor medikamente, nëse nevojitet bëhet operacion dhe në fund e pret shërimin nga Allahu. Sahabiu Ebu Huzame e pyet Pejgamberin tonë: “Ne ruhem nga sëmundjet, bëjmë dua dhe kurohem. A e ndryshojnë këta kaderin? Edhe ai i përgjigjet: “Edhe mbrojtja, dua ja dhe kurimi janë kader.” (Ahmed b. Hanbel, Musned, III/421; Tirmidhi, Tib, 21, (2065)).

Kur'ani kujton se, qoftë sëmundja, qoftë shërimi, kanë ardhur prej Tij dhe këtu tregon si shembull besimin që shërimi vjen nga Allahu, duke e ilustruar këtë me sjelljen e Ibrahim: “Është Ai që, kur sëmurem, më shëron.” (Shu'ara, 26/80) Besimi se shërimi do të vijë nga Allahu, i jep kurajë të sëmurit dhe i shton atij durimin dhe rezistencën kundrejt sëmundjes, duke e ndihmuar të shërohet. I sëmuri nuk bie kurrë në pesimizëm, madje as përballë faktit se mund të vdesë, sepse ai e di që ka ardhur nga Allahu dhe se do të kthehet përsëri tek Ai (shih, Bakara, 2/156).

Të gjitha këto, të qenit e njeriut i shëndetshëm, sëmundja e tij, përmirësimi dhe vdekja, nuk mbeten jashtë kaderit të njeriut. Detyra e njeriut në marrëdhënien njeri-kader është realizimi i përgjegjësisë që i janë ngarkuar dhe kjo është ajo që do të hetohet tek ai.



### Le të mendojmë

Si duhet ta vlerësojmë sëmundjen nga pikëpamja e kaderit?



“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen dhe pastaj të gjithë do të ktheheni te Ne.”  
(Ankebut, 29/57)



### Përmbledhja e kapitullit

Njëri prej kushteve të besimit të fesë sonë të shenjtë, Islamit, është besimi në kader dhe në kada. Të besosh në kader dhe kada do të thotë të besosh se çdo gjë e mirë dhe e keqe, e gjallë apo jo, është formuar me dijeninë, dëshirën, përcaktimin dhe krijimin e Allahut dhe se nuk ka krijues tjetër pos Tij.

Kaderi nënkupton dijeninë dhe përcaktimin e kohës, të vendit dhe të veçorive të çdo gjëje që do të ndodhë nga fillimi deri në fund nga Allahu. Krijimi kur të vijë koha, i gjërave që Allahu i ka përcaktuar më parë, quhet kada.

Konceptet teuekkul, risk, sukses, fatkeqësi dhe sëmundje janë koncepte që Kur’ani i sheh në lidhje me kaderin. Për këtë, Kur’ani thekson fillimisht faktin se njeriu është përgjegjës për sjelljen e tij dhe kërkohet nga ai që të plotësojë përgjegjësinë e vet.

Njeriu e vijon jetën sipas ligjeve biologjike. Edhe të qenit të tij i shëndetshëm, sëmundja e tij, përmirësimi dhe vdekja, realizohen në kuadër të këtyre ligjeve.



## Të rishikojmë kapitullin



1. Thoni kuptimin e koncepteve kader dhe kada.
2. Shpjegoni përse duhet t'i besojmë kaderit dhe kadasë.
3. Çfarë marrëdhënie ka mes kaderit të njeriut dhe lirisë e përgjegjësisë? Shpjegojeni.
4. Ç'do të thotë që njeriu të jetë përgjegjës në normë me lirinë e tij?
5. Formoni lidhjen mes kaderit e kadasë dhe ligjeve universale.
6. Thoni kuptimin e nga një ajeti që lidhet me kaderin dhe kadanë.
7. Shpjegoni marrëdhënien e kaderit me riskun dhe nënshtrimin.
8. Çfarë lidhjeje ka ndërmjet kaderit dhe suksesit, fatkeqësisë dhe sëmundjes?
9. Shpjegoni marrëdhënien ndërmjet koncepteve që lidhen me kaderin dhe përgjegjësinë e njeriut.



## Pyetje vlerësuese



### 1. Në ç'kuptim përdoren shprehjet shkrim balli dhe shkrim fati?

- A) Njeriu është një qenie që i kryen sjelljet me detyrim.
- B) Të qenit e njeriut një qenie që mban përgjegjësi.
- C) Njeriu zotëron kader.
- D) Besimi dhe mbështetja e njeriut në Allah.
- E) Zotërimi i vullnetit të lirë nga njeriu.

### 2. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk lidhet me konceptin "liri"?

- A) Ekzistenca e së drejtës së zgjedhjes dhe veprimit të njeriut është ndër kushtet themelore të lirisë.
- B) Dija dhe përcaktimi i njeriut nga çdo gjë kufizon lirinë e tij.
- C) Njeriu është përgjegjës për sjelljet e tij në normë me lirinë.
- D) Në themel të lirisë ekziston informimi për ligjet e Allahut në lidhje me botën.
- E) Liria është një ndër pengesat më të rëndësishme para vartësisë së pavetëdijshme.

### 3. Cila është çështja themelore e trajtuar në ajetin "Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai"?

- A) Dashuria e Allahut
- B) Duaja
- C) Përgjegjësia
- D) Nënshtrimi
- E) Vullneti i njeriut

### 4. Cilin nga konceptet e mëposhtme Kur'ani nuk e vlerëson në aspekt të marrëdhënies së njeriut me kaderin?

- A) Sëmundja
- B) Suksesi
- C) Devotshmëria
- D) Fatkeqësia
- E) Risku

### 5. Në cilën prej alternativave të mëposhtme përkufizimi i "kadasë" është dhënë në mënyrë të përmbledhur?

- A) Realizimi në kohë i gjërave që Allahu i di dhe i përcakton paraprakisht.
- B) Dija dhe përcaktimi i çdo gjëje nga Allahu.
- C) Krijimi i çdo gjëje në univers nga Allahu, sipas një rregulli dhe kriteri të caktuar.
- D) Ngjarjet që i ndodhin papritur njeriut.
- E) Dhënia e vendimit për punët që do të bëjë nga njeriu me vullnet të lirë.





## Çelësi i përgjigjeve



### KAPITULLI 1

1. A, 2. C, 3. B, 4. D, 5. D

### KAPITULLI 2

1. E, 2. A, 3. E, 4. A, 5. B

### KAPITULLI 3

1. C, 2. C, 3. B, 4. D, 5. E

### KAPITULLI 4

1. A, 2. C, 3. D, 4. B, 5. A

### KAPITULLI 5

1. A, 2. C, 3. C, 4. E, 5. D

### KAPITULLI 6

1. C, 2. D, 3. A, 4. D, 5. A

### KAPITULLI 7

1. D, 2. A, 3. B, 4. C, 5. D

### KAPITULLI 8

1. D, 2. B, 3. D, 4. B, 5. C

### KAPITULLI 9

1. C, 2. B, 3. D, 4. C, 5. A

## Literaturë

- Akseki, A. Hamdi, *Ahlak ilmi ve İslam Ahlakı (Shkenca e moralit dhe morali islam)*, Ankara, Nur Yayınları, 1991.
- Akseki, A. Hamdi, *İslam Dini (Feja islame)*, Ankara, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, 1975.
- Ateş, Süleyman, *Kur'an Prensipleri (Parimet e Kur'anit)*, İstanbul, Yeni Ufuklar Neşriyat, 1996.
- Aydın, Ali Arslan, *İslam İnançları ve Felsefesi (Besimet dhe filozofia islame)*, Ankara, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, 1964.
- Aydın, Ali Arslan, *İslam'da İman ve Esasları (Besimi në Islam dhe kushtet e tij)*, İstanbul, Hisar Yayınevi, 1982
- Bilmen, Ömer Nasuhi, *Büyük İslam İlmihali (İlmihali i madh islam)*, Ankara, Bilmen Basım ve Yayınevi, 1992.
- Buhari, *el-Edebu'l-Mufred*, 1/67, përkth. A. Fikri Yavuz, İstanbul, Sönmez Yayınları 1979.
- Çakan, İsmail Lütfi, N. Mehmed Solmaz, *Kur'an-ı Kerim'e göre Peygamberler ve Teuhid Mücadelesi (Pejgamberët dhe përpjekja për teuhid sipas Kur'anit)*, I-III, İstanbul, Ensar Neşriyat, 1998.
- Çubukçu, İ. Agâh, *İslam'da Ahlak ve Vazifeler (Moralit në islam dhe detyrat)*, Ankara, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, 1974.
- Demir, Rıza, (1991), *Dini ve Millî Şiirler Antolojisi (Antologjia fetare dhe kombëtare)*, Ankara, TDV Yayınları, Diyanet Dergisi, Nëntor 1999.
- Gölcük, Şerafettin, *Kur'an'da İnsanın Değeri (Vlera e njeriut në Kur'an)*, İstanbul, Zafer Matbaası, 1983.
- Güç, Ahmet, *Satanizm: Şeytana Tapınmanın Yeni Adı (Satanizmi: emri i ri i adhurimit të shejtanit)*, Ankara, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, 2004.
- Gündüz, Şinasi, *Din ve İnanç Sözlüğü (Fjalor i fesë dhe i besimit)*, Ankara, Vadi Yayınları, 1998.
- Harman, Ömer Faruk, "Ungjilli", XXII, 270-276, *TDV İslam Ansiklopedisi*, İstanbul 2000.
- Hökelekli, Hayati, *Din Psikolojisi (Psikologjia fetare)*, Ankara, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, 1983.
- <http://tdk.org.tr/tdksozluk/sozara.htm>
- İmam Gazali, *Varlıkların Yaratılış Hikmetleri (Urtësitë e krijimit të gjallesave)*, përkth. H. Akarsu – M. Sıradağ, İstanbul 1971.
- İmam Gazali, *Esmâ-i Hüsnâ Şerhi: el-Maksdu'l-Esna Şerhu Esmâ'l-Husna, (Cennetlik) (Komentimi i Esmâ-i Husna: el-Maksdu'l-Esna Sherhu Esmâ'l-Husna)*, përkth. M. Feriştat, İstanbul, Eskin Matbaası, 1972.
- İzutsu, Toshihiko, *Kur'an'da Allah ve İnsan (Allahu dhe njeriu në Kur'an)*, përkth. Süleyman Ateş, İstanbul, Yeni Ufuklar Neşriyat.



- Kandemir, M. Yaşar, *Meleklerle İnanıyorum (Besoj në melekë)*, İstanbul, Damla Yayınevi, 2000.
- Kırca, Celal, "Kitab", 439, "Kur'an", 448-449, "Vahij", 719-720, *İslami Kavramlar (Konceptet islame)*, Ankara, Sema Yazar Gençlik Vakfı Yayınları: 2.
- Kırca, Celal, (1997), "Kader", 410-412, "Kada", 425-426, "Fatkeqësi", 15-16, *İslami Kavramlar (Konceptet islame)*, Ankara, Sema Yazar Gençlik Vakfı Yayınları: 2.
- Komision, *İlmihal, İman ve İbadetler – Besimi dhe adhurimet (I), İslam ve Toplum- Islami dhe shoqëria (II)*, İstanbul, Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, 1999.
- Komision, *İlköğretim Din Kültürü ve Ahlak Bilgisi Dersi Öğretmen Kılavuzu 5 (Udhëzues për mësuesit në mësimin kultura fetare dhe informacione mbi moralin në shkollë fillore 5)*, İstanbul, Milli Eğitim Basımevi, 2002.
- Komision, *Dini Kavramlar Sözlüğü (Fjalor i koncepteve fetare)*, Ankara, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, 2006.
- Kur'an Kursları Öğretim Programı: Yüzünden Okuyanlar İçin (Program mësimit për kurset e Kur'anit: për mësime të njohura të Johafizë)*, Ankara 2004.
- Malik, *el-Muvatta*, İstanbul, Çağrı Yayınları 1982.
- Özcan, Mehmet Tevfik, *Ruhi Bunalımlar ve İslam Ruhiyatı (Kriza shpirtërore dhe ana shpirtërore e Islamit)*, Ankara, Santral Yayınları, 1985.
- Pazarbaşı, Erdoğan, *Kur'an ve Medeniyet, Doğuşu-Gelişimi-Çöküşü (Kur'ani dhe qytetërimi, lindja-zhvillimi-rënia)*, İstanbul, Pınar Yayınları, 1996.
- Peker, Hüseyin, *Din Psikolojisi (Psikologjia fetare)*, Samsun 2000.
- Polat, Selahattin, "Hastalık" (Sëmundja), 297-299, *İslami Kavramlar (Konceptet islame)*, Ankara, Sema Yazar Gençlik Vakfı Yayınları: 2.
- Sabuni, Nureddin, *Maturidiyye Akaidi (Akaidi Maturidit)*, përkth. Bekir Topaloğlu, Ankara, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, 1979.
- Sofuoğlu, Mehmet (Përkth), *Sahih-i Müslim ve Tercemesi*, İstanbul, İrfan Yayınevi, 1966.
- Şentürk, Lütfi ve Yazıcı, Seyfettin, *İslam İlmihali (İlmihali islam)*, Ankara, Sema Yazar Gençlik Vakfı Yayınları: 2, 1997.
- Tunç, Cihat, *Sistematik Kelam (Akaidi Sistematik)*, Kayseri, Erciyes Üniversitesi Yayınları, 1994.
- Tunçalp, Enver, *İnandım İman Ettim (Besova)*, Ankara, Şark Matbaası, 1974.
- Ulutürk, Veli, *Kur'an-ı Kerim'de Yaratma Kavramı (Koncepti i krijimit në Kur'an)*, İstanbul, İnsan Yayınları, 1995.
- Vergote, Antoine, *Din, İnanç ve İnançsızlık: Psikolojik İnceleme (Feja, Besimi dhe Mosbesimi: Analizë Psikologjike)*, përkth. Veysel Uysal, İstanbul, Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları, 1999.
- Yavuz, Kerim, *Çocukta Dini Duygu ve Düşüncenin Gelişmesi: 7-12 Yaş (Ndjenja e fesë dhe zhvillimi i saj te fëmija: 7-12 Vjeç)*, Ankara, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları 1987.
- Yavuz, Yusuf Şevki, "Kader", *TDV İslam Ansiklopedisi*, İstanbul, XXIV, 58-63 2001.
- Yazıcı, Seyfettin, *Temel Dini Bilgiler: İtikat, İbadet, Ahlak, Siyer (Informacione themelore të fesë: Besim, adhurim, moral, sije)*, Ankara, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, 1995.
- Yurdagür, Metin, *Allah'ın Sıfatları: Esmâ'ül-Husna*, İstanbul, Marifet Yayınları, 1984.